

32011L0061

DIREKTIVA 2011/61/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, DATË 8 QERSHOR 2011, "PËR ADMINISTRUESIT E FONDEVE ALTERNATIVE TË INVESTIMIT" DHE QË NDRYSHON DIREKTIVAT 2003/41/KE DHE 2009/65/KE DHE RREGULLORET (KE) NR. 1060/2009 DHE (BE) NR. 1095/2010

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh traktatin për funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në veçanti nenin 53, paragrafi 1,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe SocialDuke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legislative

Meqë:

1. Administruesit e fondeve alternative të investimit (AIFM) përgjigjen për administrimin e një sasi të konsiderueshme aktivesh të investuara në Bashkimin Evropian, shqyrtojnë sasi të konsiderueshme të tregtimeve në tregjet e instrumenteve financiare, ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm në tregjet dhe shoqëritë në të cilat ata investojnë.

2. Ndikimi i AIFM-ve në tregjet ku operojnë është kryesisht pozitiv, por vështirësitë financiare të kohëve të fundit theksojnë se aktivitetet e AIFM-ve mund të shërbejnë gjithashtu për përhapjen ose shumëfishimin e rreziqeve në të gjithë sistemin financiar. Reagimet kombëtare të pakoordinuara vështirësojnë menaxhimin efikas të rrezikut. Kështu, direktiva synon të vendosë kërkesa të përbashkëta që rregullojnë autorizimin dhe mbikëqyrjen e AIFM-ve, me qëllim që të sigurojë një qasje koherente ndaj rreziqeve përkatëse dhe ndikimin e tyre tek investitorët dhe tregjet e Bashkimit Evropian.

3. Vështirësitë e kohëve të fundit në tregjet financiare theksojnë vulnerabilitetin e shumë prej strategjive të AIFM-ve ndaj disa apo shumë rreziqeve të rëndësishme në lidhje me investitorët, pjesëmarrësit e tjerë të tregut dhe tregjet. Për të garantuar marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe të përbashkëta për mbikëqyrjen, duhet të ngrihet një kuadër që mund të trajtojë këto rreziqe duke marrë në konsideratë gamën e larmishme të strategjive dhe teknikave investuese të përdorura nga AIFM-të. Rrjedhimisht, kjo direktivë duhet të zbatohet për AIFM-të që administrojnë të gjitha llojet e fondeve që nuk mbulohen nga Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në tituj të transferueshëm, pavarësisht të mënyrës ligjore ose kontraktuale sipas së cilës i besohet kjo përgjegjësi AIFM-ve. AIFM-të nuk duhet të kenë të drejtën e administrimit të SIKTT-ve sipas kuptimit të Direktivës 2009/65/KE, në bazë të autorizimit të dhënë sipas kësaj direktive.

4. Kjo direktivë gjithashtu synon të parashikojë një treg të brendshëm të AIFM-ve dhe një kuadër rregullator dhe mbikëqyrës të harmonizuar dhe të rreptë në lidhje me aktivitetet e të gjithë AIFM-ve brenda Bashkimit Evropian, duke përfshirë ata me seli të regjistruar në një shtet anëtar (AIFM-të e BE-së) dhe ata me seli të regjistruar në vendet e treta (AIFM-të jashtë BE-së). Meqë pasojat praktike dhe vështirësitë e mundshme që rezultojnë nga kuadri i harmonizuar rregullator dhe tregu i brendshëm i AIFM-ve jashtë BE-së, të cilat kryejnë veprimtari administrimi dhe/ose tregtimi brenda Bashkimit Evropian, dhe AIFM-ve të BE-së që administrojnë fondet alternative të investimit (AIF-të) jashtë BE-së, nuk kanë siguri dhe janë të vështira për t'u parashikuar për shkak mungesës së eksperiencës së mëparshme në këtë drejtim, duhet të parashikohet një mekanizëm rishikimi. Pas një periudhe kalimtare 2-vjeçare, për AIFM-të jashtë BE-së që kryejnë veprimtari administrimi dhe/ose tregtimi brenda Bashkimit Evropian, dhe për AIFM-të e BE-së që administrojnë AIF-të jashtë BE-së, pas hyrjes në fuqi të një akt të deleguar nga Komisioni për këtë qëllim, synohet që të vihet në zbatim regjimi i harmonizuar i pasaportave. Gjatë një periudhe të mëtejshme kalimtare prej 3 vjetësh, synohet që regjimi i harmonizuar të vihet në zbatim së bashku me regjimet kombëtare të shteteve anëtare sipas disa kushteve të caktuara minimale të harmonizimit. Pas kësaj periudhe 3-vjeçare të zbatimit të përbashkët, synohet që regjimeve kombëtare t'i jepet fund sapo të hyjë në fuqi një tjetër akt i deleguar nga Komisioni.

5. 4 vite pas afatit përfundimtar për transpozimin e kësaj direktive, Komisioni duhet të rishikojë zbatimin dhe fushën e zbatimit të kësaj direktive, duke marrë në konsideratë objektivat e saj, dhe duhet të vlerësojë nëse qasja e harmonizuar në Bashkimin Evropian ka shkaktuar ndonjë çrregullim të vazhdueshëm të konsiderueshëm në treg dhe nëse kjo direktivë funksionon me efikasitet për sa u përket parimeve të tregut të brendshëm dhe të rregullave të barabarta të lojës.

6. Fusha e zbatimit të kësaj direktive duhet të përfshijë vetëm subjektet që kanë si veprimtari të rregullt administrimin e fondeve alternative të investimit, pavarësisht nëse AIF-të janë të hapura ose të mbyllura, cilado qoftë forma ligjore e AIF-ve, dhe pavarësisht faktit nëse një AIF është i listuar ose jo, të cilët mbledhin kapital nga një sërë investitorësh me synim investimin e këtij kapitali në përfitim të atyre investitorëve sipas një politike të përcaktuar investimi.

7. Sipërmarrjet e investimeve, siç janë shoqëritë për investim të brendshëm, të cilat investojnë pasurinë private të investitorëve pa mbledhur kapital të jashtëm, nuk duhet të konsiderohen si AIF sipas kësaj direktive.

8. Subjektet që nuk konsiderohen AIFM në përputhje me këtë direktivë, nuk përfshihen në fushën e saj të zbatimit. Si rrjedhojë, kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për shoqëritë kontrolluese, siç përcaktohen në këtë direktivë. Megjithatë, nuk duhet të përjashtohen nga fusha e zbatimit të saj, administruesit e fondeve të kapitalit të vet ose AIFM-të që administrojnë AIF-të, aksionet e të cilave pranohen për t'u tregtuar në një treg të rregulluar. Për më tepër, kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për administrimin e fondeve të pensionit; skemat e pjesëmarrjes ose skemat e kursimit të punonjësve; institucionet multinacionale; bankat qendrore kombëtare; qeveritë qendrore, rajonale dhe vendore dhe organet ose institucionet, që administrojnë fondet në mbështetje të sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe të pensionit; subjektet e veçanta të titullimit; ose kontratat e sigurimit dhe sipërmarrjet e përbashkëta.

9. Firmat e investimit që autorizohen sipas Direktivës 2004/39/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për tregjet e instrumenteve financiare”, dhe institucioneve të kreditit që autorizohen sipas Direktivës 2006/48/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 qershor 2006, lidhur me fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të institucioneve të kreditit, nuk duhet t’i kërkohej autorizimi sipas kësaj direktive, me qëllim ofrimin e shërbimeve të investimit, si administrimi i portofolit individual në lidhje me AIF-të. Megjithatë, firmat e investimit duhet të jenë të afta të ofrojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, njësi apo aksione të AIF-ve, ose t’i caktojnë investitorëve të Bashkimit Evropian këto njësi apo aksione, deri në masën që këto njësi ose aksione të tregtohen në përputhje me këtë direktivë. Gjatë transpozimit të kësaj direktive në legjislationin e brendshëm, shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë qëllimin rregullator të kësaj kërkesë dhe gjithashtu të garantojnë se firmat e investimit të themeluara në një vend të tretë, të cilat sipas legjislationit përkatës kombëtar mund të ofrojnë shërbime investimi, të përfshihen gjithashtu në fushën e zbatimit të kësaj kërkesë. Ofrimi i shërbimeve të investimit nga këto subjekte në lidhje me AIF-të nuk duhet të arrijë asnjëherë në anashkalimin de facto të kësaj direktive, përmes shndërrimit të AIFM-së në një subjekt që ekziston vetëm si emër, pavarësisht nëse AIFM-ja themelohet në Bashkimin Evropian ose në një vend të tretë.

10. Kjo direktivë nuk rregullon AIF-të. Kështu, duhet të mundësohet rregullimi dhe mbikëqyrja e fondeve alternative të investimit në nivel kombëtar. Rregullimi i strukturës ose përbërjes së portofolave të AIF-ve të administruara nga AIFM-të në nivel Bashkimi Evropian, do ishte joproportional dhe do të ishte e vështirë të parashikohej një harmonizim i tillë i zgjeruar, për shkak të llojeve tepër të larmishme të AIFM-ve të administruara AIFM-të. Kështu, kjo direktivë nuk i ndalon shtetet anëtare që të miratojnë ose të vazhdojnë zbatimin e kërkesave kombëtare në lidhje me AIF-të e themeluara në territorin e tyre. Fakti që, për AIF-të e themeluara në territorin e tij, një shtet anëtar mund të vendosë kërkesa të tjera përveç atyre që zbatohen në shtetet e tjera anëtare nuk duhet t’i ndalojë AIFM-të e autorizuar sipas kësaj direktive në shtete të tjera që të ushtrojnë të drejtat për të tregtuar me investitorët profesional në Bashkimin Evropian disa AIF të caktuara të themeluara jashtë shtetit anëtar që ka vendosur kërkesat shtesë dhe të cilat, për pasojë, nuk janë objekt i dhe nuk është e nevojshme që të plotësojnë këto kërkesa shtesë.

11. Disa dispozita të kësaj direktive kërkojnë që AIFM-të të veprojnë në pajtim me kërkesat për të cilat, në disa struktura të fondeve, AIFM-të nuk mbajnë përgjegjësi. Një shembull i këtyre strukturave të fondeve është rasti kur përgjegjësia e emërimit të depozitarit i takon AIF-ve ose një subjekti tjetër që vepron në emër të AIF-ve. Në këto raste, AIFM-ja nuk ka kontrollin përfundimtar lidhur me mundësinë e emërimit faktik të depozitarit, përveç rastit të administrimit të brendshëm të AIF-së. Meqë kjo direktivë nuk rregullon AIF-të, ajo nuk mund t’i kërkojë AIF-ve të emërojnë një depozitar. Në rast se një AIFM nuk arrin të garantojë pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme të një AIF-je ose një subjekti tjetër që vepron në emër të saj, autoritetet kompetente duhet t’u kërkojnë AIFM-së që të ndërmarrë hapat e nevojshme për të korrigjuar situatën. Nëse, pavarësisht këtyre hapave, papajtueshmëria vazhdon të ekzistojë dhe për sa kohë që ajo lidhet me një AIFM në BE ose një AIFM të autorizuar jashtë BE-së që administron një AIF në BE, AIFM-ja duhet të japë dorëheqjen si administrues i AIF-së. Nëse AIFM-ja nuk jep dorëheqjen, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinë duhet t’i kërkojnë këtë dorëheqje, dhe nuk duhet të lejohet më tregtimi i AIF-së përkatëse në Bashkimin Evropian. I njëjti ndalim

duhet të zbatohet për AIFM-të e autorizuar jashtë BE-së të cilat tregtojnë në Bashkimin Evropian AIF të themeluara jashtë tij.

12. Përveç se kur parashikohet ndryshe në mënyrë specifike, në rastin kur kjo direktivë i referohet interesave të investitorëve të një AIF-je, parashikohen interesat e investitorëve në cilësinë e tyre specifike si investitorë të AIF-ve dhe jo interesat e tyre individuale.

13. Sipas përjashtimeve dhe kufizimeve të parashikuara, kjo direktivë zbatohet për të gjithë AIFM-të e BE-së, që administrojnë AIF-të e BE-së ose AIF-të jashtë BE-së, pavarësisht nëse ato tregtohen ose jo në Bashkimin Evropian, për AIFM-të jashtë BE-së, që administrojnë AIF-të e BE-së, pavarësisht nëse ato tregtohen ose jo në Bashkimin Evropian, dhe për AIFM-të jashtë BE-së, që tregtojnë brenda Bashkimit Evropian AIF-të e BE-se ose AIF-të jashtë BE-së.

14. Kjo direktivë përcakton kërkesat në lidhje me mënyrën se si AIFM-të duhet të administrojnë AIF-të që kanë nën përgjegjësi. Për AIFM-të jashtë BE-së, kjo kufizohet me administrimin e AIF-ve të BE-së dhe AIF-ve të tjera, njësitë ose aksionet e të cilave tregtohen edhe për investitorët profesionist në Bashkimin Evropian.

15. Autorizimi i AIFM-ve të BE-së në përputhje me këtë direktivë mbulon administrimin e AIF-ve të BE-së, të themeluara në shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së. Duke iu nënshtruar kërkesave të mëtejshme për njoftim, këtu gjithashtu përfshihet tregtimi për investitorët profesionistë brenda Bashkimit Evropian i AIF-ve të administruara nga AIFM-të e BE-së dhe administrimi i AIF-ve të BE-së të themeluara në shtete anëtare të ndryshme nga shteti anëtar i origjinës së AIFM-së. Kjo direktivë gjithashtu parashikon kushtet sipas të cilave AIFM-të e autorizuar të BE-së kanë të drejtë të tregtojnë AIF jashtë BE-së për investitorët profesionist në Bashkimin Evropian, dhe kushtet sipas të cilave një AIFM jashtë BE-së mund të marrë një autorizim për administrimin e AIF-ve të BE-së dhe/ose tregtimin, me pasaportë, të AIF-ve për investitorët profesionist në Bashkimin Evropian. Gjatë periudhës së konsideruar si e përkohshme, shtetet anëtare gjithashtu mund t'i lejojnë AIFM-ve të BE-së të tregtojnë AIF-të jashtë BE-së vetëm brenda territorit të tyre, dhe/ose t'i lejojnë AIFM-ve jashtë BE-së të administrojnë AIF-të e BE-së dhe/ose të tregtojnë AIF-të për investitorët profesionistë vetëm brenda territorit të tyre, sipas legjislacionit të brendshëm, për sa kohë që përmbushen disa kushte minimale të parashikuara nga kjo direktivë.

16. Kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për AIFM-të, për aq kohë sa ato administrojnë AIF-të, investitorët e të cilave janë vetë AIFM-të ose shoqëritë e tyre mëmë, filialet e tyre ose filialet e shoqërive të tyre mëmë, dhe në rastin kur vetë këta investitorë nuk janë AIF.

17. Kjo direktivë parashikon më tej një regjimin më të lehtë të AIFM-ve, ku AIF-të kumulative që administrohen nuk e kalojnë cakun prej 100 milionë eurosh dhe për AIFM-të që administrojnë vetëm AIF-të pa efektin e levës financiare, që nuk i japin investitorëve të drejtat e kompensimit për një periudhë 5-vjeçare, në rastin kur AIF-të kumulative që administrohen nuk e kalojnë cakun prej 500 milionë eurosh. Edhe pse aktivitetet e AIFM-ve përkatëse nuk kanë gjasa të kenë pasoja individuale të konsiderueshme në stabilitetin financiar, agregimi mund të bëjë që veprimtaritë e tyre të rezultojnë në rreziqe sistemike. Rrjedhimisht, këto AIFM nuk duhet t'i nënshtrohen autorizimit të plotë, por duhet të regjistrohen në shtetin anëtar të origjinës së tyre dhe duhet, ndër të tjera, t'i japin autoriteteve të tyre kompetente informacionin përkatës në lidhje

me instrumentet kryesore që ata tregtojnë dhe me ekspozimet kryesore dhe përqendrimet më të rëndësishme të AIF-ve të administruara prej tyre. Megjithatë, në mënyrë që të përfitojnë nga të drejtat e dhëna sipas kësaj direktive, këto AIFM më të vogla duhet të lejohen të trajtohen si AIFM, duke iu nënshtuar procedurës së përfshirjes të parashikuar nga kjo direktivë. Ky përjashtim nuk duhet të kufizojë aftësinë e shteteve anëtare për të vendosur kërkesa më të rrepta për AIFM-të e papërfshira.

18. Asnjë AIFM e BE-së nuk duhet të administrojë dhe/ose të tregtojë AIF-të e BE-së për investitorët profesionistë në Bashkimin Evropian, nëse ai nuk është autorizuar në përputhje me këtë direktivë. AIFM-ja e autorizuar në përputhje me këtë direktivë duhet, në çdo kohë, të përmbushë kushtet e autorizimit të përcaktuara në këtë direktivë.

19. Menjëherë pas lejimit të saj sipas kësaj direktive, një AIFM jashtë BE-së, që synon të administrojë AIF-të e BE-se dhe/ose të tregtojë AIF-të në Bashkimin Evropian me pasaportë, ose një AIFM e BE-së që synon të tregtojë AIF-të jashtë BE-së në Bashkimin Evropian me pasaportë, duhet gjithashtu të autorizohet në përputhje me këtë direktivë. Të paktën gjatë periudhës kalimtare, shteti anëtar duhet lejojë një AIFM jashtë BE-së që të tregtojë AIF-të në atë shtet anëtar, si dhe të autorizojë një AIFM të BE-së që të tregtojë AIF jashtë BE-së në atë shtet anëtar, për aq kohë sa përmbushen kushtet minimale të përcaktuara në këtë direktivë.

20. Në varësi të formës së tyre ligjore, AIF-të mund të kenë administrim të brendshëm ose të jashtëm. AIF-të konsiderohen me administrim të brendshëm kur funksionet e administrimit kryhen nga organi rregullator ose çdo burim tjetër i brendshëm i AIF-së. Nëse forma ligjore e AIF-së lejon administrimin e brendshëm dhe kur organi rregullator i AIF-së zgjedh të mos emërojë një AIFM të jashtme, AIF-ja është gjithashtu AIFM dhe rrjedhimisht duhet të pajtohet me të gjitha kërkesat për AIFM-të në zbatim të kësaj direktive dhe të autorizohet si e tillë. Megjithatë, AIFM-ja që është AIF me administrim të brendshëm nuk duhet të autorizohet si administrues i jashtëm i AIF-ve të tjera. Një AIF konsiderohet se ka administrim të jashtëm kur AIF-ja ka emëruar, ose në emër të AIF-së është emëruar si administrator një person juridik i jashtëm, i cili nëpërmjet këtij emërimi mban përgjegjësi për administrimin e AIF-së. Kur është caktuar një AIFM e jashtme për të administruar një AIF të caktuar, kjo AIFM nuk duhet të konsiderohet se ofron shërbimin e investimit për administrimin e portofolit, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1, pika 9 të Direktivës 2004/39/KE, por për administrimin kolektiv të portofolit në përputhje me këtë direktivë.

21. Administrimi i AIF-ve duhet të nënkuptojë të paktën ofrimin e shërbimeve të administrimit të investimeve. AIFM-ja e vetme që duhet të emërohet sipas kësaj direktive nuk duhet të autorizohet asnjëherë që të ofrojë administrimin e portofolit pa ofruar edhe menaxhimin e rrezikut ose anasjelltas. Megjithatë, sipas kushteve të përcaktuara në këtë direktivë, një AIFM-je të autorizuar nuk duhet t'i ndalohet përfshirja në veprimtaritë e administrimit dhe të tregtimit të një AIF-je, ose në veprimtari që lidhen me aktivet e AIF-së. Një AIFM-je të jashtme nuk duhet t'i ndalohet as ofrimi i shërbimit të administrimit të portofolave të investimit sipas mandateve të dhëna nga investitorët, në mënyrë diskrete dhe rast pas rasti, duke përfshirë portofolat në pronësi të fondeve të pensionit dhe të institucioneve të pensioneve profesionale që mbulohen nga Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3 qershor 2003, "Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale" dhe as ofrimi i shërbimeve dytësore të këshillimit investues, të ruajtjes dhe të administrimit në lidhje me njësitë

e sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe për marrjen dhe transmetimin e porosive. Një AIFM-je të jashtëm duhet t'i lejohej administrimi i SIKTT-ve, në përputhje me autorizimin e dhënë sipas Direktivës 2009/65/KE.

22. Është e nevojshme të garantohet nënshtrimi i AIFM-ve ndaj kontrolleve të forta qeverisëse. AIFM-të duhet të administrohen dhe të organizohen në një mënyrë të tillë që minimizon konfliktet e interesit. Kërkesat organizative të caktuara sipas kësaj direktive nuk duhet të cenojnë sistemet dhe kontrollet e vendosura sipas legjislacionit të brendshëm për regjistrimin e personave që punojnë brenda ose për një AIFM.

23. Duhet të parashikohet zbatimi i kërkesave për kapitalin minimal me qëllim që të garantohet vazhdimësia dhe rregullsia e administrimit të AIF-ve nga një AIFM, dhe që të mbulohej ekspozimi i mundshëm i AIFM-ve ndaj përgjegjësisë profesionale në lidhje me të gjitha veprimtaritë e tyre, duke përfshirë administrimin e AIF-ve sipas një mandati të deleguar. AIFM-të duhet të kenë lirinë për të zgjedhur nëse i mbulojnë rreziqet e mundshme të përgjegjësisë profesionale nëpërmjet fondeve të veta ose nëpërmjet një sigurimi të përshtatshëm të shpërblimeve profesionale.

24. Për të trajtuar ndikimin e mundshëm negativ të strukturave të keqprojektuara të shpërblimit për administrimin e mirë të rrezikut dhe kontrollin e sjelljeve të rrezikshme nga ana e individëve, për AIFM-të duhet të përcaktohet një detyrim i qartë që të vendosin, për anëtarët e stafit veprimtaritë profesionale të të cilëve kanë një ndikim të madh në profilet e rrezikut të AIF-ve që ata administrojnë, politika dhe praktika shpërblimi të cilat janë në pajtim me menaxhimin e mirë dhe efikas të rrezikut. Këto kategori të stafit duhet të paktën të përfshijnë drejtuesit e lartë, marrësit e rrezikut, funksionet e kontrollit, dhe çdo punonjës që merr një shpërblim total që e përfshin atë në të njëjtën fashë shpërblimi me drejtuesit e lartë dhe marrësit e rrezikut.

25. Parimet që rregullojnë politikat e shpërblimit duhet marrin parasysh se AIFM-të mund t'i zbatojnë këto politika në mënyra të ndryshme sipas madhësisë së tyre dhe sipas madhësisë së AIF-ve që ato administrojnë, sipas organizimit të tyre të brendshëm dhe natyrës, fushës së zbatimit dhe kompleksitetit të veprimtarive të tyre.

26. Parimet në lidhje me politikat e mira të shpërblimit të përcaktuara në rekomandimin e Komisionit 2009/384/KE, datë 30 prill 2009, për politikat e shpërblimit në sektorin e shërbimeve financiare, janë konsistente me dhe plotësojnë parimet e kësaj direktive.

27. Për nxitjen e konvergjencave mbikëqyrëse gjatë vlerësimit të politikave dhe praktikave të shpërblimit, Autoriteti Evropian i Mbikëqyrjes (Autoriteti Evropian i Titujve dhe i Tregjeve), i themeluar përmes Rregullores (BE) nr. 1095/2010 së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (ESMA) duhet të garantojë ekzistencën e udhëzimeve për politikat e mira të shpërblimit në sektorin e AIFM-së. Autoriteti Mbikëqyrës Evropian (Autoriteti Bankar Evropian), i themeluar përmes Rregullores (BE) nr. 1093/2010 së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, duhet të mbështesë shqyrtimin e këtyre udhëzimeve.

28. Dispozitat për shpërblimin nuk duhet të cenojnë ushtrimin e plotë të të drejtave themelore të garantuara sipas traktateve, në veçanti nenit 153, paragrafi 5 të TFBE-së, parimet e përgjithshme të legjislacionit të brendshëm për kontratën dhe punën, legjislacionin e zbatueshëm

në lidhje me të drejtat e aksionarëve, dhe përfshirjen dhe të përgjegjësitë e përgjithshme të organeve administruese dhe mbikëqyrëse të institucionit përkatës, si dhe aty ku zbatohet, të drejtën e partnerëve social për lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve kolektive në përputhje me të legjislacionet dhe traditat e brendshme.

29. Vlerësimi i besueshëm dhe objektiv i aktiveve është thelbësor për mbrojtjen e interesave të investitorëve. AIFM-të përdorin metodologji dhe sisteme të ndryshme për të vlerësuar aktivet, në varësi të aktiveve dhe tregjeve kryesore ku ata investojnë. Këto diferenca duhet të njihen, por gjithsesi, në çdo rast, AIFM-ve duhet t' i zbatojnë procedurat e vlerësimit që rezultojnë nga vlerësimi i përshtatshëm i aktiveve të AIF-ve. Procesi i vlerësimit të aktiveve dhe i llogaritjes së vlerës neto të aktiveve duhet të jetë i pavarur, në mënyrë funksionale, nga administrimi i portofolit dhe politika e shpërbimit të AIFM-së, dhe duhet të ketë masa të tjera që garantojnë parandalimin e konfliktit të interesave dhe të ndikimit të paarsyeshëm mbi punonjësin. Duke iu nënshtruar disa kushteve të caktuara, AIFM-të duhet të kenë mundësi që të emërojnë një vlerësues të jashtëm për kryerjen e funksionit të vlerësimit.

30. Duke iu nënshtruar kufizimeve dhe kërkesave të rrepta, duke përfshirë ekzistencën e arsyeve objektive, një AIFM duhet të ketë mundësi që të delegojë disa nga funksionet e tij në përputhje me këtë direktivë në mënyrë që të rrisë efikasitetin në kryerjen e veprimtarive të tij. Duke iu nënshtruar të njëjtave kushte, duhet të lejohet edhe nëndelegimi. Megjithatë, AIFM-të duhet të vazhdojnë të mbajnë përgjegjësi në lidhje me ushtrimin siç duhet të funksioneve të deleguara dhe me pajtueshmërinë e vazhdueshme me këtë direktivë.

31. Kufizimet dhe kërkesat e rrepta për delegimin e detyrave nga AIFM-të duhet të zbatohen për delegimin e funksioneve drejtuese të përcaktuara në shtojcën I. Delegimi i detyrave mbështetëse, si funksionet administrative ose teknike që kryhen nga AIFM-ja si pjesë e detyrave të saj të administrimit, nuk i nënshtrohen kufizimeve dhe kërkesave specifike të përcaktuara në këtë direktivë.

32. Zhvillimet e kohëve të fundit vënë theksin mbi nevojën e madhe për të bërë një ndarje ndërmjet funksioneve të ruajtjes dhe funksioneve të administrimit të aktiveve, dhe për të ndarë aktivet e investitorit nga aktivet e administratorit. Ndonëse AIFM-të administrojnë AIF-të me modele dhe marrëveshje të ndryshme biznesi për, ndër të tjera, ruajtjen e aktiveve, është thelbësore që të emërohet një depozitar i ndryshëm nga AIFM-ja, me qëllim që të ushtrojë funksionet e depozitarit në lidhje me AIF-të.

33. Dispozitat e kësaj direktive në lidhje me emërimin dhe detyrat e depozitarit duhet të zbatohen për të gjithë AIF-të e administruara nga një AIFM që i nënshtrohet kësaj direktive dhe për pasojë për të gjithë modelet e biznesit të AIF-ve. Megjithatë, ato duhet të përshtaten sipas specifikave të modeleve të ndryshme të biznesit. Për disa modele biznesi, detyra të caktuara të depozitarit kanë më tepër rëndësi se të tjera, në varësi të llojit të aktiveve që AIF-të investojnë dhe të detyrave që lidhen me këto aktive.

34. Për AIF-të që nuk kanë të drejta kompensimi që mund të ushtrohen për një periudhë 5-vjeçare nga data e investimeve fillestare dhe që, në përputhje me politikën bazë të investimit, përgjithësisht nuk investojnë në aktive që duhet të mbahen në kujdestari në përputhje me këtë direktivë, ose përgjithësisht investojnë në emetues ose shoqëri të palistruara me qëllim që të mund

të marrin nën kontroll këto shoqëri në përputhje me këtë direktivë, siç janë kapitali privat, fondet për ndërmarrjet e reja dhe fondet e pasurive të paluajtshme, shtetet anëtare duhet të lejojnë emërimin e një noteri, avokati, mbajtësi të regjistrimit, ose një subjekti tjetër që të kryejë funksionet e depozitarit. Në këto raste, funksionet e depozitarit duhet të jenë pjesë e veprimtarive profesionale ose të biznesit, në lidhje me të cilat subjekti i emëruar i nënshtrohet regjistrimit profesional të detyrueshëm të njohur me ligj, ose dispozitave ligjore ose rregulloreve të sjelljes profesionale, dhe mund të sigurojë garanci të mjaftueshme financiare dhe profesionale që i mundësojnë këtij subjekti që të kryejë në mënyrë efikase funksionet përkatëse të depozitarit dhe të përmbushë angazhimet ekzistuese në lidhje me këto funksione. Këtu merret në konsideratë praktika aktuale në lidhje me disa lloje të fondeve të mbyllura. Megjithatë, për të gjitha AIF-të e tjera, depozitari duhet të jetë institucion krediti, firmë investimi ose një subjekt tjetër që ka marrë lejen sipas Direktivës 2009/65/KE, duke marrë parasysh rëndësinë e funksionit të kujdestarisë. Vetëm për rastin e AIF-ve jashtë BE-së, duhet të lejohet që depozitari të jetë një institucion krediti ose çdo subjekt tjetër me natyrë të njëjtë me atë të subjekteve të përmendura në këtë deklaramim, për aq kohë që ai i nënshtrohet rregullimit dhe mbikëqyrjes së kujdesshme dhe efikase, të cilat kanë të njëjtin ndikim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe zbatohen me efikasitet.

35. Depozitari duhet të ketë selinë e regjistruar ose një degë në të njëjtin shtet me atë të AIF-së. Vetëm në rastin e përmbushjes së kushteve të caktuara shtesë, një AIF jashtë BE-së mund të caktojë një depozitar në vendin e tretë përkatës. Sipas kriterëve të përcaktuara në aktet e deleguara, Komisioni duhet të autorizohet që të miratojë masat zbatuese, duke përmendur se rregullimi dhe mbikëqyrja e kujdesshme e një vendi të tretë kanë të njëjtën fuqi me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe zbatohen me efikasitet. Gjithashtu, procedura e ndërmjetësimit e përcaktuar në nenin 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010 duhet të zbatohet në rastin kur autoritetet kompetente nuk bien dakord për zbatimin e saktë të kushteve të tjera shtesë. Në të kundërt, në lidhje me AIF-të jashtë BE-së, depozitari duhet gjithashtu të lejohet që të regjistrohet në shtetin anëtar të origjinës ose në shtetin anëtar të referencës së AIFM-së që menaxhon AIF-në.

36. Komisioni ftohet që të shqyrtojë mundësitë për të paraqitur një propozim legjislativ horizontal të përshtatshëm që sqaron përgjegjësitë dhe detyrimet e depozitarit dhe rregullon të drejtën e depozitarit të një shteti anëtar që të ofrojë shërbime në një shtet tjetër anëtar.

37. Depozitari duhet të jetë përgjegjës për të monitoruar siç duhet fluksin e parasë së AIF-së, dhe në veçanti, për të garantuar se paratë e investitorit ose paratë që i përkasin AIF-së, ose AIFM-së që vepron në emër të AIF-së, të regjistrohen saktë në llogaritë e hapura në emër të AIF-së ose të AIFM-së që vepron në emër të AIF-së, ose në emër të depozitarit që vepron në emër të AIF-së për ruajtjen e aktiveve të AIF-së, duke përfshirë mbajtjen në kujdestari të instrumenteve financiare që mund të regjistrohen në llogarinë e instrumenteve financiare të hapur në regjistrat e depozitarit dhe të të gjitha instrumenteve financiare që mund t'i dorëzohen fizikisht depozitarit, si dhe për verifikimin e pronësisë së të gjitha aktiveve të tjera të AIF-së ose të AIFM-së që vepron në emër të AIF-së. Gjatë garantimit të regjistrimit të parave të investitorit në llogaritë e mjeteve monetare, depozitari duhet të marrë në konsideratë parimet e përcaktuara në nenin 16 të Direktivës së Komisionit 2006/73/KE, datë 10 gusht 2006, "Për zbatimin e Direktivës 2004/39/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat organizative dhe kushtet operative të firmave të investimit dhe me kushtet e përcaktuara për qëllime të kësaj direktive".

38. Depozitari duhet të veprojë në mënyrë të ndershme, të drejtë, profesionale, të pavarur dhe në interes të AIF-së ose të investitorëve të AIF-së.

39. Depozitari duhet të jetë në gjendje që t'i delegojë ruajtjen e aktiveve një pale të tretë, e cila nga ana e saj, duhet të jetë në gjendje ta delegojë këtë funksion. Megjithatë, delegimi dhe nëndelegimi duhet të justifikohen në mënyrë objektive dhe duke iu nënshtruar kërkesave në lidhje me përshtatshmërinë e palës së tretë, të cilës i besohet funksioni i deleguar, si dhe në lidhje me aftësinë dhe kujdesin e duhur që depozitari të tregojë në lidhje me përzgjedhjen, caktimin dhe rishikimin e palës së tretë.

40. Pala e tretë, të cilës i delegohet ruajtja e aktiveve, duhet të mbajë një llogari të përbashkët të veçuar për më shumë se një AIF, të ashtuquajtura "llogari omnibus".

41. Fakti që kujdestaria e aktiveve i besohet operatorit të sistemit të shlyerjes së titujve, siç caktohet për qëllimet e Direktivës 98/26/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 maj 1998, "Për finalizimin e shlyerjes së pagesave dhe të titujve në sistemet e shlyerjes", ose fakti që ofrimi i shërbimeve të ngjashme i besohet sistemeve të shlyerjes së titujve të vendeve të treta nuk duhet të konsiderohen si delegim i funksioneve të kujdestarisë.

42. Kufizimet dhe kërkesat e rrepta ndaj të cilave nënshtrohet delegimi i detyrave nga depozitari duhet të zbatohen për delegimin e funksioneve të tij specifike si depozitar, konkretisht për monitorimin e fluksit të parasë, ruajtjen e aktiveve dhe funksionet mbikëqyrëse. Delegimi i detyrave mbështetëse që lidhen me detyrat e tij si depozitar, si funksionet administrative ose teknike që kryhen nga depozitari si pjesë e detyrave të tij si depozitar, nuk i nënshtrohet kufizimeve dhe kërkesave specifike të përcaktuara në këtë direktivë.

43. Kjo direktivë gjithashtu merr në konsideratë faktin se shumë AIF, dhe në veçanti fondet e mbrojtura përmes ndarjes, përdorin tashmë një broker primar. Kjo direktivë garanton që AIF-të të mund të vazhdojnë të përdorin funksionin e brokerit primar. Megjithatë, përveç se kur ai e ka ndarë nga ana funksionale dhe hierarkike kryerjen e funksioneve të tij depozitare nga detyrat e brokerit primar dhe kur konfliktet e mundshme të interesit identifikohen dhe menaxhohen siç duhet dhe i njoftohen investitorëve të AIF-së, asnjë broker primar nuk duhet të caktohet si depozitar duke qenë se brokerat primarë veprojnë si kundërpalë të AIF-ve dhe, ndaj nuk mund të veprojnë njëkohësisht në interesin më të lartë të AIF-ve, siç i kërkohet një depozitari. Depozitarët duhet të jenë në gjendje t'i delegojnë detyrat e kujdestarisë te një ose më shumë brokera primarë ose palë të treta. Përveç detyrave të deleguara të kujdestarisë, brokerat primarë duhet të lejohen që të ofrojnë shërbime të brokerimit primar për AIF-në. Këto shërbime të brokerimit primar nuk duhet të jenë pjesë e marrëveshjes së delegimit.

44. Depozitari duhet të mbajë përgjegjësi për humbjet që i shkaktohen AIFM-së, AIF-së dhe investitorëve. Kjo direktivë bën një dallim ndërmjet humbjeve të instrumenteve financiare të mbajtura në kujdestari dhe të çdo humbjeje tjetër. Në rastin e humbjeve të ndryshme nga ato në lidhje me instrumentet financiare të mbajtura në kujdestari, depozitari duhet të mbajë përgjegjësi në rastet e veprimit të qëllimshëm ose të pakujdesisë. Nëse depozitari mban aktive në kujdestari dhe ato humbasin, depozitari duhet të mbajë përgjegjësi, përveç rastit kur ai vërteton se humbja ka ardhur si rezultat i rrethanave të jashtme që shkojnë përtej kontrollit të tij të arsyeshëm, pasojat e të cilave do ishin të pashmangshme, pavarësisht të gjitha përpjekjeve të arsyeshme për

të kundërtën. Në këtë kontekst, depozitari nuk duhet të mbështetet, për shembull, në rrethana të brendshme, si një akt mashtrimi nga një punonjësi, me qëllim për t'iu shmangur përgjegjësisë.

45. Depozitari duhet të mbajë përgjegjësi në rastin kur ai delegon detyrat e kujdestarisë dhe instrumentet financiare që mbahen në kujdestari nga një pala e tretë humbasin. Megjithatë, nëse depozitarit i lejohet shprehimisht që të çlirohet nga çdo përgjegjësi nëpërmjet një transferimi kontraktual të kësaj përgjegjësie tek një palë e tretë, sipas një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet depozitarit dhe AIF-së ose AIFM-së që vepron në emër të AIF-së, në të cilën ky çlirim justifikohet objektivisht, dhe nëse pala e tretë mund të mbajë përgjegjësi për humbjen në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet depozitarit dhe palës së tretë, depozitari mund të çlirohet nga përgjegjësia nëse ai mund të vërtetojë se ka ushtruar aftësitë dhe kujdesin e duhur dhe se janë përmbushur kërkesat specifike të delegimit. Përmes vendosjes së kërkesës për transferimin kontraktual të përgjegjësisë tek pala e tretë, kjo direktivë synon që t'i bashkëngjisë kësaj kontrate ndikimet e jashtme, duke e bërë palën e tretë përgjegjëse ndaj AIF-së, ose ndaj investitorëve të AIF-së, në lidhje me humbjet e instrumenteve financiare të mbajtura në kujdestari.

46. Gjithashtu, në rastin kur legjislacioni i një vendi të tretë kërkon që instrumente të caktuara financiare të mbahen në kujdestari nga një subjekt lokal dhe nuk ekziston asnjë subjekt lokal që përmbush kërkesat e delegimit të depozitarit, ky i fundit duhet të jetë në gjendje të çlirohet nga përgjegjësia, me kusht që: rregullat ose instrumentet e përfshirjes së AIF-së përkatëse lejojnë shprehimisht këtë çlirim; investitorët janë informuar siç duhet për këtë çlirim dhe për rrethanat që justifikojnë shkarkimin përpara investimit të tyre; AIF-ja ose AIFM-ja që vepron në emër të AIF-së ka udhëzuar depozitarin të delegojë kujdestarinë e këtyre instrumenteve financiare te një subjekt lokal; ekziston një kontratë me shkrim ndërmjet depozitarit dhe AIF-së ose AIFM-së që vepron në emër të AIF-së, e cila lejon shprehimisht këtë çlirim; dhe ekziston një kontratë me shkrim ndërmjet depozitarit dhe palës së tretë, e cila transferon shprehimisht përgjegjësinë e depozitarit tek ajo palë e tretë dhe i mundëson AIF-së ose AIFM-së që vepron në emër të AIF-së, që të paraqesë një ankesë kundrejt palës së tretë në lidhje me humbjen e instrumenteve financiare, ose i mundëson depozitarit që të paraqesë një ankesë të tillë në emër të tyre.

47. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë asnjë masë të ardhshme legjislative në lidhje me depozitarin në Direktivën 2009/65/KE, sepse SIKTT-ja dhe AIF-të janë të ndryshme, qoftë në strategjitë e investimit që ato ndjekin, ashtu dhe në llojin e investitorëve për të cilët ato synohen.

48. Një AIFM, për çdo AIF të BE-së që ajo administron dhe për çdo AIF që ajo tregon në Bashkimin Evropian, duhet të vërë në dispozicion raportin vjetor të çdo viti ushtrimor, jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të vitit ushtrimor, në përputhje me këtë direktivë. Kjo periudhë 6 mujore nuk duhet të cenojë të drejtën e shteteve anëtare për të caktuar një periudhë më të shkurtër.

49. Duke qenë se AIFM-ja mund të përdorë efektin e levës financiare dhe, në kushte të caktuara, të kontribuojë për ndërtimin e rrezikut sistemik ose të tregjeve të parregullta, duhet të vendosen kërkesa e veçanta për AIFM-të që përdorin levën financiare. Informacioni që nevojitet për të zbuluar, monitoruar dhe për të reaguar ndaj këtyre rreziqeve nuk është mbledhur në mënyrë konsistente në të gjithë Bashkimin Evropian dhe nuk është ndarë në të gjitha shtetet anëtare, në mënyrë që të identifikohen burimet e mundshme të rrezikut ndaj qëndrueshmërisë së

tregjeve financiare në Bashkimin Evropian. Për të korigjuar këtë situatë, duhet të zbatohen kërkesa të veçanta për AIFM-të që përdorin efektin e levës financiare në një nivel të konsiderueshëm në nivel AIF-je. Këtyre AIF-ve duhet t'i kërkohej që të nxjerrin informacion në lidhje me nivelin e përgjithshëm të efektit të levës financiare të përdorur, efektin e levës financiare që lind nga huamarrja në mjete monetare ose në tituj dhe efektin e levës financiare që lind nga pozicionet e zotëruara në derivative, nga ripërdorimi i aktiveve dhe burimet kryesore të levës financiare në AIF-të e tyre. Informacioni i mbledhur nga autoritetet kompetente duhet të ndahet me autoritetet e tjera në Bashkimin Evropian, me ESMA-n dhe me Bordin Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB) i themeluar përmes Rregullores (BE) nr. 1092/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 nëntor 2010, "Për mbikëqyrjen makroprudenciale të sistemit financiar dhe për themelimin e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik", në mënyrë të atillë që të lehtësojë analizën kolektive të ndikimit të efektit të levës financiare të AIF-ve që administrohen nga AIFM-të, në sistemin financiar në Bashkimin Evropian dhe një reagim të përbashkët. Nëse një ose më shumë AIF të administruara nga një AIFM do të mund të përbënin një burim të rëndësishëm për rrezikun e kundërpalë në një institucion krediti ose në institucione të tjera me rëndësi sistemike në shtete të tjera anëtare, ky informacion gjithashtu duhet të ndahet me autoritetet përkatëse.

50. Me qëllim për të garantuar një vlerësim të përshtatshëm të rreziqeve të shkaktuara nga përdorimi i efektit të levës financiare nga AIFM-ja, në lidhje me AIF-të e administruara prej saj, AIFM-ja duhet të provojë se kufijtë e financimit për çdo AIF të administruar prej saj, janë të arsyeshme dhe se ajo i respekton këto kufij në çdo kohë. Kur stabiliteti dhe integriteti i sistemit financiar mund të vihet në rrezik, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së duhet të jenë në gjendje të vendosin kufij për nivelin e efektit të levës financiare që një AIFM mund të përdorë për AIF-të që ajo administron. ESMA dhe ESRB duhet të informohen rreth çdo veprimi të marrë në këtë kontekst.

51. Pas marrjes në konsideratë të këshillës së ESRB-së, konsiderohet gjithashtu e nevojshme që të lejohet që ESMA të përcaktojë se efektet e levës financiare që përdoren nga një AIFM ose nga një grup AIFM-sh përbëjnë rrezik të konsiderueshëm ndaj qëndrueshmërisë dhe integritetit të sistemit financiar dhe që të jepen këshilla për autoritetet kompetente, duke specifikuar masat korigjuese që duhen marrë.

52. Duhet që të garantohet se autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, shoqëritë e kontrolluara nga AIF-të e administruara nga AIFM-ja dhe punonjësit e këtyre shoqërive të marrin informacione të caktuara që i nevojiten këtyre shoqërive për të vlerësuar se si do të ndikojë ky kontroll në situatën e tyre.

53. Kur AIFM-të administrojnë AIF që ushtrojnë kontroll mbi një emetues, aksionet e të cilit pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, informacioni përgjithësisht duhet të nxirret në përputhje me Direktivën 2004/25/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, "Për ofertat e marrjes nën kontroll" dhe me Direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, "Për harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me informacionin për emetuesit titujt e të cilëve pranohen për tregim në një treg të rregulluar". Për AIFM-të që administrojnë AIF-të që ushtrojnë kontrollin mbi një shoqëri të parenditur duhet të zbatohen kërkesa specifike. Për të garantuar transparencë në lidhje me shoqërinë e kontrolluar, duhet të zbatohen kërkesa për rritjen e transparencës, nxjerrjen dhe raportimin e informacionit.

Për më tepër, raportet vjetore të AIF-ve përkatëse duhet të plotësohen në lidhje me shoqërinë e kontrolluar ose ky informacion shtesë duhet të përfshihet në raportin vjetor të shoqërisë së kontrolluar. Ky informacion duhet të vihet në dispozicion të përfaqësuesve të punonjësve ose, nëse nuk ka të tillë, të vetë punonjësve, dhe për investitorët e AIF-së përkatëse.

54. Kërkesat specifike për informacion që i drejtohen punonjësve të shoqërive të caktuara zbatohen në rastet kur AIF-të fitojnë kontrollin mbi këto shoqëri në përputhje me këtë direktivë. Gjithsesi, në shumicën e rasteve AIFM-ja nuk ka kontroll mbi AIF-në, përveçse kur ajo është një AIF me administrim të brendshëm. Gjithashtu, në përputhje me parimet e përgjithshme të ligjit për shoqëritë tregtare, nuk ekziston asnjë lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet aksionarëve dhe përfaqësuesve të punonjësve ose, në rastin kur nuk ka të tillë, ndërmjet aksionarëve dhe vetë punonjësve. Për këto arsye, në përputhje me këtë direktivë, për një aksionar ose administratorin e tij, përkatësisht AIF-në dhe AIFM-në, nuk mund të caktohet asnjë kërkesë e drejtpërdrejtë për informacionin rreth përfaqësuesve të punonjësve ose, nëse nuk ka të tillë, për vetë punonjësit. Në lidhje me kërkesat për informacion drejt këtyre përfaqësuesve të punonjësve ose, nëse nuk ka të tillë, për vetë punonjësit, kjo direktivë duhet të parashikojë detyrimin për AIFM-në përkatëse që të bëjnë përpjekjet maksimale për të garantuar që bordi i drejtuesve të shoqërisë përkatëse të bëjë publik informacionin përkatës për përfaqësuesit e punonjësve ose, nëse nuk ka të tillë, për vetë punonjësit.

55. Komisioni ftohet të shqyrtojë nevojën dhe mundësitë për të ndryshuar informacionin dhe kërkesat për nxjerrjen e tij, që zbatohen në rastet e kontrollit mbi shoqëritë e palistuar ose emetuesit e përcaktuar në këtë direktivë, në një nivel të përgjithshëm, pavarësisht llojit të investitorit.

56. Nëse një AIFM administron një ose më shumë AIF që marrin kontrollin e një shoqërie të palistuar, AIFM-ja duhet t'u sigurojë autoriteteve kompetente të shtetit të tij anëtar informacionin për financimin e blerjes. Ky detyrim për të dhënë informacion për financimin duhet të zbatohet edhe kur një AIFM administron AIF-të që marrin kontrollin mbi një emetues aksionesh që pranohet për të tregtuar në një treg rregulluar.

57. Kur një AIFM administron një ose më shumë AIF që marrin kontrollin mbi një shoqëri të palistuar ose një emetues, për një periudhë 24 mujore në vijim të marrjes së kontrollit të shoqërisë nga AIF-të, AIFM-ja, së pari, nuk duhet të lejohet të lehtësojë, të mbështesë ose të udhëzojë ndonjë shpërndarje, reduktim kapitali, të drejtë kompensimi për aksionet dhe/ose blerjet e aksioneve të veta nga shoqëria, në përputhje me këtë direktivë; së dyti, për aq kohë sa AIFM-ja autorizohet të votojë në emër të AIF-ve në mbledhjet e organeve qeverisëse të shoqërisë, ajo nuk duhet të votojë në favor të një shpërndarjeje, reduktimit të kapitalit, të të drejtave të kompensimit për aksionet dhe/ose të blerjes së aksioneve të veta nga shoqëria, në përputhje me këtë direktivë; dhe së treti, në çdo rast, ajo duhet të përpiqet maksimalisht për parandalimin e shpërndarjeve, të reduktimeve në kapital, të të drejtave të kompensimit për aksionet dhe/ose të blerjes së aksioneve të veta nga shoqëria, në përputhje me këtë direktivë. Gjatë transpozimit të kësaj direktive në legjislacionin e brendshëm, shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë qëllimin rregullator të dispozitave të seksionit 2 të kapitullit V të kësaj direktive dhe, në këtë kontekst, t'i kushtojnë vëmendjen e duhur nevojës për rregulla të barabarta loje ndërmjet AIF-ve të BE-së dhe AIF-ve jashtë BE-së gjatë marrjes së kontrollit në shoqëritë e themeluara në Bashkimin Evropian.

58. Kërkesat për njoftimin dhe nxjerrjen e informacionit dhe masat mbrojtëse specifike kundër shitjes pjesë pjesë të aktiveve në rastin e kontrollit mbi një shoqëri të palistuar ose një emetues duhet t'i nënshtrohet një përjashtimi të përgjithshëm për kontrollin mbi sipërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe mbi shoqëritë e qëllimit të veçantë, me qëllim blerjen, zotërimin ose administrimin e pasurisë së patundshme. Për më tepër, këto kërkesa nuk synojnë të bëjnë publik informacionin pronësor, i cili do ta vendoste AIFM-në në disavantazh kundrejt konkurrentëve të mundshëm, si fondet sovrane të pasurisë ose konkurrentët që mund të dëshirojnë që ta nxjerrin shoqërinë e synuar nga biznesi duke përdorur këtë informacion në avantazhin e tyre. Kështu, detyrimet për njoftimin dhe komunikimin e informacionit duhet të zbatohen sipas kushteve dhe kufizimeve në lidhje me informacionin konfidencial të përcaktuar në Direktivën 2002/14/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2002, që cakton kuadrin e përgjithshëm për njoftimin dhe këshillimin e punonjësve në Komunitetin Evropian, si dhe pa cenuar direktivat 2004/25/KE dhe 2004/109/KE. Kjo do të thotë se shtetet anëtare duhet të parashikojnë se, sipas limiteve dhe kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm, përfaqësuesit e punëmarrësve dhe cilido që i asiston ato, nuk janë të autorizuar t'u zbulojnë punëmarrësve dhe palëve të treta informacione që ndikojnë në interesin legjitim të ndërmarrjes, i cili u është dhënë shprehimisht në konfidencë. Megjithatë, shtetet anëtare mund t'i autorizojë përfaqësuesit e punëmarrësve dhe çdokënd që i asiston ata që t'u kalojnë informacion konfidencial punëmarrësve dhe palëve të treta, të cilët duhet t'i përmbahen detyrimin të ruajtjes së konfidencialitetit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që AIFM-të përkatëse të mos kërkojnë komunikimin e informacionit nga bordi i drejtuesve për përfaqësuesit e punonjësve ose, kur nuk ka të tillë, vetë punonjësit, kur natyra e informacionit është e tillë që, sipas kriterëve objektive, do të dëmtonte rëndë funksionimin e shoqërisë në fjalë ose do ta cenonte atë. Kërkesat për njoftimin dhe nxjerrjen e informacionit dhe masat mbrojtëse specifike ndaj shitjes pjesë pjesë të aktiveve duhet gjithashtu të zbatohet pa cenuar asnjë rregull më të rreptë të miratuar nga shtetet anëtare.

59. Kjo direktivë gjithashtu përcakton kushtet sipas të cilave AIFM-të e BE-së mund të tregtojnë njësitë ose aksionet e AIF-ve të BE-së për investitorët profesionistë në Bashkimin Evropian. Ky tregtim nga AIFM-të e BE-së duhet të lejohet, vetëm për aq kohë sa AIFM-ja pajtohet me këtë direktivë dhe tregtimi bëhet me një pasaportë, pa cenuar tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të që bien nën caqet e parashikuara në këtë direktivë. Shtetet anëtare mund të lejojnë tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të që bien nën këto caqe, sipas dispozitave kombëtare.

60. Njësitë ose aksionet e një AIF-je mund të listohen në një treg të rregulluar në Bashkimin Evropian, ose të ofrohen apo të vendosen nga palët e treta që veprojnë në emër të AIFM-së në një shtet anëtar të veçantë, vetëm nëse vetë AIFM-ja që administron AIF-në lejohet të tregtojë njësitë ose aksionet e AIF-së në këtë shtet anëtar. Gjithashtu, legjislacione të tjera brendshme dhe të Bashkimit Evropian, si Direktiva 2003/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 4 nëntor 2003, "Për prospektin që duhet të publikohet kur titujt ofrohen për publikun ose pranohen për tregtim" dhe Direktiva 2004/39/KE, gjithashtu mund të rregullojnë shpërndarjen e AIF-ve për investitorët në Bashkimin Evropian.

61. Shumë AIFM të BE-së aktualisht administrojnë AIF jashtë BE-së. Duhet që AIFM-të e autorizuar të BE-së të lejohen të menaxhojnë AIF jashtë BE-së pa i tregtuar atonë Bashkimin Evropian, pa vendosur për to kërkesa të rrepta depozitare dhe kërkesat në lidhje me raportin vjetor të parashikuar sipas kësaj direktive, duke qenë se këto kërkesa janë përfshirë për mbrojtjen e investitorëve të Bashkimit Evropian.

62. Pas hyrjes në fuqi të një akti të deleguar të miratuar nga Komisioni në këtë drejtim, i cili parimisht, duke marrë në konsideratë këshillën e ofruar nga ESMA, hyn në fuqi 2 vjet pas përfundimit të afatit për transpozimin e kësaj direktive, AIFM-të e autorizuar të BE-së që synojnë të tregtojnë AIF-të jashtë BE-së për investitorët profesionistë në shtetin anëtar të origjinës së tyre dhe/ose në shtetet e tjera anëtare, duhet të lejohen ta bëjnë diçka të tillë me një pasaportë ose për aq kohë sa ata veprojnë në pajtim me këtë direktivë. Kjo e drejtë duhet t'i nënshtrohet procedurave të njoftimit dhe kushteve në lidhje me vendin e tretë të AIF-së jashtë BE-së.

63. Gjatë periudhës kalimtare, e cila parimisht, duke marrë në konsideratë këshillën e ESMA-s, mund të përfundojë nëpërmjet një akti të deleguar 3 vjet pas vendosjes së pasaportës për AIFM-të jashtë BE-së, AIFM-të e BE-së që synojnë të tregtojnë AIF jashtë BE-së në disa shtete anëtare, por pa një pasaportë, duhet gjithashtu që të lejohen nga shtetet anëtare përkatëse që ta bëjnë diçka të tillë, por vetëm për aq kohë sa ata veprojnë në pajtim me këtë direktivë, me përjashtim të kërkesave për depozitarin. Megjithatë, këto AIFM të BE-së duhet të garantojnë që emërohen një ose më shumë subjekte për të kryer detyrat e depozitarit. Përveç kësaj, marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit për qëllimet e mbikëqyrjes së rrezikut sistemik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare duhet të vendosen ndërmjet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, me qëllim që të garantohet shkëmbimi efikas i informacionit që u lejon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së që të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë. Marrëveshjet e bashkëpunimit nuk duhet të përdoren si barrierë për të penguar tregtimin e AIF-ve jashtë BE-së në një shtet anëtar. Gjithashtu, vendi i tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së nuk duhet të renditen si një shtet apo territor jobashkëpunues nga Task Forca e Veprimtë Financiar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (FATF).

64. Pas hyrjes në fuqi të një akti të deleguar që miratohet nga Komisioni në këtë aspekt, i cili parimisht, duke marrë në konsideratë këshillën e dhënë nga ESMA, hyn në fuqi 2 vjet pas përfundimit të afatit për transpozimin e kësaj direktive, parimi bazë i kësaj direktive duhet të jetë që një AIFM jashtë BE-së duhet të përfitojë nga të drejtat e akorduara sipas kësaj direktive, siç është tregtimi i njësisë ose aksioneve të AIF-ve në të gjithë Bashkimin Evropian me një pasaportë, në pajtim me këtë direktivë. Kjo duhet të garantojë rregulla të barabarta loje ndërmjet AIFM-ve të BE-së dhe jashtë BE-së. Për rrjedhojë, kjo direktivë parashikon një autorizim të zbatueshëm për AIFM-të jashtë BE-së, i cili gjen zbatim pas hyrjes në fuqi të aktit të deleguar që miratohet në këtë drejtim nga Komisioni. Për të garantuar zbatimin e kësaj pajtueshmërie, autoritetet kompetente të një shteti anëtar duhet të zbatojnë pajtueshmërinë me këtë direktivë. Për këto AIFM jashtë BE-së, autoritetet mbikëqyrëse kompetente duhet të jenë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës, siç përcaktohet në këtë direktivë.

65. Kështu, në rastin kur AIFM-ja jashtë BE-së synon të administrojë AIF-të e BE-së dhe/ose të tregtojë AIF-të në Bashkimin Evropian me një pasaportë, asaj gjithashtu duhet t'i kërkohet pajtueshmëria me këtë direktivë, në mënyrë që t'i nënshtrohet të njëjtave detyrime me ato të AIFM-ve të BE-së. Në rrethana tepër të veçanta, në rastin kur dhe deri në masën që pajtueshmëria me një dispozitë të kësaj direktive nuk përputhet me pajtueshmërinë me legjislacionin të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së, që tregtohet në Bashkimin Evropian, duhet të parashikohet mundësia që AIFM-ja jashtë BE-së të përjashtohet

nga pajtueshmëria me dispozitën përkatëse të kësaj direktive, nëse ajo mund të vërtetohet se mund të kombinohet pajtueshmëria me një dispozitë të kësaj direktive me pajtueshmërinë me një dispozitë të detyrueshme të legjislacionit të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së që tregtohet në Bashkimin Evropian; legjislacioni të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së parashikon një rregull ekuivalent që ka të njëjtin qëllim rregullator dhe ofron të njëjtin nivel mbrojtjeje për investitorët e AIF-së përkatëse; dhe se AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së vepron në pajtim me rregullin e barasvlershëm.

66. Gjithashtu, një AIFM jashtë BE-së që synon të administrojë AIF-të e BE-së dhe/ose të tregtojë AIF-të në Bashkimin Evropian me një pasaportë duhet të veprojë në pajtim me një procedurë specifike autorizimi dhe duhet të përmbushë disa kërkesa të caktuara në lidhje me vendin e tretë të AIFM-së jashtë BE-së dhe, sipas rastit, me vendin e tretë të AIF-së jashtë BE-së.

67. ESMA duhet të ofrojë këshilla në lidhje me përcaktimin e shtetit anëtar të referencës dhe, sipas rastit, përjashtimin lidhur me përputhjen me rregulloren e barasvlershme. Kërkesat specifike për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së duhet të gjejnë zbatim. Gjithashtu, procedura e ndërmjetësimit që parashikohet në nenin 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010 duhet të zbatohet në rastin e mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare për përcaktimin e shtetit anëtar të referencës, zbatimit të përjashtimit në rastin e mospërputhshmërisë ndërmjet pajtueshmërisë me këtë direktivë dhe asaj me rregullat e barasvlershme të një vendi të tretë, dhe në rastin e vlerësimit në lidhje me përmbushjen e kërkesave specifike në lidhje me vendin e tretë të AIFM-së jashtë BE-së dhe, sipas rastit, me vendin e tretë të AIF-së jashtë BE-së.

68. ESMA, çdo vit, duhet të analizojë rishikimin e veprimtarive mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente, në lidhje me autorizimin dhe mbikëqyrjen e AIFM-ve jashtë BE-së, për të përmirësuar më tej konsistencën e rezultateve të mbikëqyrjes, në përputhje me nenin 30 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

69. Gjatë periudhës kalimtare, e cila në parim, duke marrë në konsideratë këshillën e ESMA-s, mund të përfundojë nëpërmjet një akti të deleguar, 3 vite pas themelimit të pasaportës për AIFM-të jashtë BE-së, një AIFM jashtë BE-së që synon të tregtojë AIF-të vetëm në disa shtete anëtare dhe pa këtë pasaportë, duhet të lejohet nga shtetet anëtare përkatëse që ta bëjë diçka të tillë por vetëm për aq kohë sa përmbushen disa kushte minimale të caktuara. Këto AIFM jashtë BE-së duhet t'i nënshtrohen të paktën rregullave të ngjashme me ato që zbatohen për AIFM-të e BE-së që administrojnë AIF-të e BE-së në lidhje me zbulimin e informacionit për investitorët. Për të lehtësuar monitorimin e rrezikut sistemik, këto AIFM jashtë BE-së duhet gjithashtu t'i nënshtrohen detyrimeve të raportimit përpara autoriteteve kompetente të shtetit anëtar ku tregtohet AIF-ja. Për rrjedhojë, këto AIFM duhet të veprojnë në pajtim me kërkesat për transparencë që përcaktohen në këtë direktivë dhe me detyrimet për AIFM-të administruese të AIF-ve që fitojnë kontrollin e shoqërive dhe emetuesve të palistuar. Gjithashtu, ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku tregtohen AIF-të, nëse është e zbatueshme, autoriteteve kompetente të AIF-ve përkatëse të BE-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIFM-ja jashtë BE-së, dhe, nëse është e zbatueshme, autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, duhet të lidhen marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit për qëllimet e mbikëqyrjes së rrezikut sistemik dhe në

përputhje me standardet ndërkombëtare me qëllim që të garantojnë shkëmbimin efikas të informacionit që u lejon autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë. Marrëveshjet e bashkëpunimit nuk duhet të përdoren si barrierë për të penguar tregtimin e fondeve të vendeve të treta në një shtet anëtar. Së fundmi, vendi i tretë ku është themeluar AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së nuk duhet të renditen si shtet dhe territor jobashkëpunues nga FATF.

70. Kjo direktivë nuk duhet të ndikojë në gjendjen aktuale, sipas të cilës një investitor profesionist i themeluar në Bashkimin Evropian mund të investojë në AIF-të me nismën e tij, pavarësisht vendit të themelimit të AIFM-së dhe/ose të AIF-së.

71. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të lejojnë tregtimin e të gjitha AIF-ve ose për lloje të caktuara të tyre që administrohen nga AIFM-të për investitorët e shitjeve me pakicë në territorin e tyre. Nëse një shtet anëtar lejon tregtimin e llojeve të caktuara të AIF-ve, shteti anëtar duhet të kryejë vlerësimin rast pas rasti, për të përcaktuar nëse një AIF specifike duhet të konsiderohet si një lloj AIF-je që mund të tregtohet për investitorët në tregun me pakicë në territorin e tij. Pa cenuar zbatimin e instrumenteve të tjera të legjislacionit të Bashkimit Evropian, shtetet anëtare, në këto raste, duhet të jenë në gjendje të vendosin kërkesa më të rrepta për AIF-të dhe AIFM-të si një parakusht për tregtimin për investitorët e shitjeve me pakicë, krahasuar me rastin kur AIF-të tregtohen për investitorët profesionistë në territorin e tyre, pavarësisht nëse këto AIF tregtohen brenda vendit ose në një hapësirë ndërkufitare. Nëse një shtet anëtar lejon tregtimin e AIF-ve për investitorët në territorin e tij, kjo mundësi duhet të vihet në dispozicion, pavarësisht shtetit anëtar ku është themeluar AIFM-ja që administron AIF-në, dhe shtetet anëtare nuk duhet të vendosin kërkesa më të rrepta ose shtesë për AIF-të e BE-së të themeluara në një shtet tjetër anëtar dhe që tregtohen në një hapësirë ndërkufitare, krahasuar me ato që vendosen për AIF-të e tregtuara brenda vendit. Gjithashtu, AIFM-të, shoqëritë e investimit që autorizohen sipas Direktivës 2004/39/KE dhe institucionet e kreditit që autorizohen sipas Direktivës 2006/48/KE që ofrojnë shërbime investimit për klientët në tregut me pakicë, duhet të marrin në konsideratë çdo kërkesë shtesë kur vlerësojnë nëse një AIF e caktuar është e përshtatshme për një klient individual të tregut të pakicës apo nëse ai është një instrument financiar kompleks ose jo kompleks.

72. Duhet që të sqarohen kompetencat dhe detyrat e autoriteteve kompetente përgjegjëse për zbatimin e kësaj direktive si edhe të forcohen mekanizmat e nevojshëm për të garantuar një bashkëpunim efikas ndërkufitar në fushën e mbikëqyrjes. Sipas rrethanave të caktuara, duhet që autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse të një AIFM-je të kenë mundësi të ndërmarrin veprime të drejtpërdrejta për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me dispozitat për të cilat ata janë përgjegjës. Për dispozitat e tjera, autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse duhet, në rrethana të caktuara, të lejohen të kërkojnë veprimin nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe të ndërhyjnë nëse nuk ndërmerret një veprim i tillë.

73. Kjo direktivë parashikon një rol të përgjithshëm koordinues për ESMA-n dhe mundësinë për procedura ndërmjetësuese detyruese, të kryesuara nga ESMA, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve kompetente.

74. ESMA duhet të përgatisë draftin e standardeve teknike rregullatore për përmbajtjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit që duhet të lidhen nga shteti anëtar i origjinës ose shteti anëtar i

referencës së AIFM-së dhe autoritetet mbikëqyrëse përkatëse të vendit të tretë dhe për procedurat për shkëmbimin e informacionit. Draft standardet rregullatore teknike duhet të garantojnë që, në përputhje me këto marrëveshje bashkëpunimi, duhet të jepet gjithë informacioni i nevojshëm për t'i lejuar autoriteteve kompetente, si të shtetit anëtar të origjinës, ashtu dhe atij pritës, që të ushtrojnë kompetencat mbikëqyrëse dhe hetuese sipas kësaj direktive. ESMA gjithashtu duhet të luajë një rol lehtësues për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Për shembull, ESMA mund të përmbushë rolin e saj lehtësues duke parashikuar një format standard për këto marrëveshje bashkëpunimi.

75. Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë rregullat për sanksionet e zbatueshme për shkeljen e kësaj direktive dhe të sigurohen që ato zbatohen. Sanksionet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese.

76. Kjo direktivë respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura, në veçanti, në TFBE-në dhe në Kartën e Të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta), në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale që njihen në nenin 16 të TFBE-së dhe në nenin 8 të Kreut. Çdo shkëmbim ose transmetim i informacionit nga autoritetet kompetente duhet të bëhet në përputhje me rregullat për transferimin e të dhënave personale, siç përcaktohen në Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 tetor 1995, "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe me lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave". Çdo shkëmbim ose transmetim i informacionit nga ESMA duhet të bëhet në përputhje me rregullat për transferimin e të dhënave personale, siç përcaktohen në Rregulloren (KE) nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 dhjetor 2000, "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet Komunitare, si dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"¹⁹, të cilat duhet të zbatohen plotësisht për përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e kësaj direktive.

77. Për të siguruar kushte të njëtrajtshme për implementimin e kësaj direktive, kompetencat zbatuese duhet t'i akordohen Komisionit. Këto kompetenca duhet të ushtrohen sipas Rregullores (BE) nr. 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2011, "Për përcaktimin e rregullave dhe parimeve të përgjithshme për mekanizmat e kontrollit nga shtetet anëtare për ushtrimin e kompetencave zbatuese nga Komisioni".

78. Komisioni ka kompetencën të miratojë aktet e deleguara në përputhje me nenin 290 të TFBE-së, në rastin kur shprehimisht parashikohet në këtë direktivë. Në veçanti, Komisionit duhet të marrë kompetencën për të miratuar aktet e deleguara për të specifikuar metodat e financimit siç përcaktohet në këtë direktivë, duke përfshirë çdo strukturë financiare dhe/ose ligjore, që përfshin palë të treta të kontrolluara nga AIF-ja përkatëse, kur këto struktura janë ngritur posaçërisht për të krijuar, direkt ose indirekt, efekte të levës financiare në nivel AIF-je. Veçanërisht për kapitalin privat dhe fondet e kapitalit, kjo tregon se efekti ekzistues i levës financiare në nivel të një shoqërie portofoli nuk synohen të përfshihen kur përmenden këto struktura financiare apo ligjore.

79. Gjithashtu, duhet të miratohen aktet e deleguara që specifikojnë mënyrën e llogaritjes së caqeve për regjimin më të butë dhe mënyrën e trajtimit të AIFM-ve, aktivet e të cilave administrohen, duke përfshirë çdo aktiv të blerë përmes përdorimit të efektit të levës financiare, në të njëjtin vit kalendarik, ndonjëherë tejkalojnë dhe/ose bien nën cakun përkatës; që

specifikojnë detyrimet për regjistrimin e AIFM-ve që bien nën këto caqe dhe për të dhënë informacion me qëllim për të monitoruar me efikasitet rrezikun sistematik dhe detyrimin që këto AIFM të njoftojnë autoritetet kompetente përkatëse, në rastin kur ato nuk përmbushin më kushtet për zbatimin e një regjimi më të zbutur.

80. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të qartësuar metodat për lëvrimin e fondeve, duke përfshirë çdo strukturë financiare dhe/ose ligjore që përfshijnë palët e treta të kontrolluara nga AIF-ja përkatëse dhe mënyrën e llogaritjes së efektit të levës financiare; për të specifikuar rreziqet që duhet të mbulohen nga fondet e veta shtesë ose sigurimin ndaj shpërblimeve profesionale, kushtet për përcaktimin e përshtatshmërisë së fondeve të veta shtesë ose mbulimin e sigurimit ndaj rreziqeve profesionale, si dhe mënyrën e përcaktimit të përshtatjeve të vazhdueshme të fondeve vetjake shtesë ose të mbulimit të sigurimit ndaj shpërblimeve profesionale. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar kriteret që duhet të përdorin autoritetet kompetente për të vlerësuar nëse AIFM-të veprojnë në pajtim me detyrimet e tyre për sa i përket zhvillimit të veprimtarive, detyrimin të tyre për të vepruar në interesin më të lartë të AIF-ve ose investitorëve të AIF-ve që ata administrojnë dhe integritetit të tregut; krijimi dhe përdorimi efikas i burimeve dhe procedurave të nevojshme për zhvillimin e përshtatshëm të veprimtarive të tyre të biznesit; të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të shmangur konfliktet e interesit dhe, kur këto konflikte nuk mund të shmangen, për të dëshmshpërblyer, administruar dhe monitoruar, dhe sipas rastit, për t'i bërë publike këto konflikte interesi me qëllim që të parandalojnë ndikimin e tyre negativ në interesat e AIF-ve dhe investitorëve të tyre dhe për të garantuar se AIF-të që ata administrojnë trajtohen me ndershmëri; për të vepruar në pajtim me të gjitha kërkesat rregullatore që zbatohen për zhvillimin e veprimtarive të tyre të biznesit me qëllim që të mbështesin interesat më të larta të AIF-ve ose investitorëve të AIF-ve që ata administrojnë dhe integritetit të tregut; dhe për t'i trajtuar të gjithë investitorët e AIF-së me ndershmëri.

81. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar llojin e konflikteve të interesit që AIFM-të duhet të identifikojnë, si edhe hapat e arsyeshme që AIFM-të priten që të ndërmarrin në lidhje me strukturat dhe procedurat organizative dhe administrative, me qëllim identifikimin, parandalimin, administrimin, monitorimin dhe zbulimin e konflikteve të interesit. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar funksionet e menaxhimit të rrezikut që duhet të përdoren; shpeshhtësinë e përshtatshme të rishikimit të sistemit të menaxhimit të rrezikut; mënyrën se si duhet të ndahet funksioni i menaxhimit të rrezikut nga pikëpamja funksionale dhe hierarkike nga njësitë operative, duke përfshirë funksionin administrimit të portofolit; masat mbrojtëse specifike kundër konflikteve të interesit; dhe kërkesat për menaxhimin e rrezikut që duhet të përdoren nga AIFM-të. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar sistemet e administrimit të likuiditetit dhe procedurat që AIFM-të duhet të përdorin, si dhe harmonizimin e strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe të politikës së kompensimit. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar kërkesat që iniciuesit, sponsorët dhe huadhënësit fillestarë të instrumenteve të titullzuara duhet të përmbushin me qëllim që një AIFM të lejohet të investojë në këto instrumente të emetuara pas datës 1 janar 2011.

82. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar kërkesat që AIFM-të duhet të plotësojnë kur investojnë në këto instrumente titullzimi; për të specifikuar procedurat administrative dhe kontabël, marrëveshjet e kontrollit dhe të mbrojtjes për përpunimin e të

dhënave elektronike dhe mekanizmat e përshtatshëm të kontrollit të brendshëm; për të specifikuar procedurat për vlerësimin e duhur të aktiveve dhe të llogaritjes së vlerës neto të aktiveve për njësi ose aksion të AIF-së, garancitë profesionale që vlerësuesi i jashtëm duhet të jetë në gjendje të paraqesë, si dhe shpeshhtësinë e vlerësimeve të përshtatshme për AIF-të e hapura.

83. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar kushtet sipas të cilave duhet të miratohet delegimi i funksioneve të AIFM-së dhe kushtet sipas të cilave AIF-ja ka deleguar funksionet e saj deri në masën që ajo është kthyer në një subjekt që ekziston vetëm si emër dhe nuk mund të konsiderohet më si administrues i AIF-së; për sa i përket depozitarëve, për të specifikuar kriteret për të vlerësuar se rregullimi dhe mbikëqyrja e kujdesshme e shteteve të treta ku janë themeluar depozitarët ka të njëjtën fuqi si legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe zbatohen me efikasitet, veçantitë që duhet të përfshihen në marrëveshjen standarde, kushtet për përmbushjen e funksioneve të depozitarit, duke përfshirë llojin e instrumenteve financiare që duhet të përfshihen në objektin e detyrave të kujdestarisë së depozitarit, kushtet sipas të cilave depozitari mund të ushtrojë detyrat e tij të kujdestarisë për instrumentet financiare të regjistruara tek një depozitar qendrore dhe kushtet sipas të cilave depozitari duhet të ruajë instrumentet financiare të emetuara në një formë nominative dhe të regjistruara tek një emetues ose regjistruues, detyrat e depozitarit që kryhen me kujdesin e duhur, ndarjen e detyrimeve, kushtet sipas të cilave dhe rrethanat në të cilat instrumentet financiare që mbahen në kujdestari duhet të konsiderohen si të humbura, çfarë duhet të nënkuptohet me ngjarje të jashtme përtej kontrollit të arsyeshëm, pasojat e të cilave do të ishin të pashmangshme pavarësisht të gjitha përpjekjeve të arsyeshme për të kundërtën, dhe kushtet sipas të cilave dhe rrethanave në të cilat ekziston një arsye objektive për të parashikuar në kontratë çlirimin nga përgjegjësia. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar përmbajtjen dhe formatin e raportit vjetor që AIFM-të duhet të vënë në dispozicion për çdo AIF që ato administrojnë, si dhe për të specifikuar detyrimet e AIFM-ve për t'i bërë publik informacionin investitorëve dhe kërkesat për raportim tek autoritetet kompetente, si dhe për shpeshhtësinë e tyre.

84. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar se kur efekti i levës financiare konsiderohet se është përdorur në një nivel të konsiderueshëm dhe parimet që duhet të përdorin autoritetet kompetente kur mendojnë të vendosin kufij për nivelin e burimeve të lëvruara që një AIFM mund të zbatojë. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar marrëveshjet e bashkëpunimit në lidhje me AIFM-të jashtë BE-së dhe/ose me AIF-të jashtë BE-së, me qëllim hartimin e një kuadri të përbashkët për të lehtësuar lidhjen e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta. Aktet e deleguara gjithashtu duhet të miratohen për të specifikuar përmbajtjen e informacionit të shkëmbyer në lidhje me AIFM-të ndërmjet autoriteteve kompetente dhe me sigurimin e informacionit të caktuar për ESMA-n.

85. Në varësi të këshillës së ESMA-s në këtë drejtim dhe të kriterëve të përcaktuara në këtë direktivë, një akt i deleguar gjithashtu duhet të miratohet, me qëllim që të përfshijë në pasaportë AIFM-të e BE-së që tregtojnë AIF-të jashtë BE-së në Bashkimin Evropian dhe AIFM-të jashtë BE-së që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF-të në Bashkimin Evropian, si dhe duhet të miratohet një akt tjetër i deleguar për të ndërprerë zbatimin e regjimeve kombëtare të alokimit direkt në këtë drejtim.

86. Parlamenti Evropian dhe Këshillit duhet të kenë 3 muaj kohë nga data e njoftimit për të kundërshtuar një akt të deleguar. Me iniciativën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit, duhet të ekzistojë mundësia për ta shtyrë këtë periudhë me 3 muaj, në lidhje me zonat përkatëse me ndikim të konsiderueshëm. Gjithashtu, Parlamenti Evropian dhe Këshilli duhet të kenë mundësi të informojnë institucionet e tjera për synimin e tyre për të mos paraqitur kundërshtime. Sipas rastit, ky miratim i hershëm i akteve të deleguara ka rëndësi të veçantë në rastet kur duhet të respektohen afatet, për shembull, për t'i lejuar shteteve anëtare që të transpozojnë aktet e deleguara brenda periudhës së transpozimit të përcaktuar në direktivë.

87. Në deklaratën për nenin 290 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian, bashkëlidhur si shtojcë në Aktin Përfundimtar të Konferencës Ndërqeveritare, që miratoi Traktatin e Lisbonës, Konferenca mbajti shënim qëllimin e Komisionit për t'u konsultuar me ekspertët e emëruar nga shtetet anëtare për të përgatitur draftin e akteve të deleguara në fushën e shërbimeve financiare, në përputhje me praktikën e themeluar.

88. 2 vjet pas përfundimit të afatit për transpozimin e kësaj direktive, ESMA duhet të nxjerrë një opinion për funksionimin e pasaportës në fuqi, dhe për funksionimin e regjimeve kombëtare të alokimit direkt. Gjithashtu, ajo duhet të japë këshilla që në pasaportë të përfshihen edhe AIFM-të e BE-së që tregtojnë AIF-të jashtë BE-së në Bashkimin Evropian dhe AIFM-të jashtë BE-së që administrojnë AIF-të në Bashkimin Evropian. Komisioni duhet të miratojë një akt të deleguar, brenda 3 muajve pas marrjes së opinionit dhe këshillës nga ESMA dhe duke marrë në konsideratë kriteret e renditura në, dhe objektivat e kësaj direktive, ndër të tjera, lidhur me tregun e brendshëm, mbrojtjen e investitorit dhe monitorimin efikas të rrezikut sistematik, duke specifikuar datën në të cilën rregullat në lidhje me zgjerimin e pasaportës, që parashikohen në këtë direktivë, duhet të gjejnë zbatim në të gjitha shtetet anëtare.

89. Në Samitin e Londrës të prillit 2009, liderët e G20-s ranë dakord që fondet e mbrojtura nëpërmjet ndarjes dhe administratorët e tyre duhet të regjistrohen dhe atyre duhet t'u kërkohet që të nxjerrin vazhdimisht informacione për mbikëqyrësit dhe rregullatorët. Ato duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes për të garantuar se ruajnë një administrim të përshtatshëm të rrezikut. Në qershor 2010, liderët e G20-s në Toronto rikonfirmuan angazhimin e tyre dhe gjithashtu u angazhuan për të përsheptuar zbatimin e masave të forta për të përmirësuar transparencën dhe mbikëqyrjen rregullatore të fondeve të mbrojtura përmes ndarjes në nivel ndërkombëtar dhe në një mënyrë konsistente dhe jodiskriminuese. Në mbështetje të objektivave të G20-s, Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve miratoi parimet e nivelit të lartë për mbikëqyrjen e fondeve të mbrojtura përmes ndarjes në qershor 2009, për të udhëzuar zhvillimin e rregullores ndërkombëtare konsistente në këtë fushë. Më 16 shtator 2010, Këshilli i Evropës pranoi se Evropa duhet të nxisë më me vendosmëri interesin dhe vlerat e saj në një frymë reciprociteti dhe të përfitimit të ndërsjellë në kontekstin e marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit Evropian dhe se ajo duhet të ndër marrë hapa për të garantuar, ndër të tjera, qasje më të madhe në treg për bizneset evropiane dhe për të thelluar bashkëpunimin rregullator me partnerët tregtarë kryesorë. Komisioni do të përpiqet të garantojë se këto angazhime zbatohen në një mënyrë të ngjashme edhe nga partnerët ndërkombëtarë të Bashkimit Evropian.

90. 3 vite pas hyrjes në fuqi të aktit të deleguar, sipas të cilit pasaporta duhet të zbatohet për të gjithë AIFM-të, ESMA duhet të nxjerrë një opinion për funksionimin e pasaportës në fuqi dhe për funksionimin e regjimeve kombëtare të alokimit direkt. Ajo, gjithashtu, duhet të japë

këshilla për përfundimin e këtyre regjimeve kombëtare. Komisioni duhet të miratojë një akt të deleguar brenda 3 muajve nga marrja e opinionit dhe këshillës nga ESMA, duke marrë në konsideratë kriteret e renditura në, dhe objektivat e kësaj direktive, që lidhen, ndër të tjera, me tregun e brendshëm, me mbrojtjen e investitorit dhe me monitorimin efikas të rrezikut sistematik, duke specifikuar datën në të cilën regjimet kombëtare të përmendura në këtë direktivë duhet të mos zbatohen më në të gjitha shtetet anëtare.

91. 4 vite pas afatit për transpozimin e kësaj direktive, në bazë të konsultimeve publike dhe duke marrë në konsideratë diskutimet me autoritetet kompetente, Komisioni duhet të nisë të rishikojë zbatimin dhe fushën e zbatimit të kësaj direktive. Ky rishikim duhet të analizojë përvojën e fituar në zbatimin e kësaj direktive, ndikimin e saj tek investitorët, AIF-të ose AIFM-të në Bashkimin evropian dhenë vendet e treta dhe shkallën deri në të cilën janë arritur objektivat e kësaj direktive, duke propozuar ndryshimet e përshtatshme, nëse nevojiten. Ky rishikim duhet të përfshijë një vërtetim të përgjithshëm për funksionimin e rregullave të përcaktuara në këtë direktivë dhe për eksperiencën e fituar në zbatim të tyre. Komisioni, në rishikimin e tij, duhet të shqyrtojë funksionet e ESMA-s dhe të autoriteteve kompetente të Bashkimit Evropian në garantimin e mbikëqyrjes efikase të të gjitha AIFM-ve që operojnë në tregjet e Bashkimit Evropian, në kontekstin e kësaj direktive, duke përfshirë, ndër të tjera, në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1095/2010, transferimin e përgjegjësisë të mëtejshme mbikëqyrëse në fushën e autorizimit dhe mbikëqyrjes së AIFM-ve jashtë BE-së tek ESMA-s. Në këtë kontekst, Komisioni duhet të vlerësojë kostot dhe përfitimet në rastin kur këto detyra i besohen ESMA-s.

92. Kjo direktivë synon të themelojë një kuadër që mund të trajtojë rreziqet e mundshme që mund të shfaqen nga aktivitetet e AIFM-ve dhe të garantojnë monitorimin efikas të këtyre rreziqeve nga autoritetet kompetente brenda Bashkimit Evropian. Duhet të parashikohet një kuadër i rreptë rregullator dhe mbikëqyrës, që nuk lë boshllëqe në rregullimin financiar. Në këtë aspekt, vendosen referenca për kërkesat ekzistuese për kujdesin e përshtatshëm, që zbatohen për investitorët profesionistë, në përputhje me rregulloren përkatëse që zbatohet për këta investitorë. Komisioni ftohet të rishikojë legjislacionin përkatës në lidhje me investitorët profesionistë, me qëllim që të vlerësojë nevojën për kërkesa më të rrepta në lidhje me procesin e kujdesit të përshtatshëm që duhet të ndërmerret nga investitorët profesionistë të Bashkimit Evropian që investojnë me iniciativën e tyre në produkte financiare jashtë BE-së, siç janë AIF-të jashtë BE-së.

93. Në fund të rishikimit të tij, Komisioni duhet t'i paraqesë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport, ku përfshin, sipas rastit, ndryshimet e propozuara dhe ku merr në konsideratë objektivat e kësaj direktive dhe ndikimet e mundshme mbi investitorët, AIF-të ose AIFM-të, në Bashkimin Evropian dhe në vendet e treta.

94. Meqenëse objektivat e kësaj direktive, konkretisht sigurimi i një niveli të lartë mbrojtjeje për investitorin duke përcaktuar një kuadër të përbashkët për autorizimin dhe mbikëqyrjen e AIFM-ve, nuk mund të arrihet në shkallën e duhur nga shtetet anëtare, siç tregohet nga mangësitë e rregulloreve dhe të mbikëqyrjes kombëtare ekzistuese të këtyre aktorëve, por mund të arrihet më mirë në nivel Bashkimi Evropian, Bashkimi Evropian mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit për Bashkimin Evropian. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, siç përcaktohet në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

95. Ndaj, direktivat 2003/41/KE dhe 2009/65/KE, Rregullorja (KE) nr. 1060/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, "Për agjencitë e vlerësimit të kredisë" dhe Rregullorja (BE) nr. 1095/2010 duhet të ndryshohen përkatësisht,

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo Direktivë përcakton rregullat për autorizimin, operimin e vazhdueshëm dhe transparencën e administruesve të fondeve alternative të investimit (AIFM-të), të cilët administrojnë dhe/ose tregtojnë fondet alternative të investimit (AIF-të) në Bashkimin Evropian.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni dhe me nenin 3, kjo direktivë zbatohet për:

a) AIFM-të e BE-së që administrojnë një ose më shumë AIF, pavarësisht faktit nëse AIF-të janë AIF të BE-së ose AIF jashtë BE-së;

b) AIFM-të jashtë BE-së që administrojnë një ose më shumë AIF të BE-së; dhe

c) AIFM-të jashtë BE-së që tregtojnë një ose më shumë AIF në Bashkimin Evropian, pavarësisht faktit nëse AIF-të janë AIF të BE-së ose AIF jashtë BE-së.

2. Për qëllime të paragrafit 1, nuk janë të rëndësishme faktet si më poshtë:

a) nëse AIF-ja i përket llojit të hapur ose të mbyllur;

b) nëse AIF-ja krijohet sipas ligjit të kontratave, të drejtës së trusteeve, statutit, ose në rastin e formave të tjera ligjore;

c) struktura ligjore e AIFM-ve.

3. Kjo direktivë nuk zbatohet për:

a) shoqëritë kontrolluese;

b) institucionet e pensioneve profesionale që mbulohen nga Direktiva 2003/41/KE, duke përfshirë, sipas rastit, subjektet e autorizuar përgjegjëse për administrimin e këtyre institucioneve dhe që veprojnë në emër të tyre, siç përmenden në nenin 2, paragrafi 1 të kësaj

direktive, ose administruesit e investimeve që emërohen në përputhje me nenin 19, paragrafi 1 të kësaj direktive, për aq kohë sa ata nuk administrojnë AIF-të;

c) institucionet multinacionale, si Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve, Fondi Evropian i Investimeve, Institucionet Evropiane Financiare të Zhvillimit dhe bankat dypalëshe të zhvillimit, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe institucione të tjera multinacionale dhe organizata ndërkombëtare të ngjashme, në rast se këto institucione ose organizata administrojnë AIF dhe për sa kohë që këto AIF veprojnë sipas interesit publik;

d) bankat qendrore kombëtare;

e) qeveritë kombëtare, rajonale dhe vendore, dhe organet ose institucionet e tjera që administrojnë fondet në mbështetje të sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe të pensionit;

f) skemat e pjesëmarrjes së punonjësve ose skemat e kursimeve të punonjësve;

g) subjektet e titullimit me qëllim të veçantë

4. Shtetet anëtare ndërmarrin hapat e nevojshme për të garantuar se AIFM-të e përmendura në paragrafin 1 veprojnë në çdo kohë në pajtim me këtë direktivë.

Neni 3

Përjashtimet

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për AIFM-të, për aq kohë sa ato administrojnë një ose më shumë AIF, investitorët e të cilave janë vetëm AIFM-ja ose shoqëritë mëmë ose filialet e AIFM-ve ose filiale të tjera të këtyre shoqërive mëmë, me kusht që asnjë prej këtyre investitorëve të mos jetë AIF.

2. Pa cenuar zbatimin e nenin 46, vetëm për paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni zbatohen për AIFM-të si më poshtë:

a) AIFM-të, të cilat drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, përmes një shoqërie, me të cilën AIFM-të lidhen përmes administrimit ose kontrollit të përbashkët, ose përmes një kontrolli direkt ose indirekt, administrojnë portofolat e AIF-ve, aktivet e të cilave, duke përfshirë çdo aktiv të blerë nëpërmjet efektit të levës financiare, në total nuk tejkalojnë cakun prej 100 milionë eurosh; ose

b) AIFM-të, të cilat direkt ose indirekt, nëpërmjet një shoqërie me të cilën AIFM-të lidhen nëpërmjet administrimit ose kontrollit të përbashkët, ose nëpërmjet një kontrolli direkt ose indirekt të konsiderueshëm, administrojnë portofolat e AIF-ve, aktivet e të cilave në total nuk tejkalojnë një cak prej 500 milionë eurosh kur portofolat e AIF-ve përbëhen nga AIF që nuk përdorin efektin e levës financiare dhe nuk mund të ushtrojnë të drejtat e kompensimit gjatë një periudhe 5-vjeçare në vijim të datës së investimit fillestar në secilën AIF.

3. Shtetet anëtare garantojnë se AIFM-të e përmendura në paragrafin 2, të paktën:

- a) i nënshtrohen regjistrimit tek autoritetet kompetente të shtetit të tyre anëtar;
- b) identifikojnë veten dhe AIF-të që ato administrojnë përpara autoriteteve kompetente të shtetit të tyre anëtar të origjinës, në kohën e regjistrimit;
- c) japin informacion për strategjitë e investimit të AIF-ve që ato administrojnë përpara autoriteteve kompetente të shtetit të tyre anëtar të origjinës, në kohën e regjistrimit;
- d) u japin rregullisht autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tyre informacion për instrumentet kryesore që ata tregtojnë dhe ekspozimet kryesore dhe përqendrimet më të rëndësishme të AIF-ve që ata administrojnë, me qëllim që t'i mundësojnë autoriteteve kompetente që të monitorojnë me efikasitet rrezikun sistemik; dhe
- e) njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tyre në rast se ata nuk përmbushin më kushtet e përmendura në paragrafin 2.

Ky paragraf dhe paragrafi 2 duhet të zbatohet pa cenuar asnjë rregull më të rreptë të miratuar nga shtetet anëtare, në lidhje me AIFM-të e përmendura në paragrafin 2.

Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të garantuar që, kur nuk përmbushen më kushtet e përcaktuara në paragrafin 2, AIFM-ja përkatëse aplikon për autorizim brenda 30 ditëve kalendarike, në përputhje me procedurat përkatëse që përcaktohen në këtë direktivë.

4. AIFM-të e përmendura në paragrafin 2 nuk përfitojnë nga asnjë e drejtë e dhënë sipas kësaj direktive, përveçse kur ata zgjedhin të aplikojnë për autorizim sipas kësaj direktive. Nëse AIFM-të aplikojnë për autorizim, kjo direktivë bëhet e zbatueshme në tërësinë e saj.

5. Komisioni miraton aktet zbatuese me qëllim për të specifikuar procedurat për AIFM-të që zgjedhin të aplikojnë për aplikim në zbatim të kësaj direktive, në përputhje me paragrafin 4. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

6. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

- a) mënyrat se si caqet e përmendur në paragrafin 2 duhet të llogariten dhe trajtimin e AIFM-ve që administrojnë AIF-të, aktive e të cilave, duke përfshirë çdo aktiv të fituar përmes përdorimit të efekteve të levës financiare, me raste tejkalojnë dhe/ose bien nën cakun përkatës, në të njëjtin vit kalendarik;

- b) detyrimin për t'u regjistruar dhe për të dhënë informacion në mënyrë që të lejohet monitorimi efikas i rrezikut sistemik, siç përcaktohet në paragrafin 3; dhe

- c) detyrimin për të njoftuar autoritetet kompetente siç përcaktohet në paragrafin 3.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj direktive, përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) "AIF-të" janë sipërmarrjet e investimit kolektiv, duke përfshirë seksionet e tyre të investimit, të cilat:

I. mbledhin kapital nga një numër investitorësh me qëllim që ta investojnë atë në përputhje me një politikë të përcaktuar investimi në përfitim të këtyre investitorëve; dhe

II. nuk kërkojnë autorizim në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2009/65/KE;

b) "AIFM-të" janë persona juridikë, veprimtaria e rregullt e të cilëve është administrimi i një ose më shumë AIF-ve;

c) "degë", në rastin kur lidhet me një AIFM, është vendi i biznesit, i cili është pjesë e një AIFM-je, që nuk ka personalitet juridik dhe që ofron shërbimet për të cilat është autorizuar AIFM-ja; të gjitha vendet e biznesit të themeluara në të njëjtin shtet anëtar nga një AIFM që ka zyrën e regjistruar në një shtet tjetër anëtar ose në një vend të tretë konsiderohen si një degë e vetme;

d) "interes i mbajtur" është pjesa e fitimit të AIF-së që shkon për AIFM-në si kompensim për administrimin e AIF-së dhe duke përjashtuar çdo pjesë të fitimit të AIF-së që shkon për AIFM-në si kthim i ndonjë investimi që AIFM-ja ka bërë për AIF-në;

e) "lidhjet e ngushta" është situata në të cilën dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur përmes:

I. pjesëmarrjes, konkretisht zotërimit, direkt ose përmes kontrollit, të 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të sipërmarrjes;

II. kontrollit, konkretisht marrëdhënies ndërmjet një shoqërie mëmë dhe një filiali, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës së Shtatë të Këshillit 83/349/KEE, datë 13 qershor 1983, "Për llogaritë e konsoliduara", ose një marrëdhënieje të ngjashme ndërmjet një personi fizik ose juridik dhe një sipërmarrjeje; për qëllimet e kësaj pike, filiali i një filiali gjithashtu konsiderohet si filial i shoqërisë mëmë të këtyre filialeve.

Situata kur dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë përgjithmonë të lidhur me të njëjtin person përmes një marrëdhënieje kontrolli, konsiderohet gjithashtu si një "lidhje e ngushtë" ndërmjet këtyre personave.

f) "autoritete kompetente" janë autoritetet kombëtare të shteteve anëtare që autorizohen me ligj ose me rregullore që të mbikëqyrin AIFM-të;

g) "autoritete kompetente" në lidhje me depozitarin janë:

I. nëse depozitari është institucion krediti i autorizuar sipas Direktivës 2006/48/KE, autoritetet kompetente siç përcaktohen në pikën 4 të nenin 4 të saj;

II. nëse depozitari është firmë investimi e autorizuar sipas Direktivës 2004/39/KE, autoritetet kompetente siç përcaktohen në pikën 22 të nenit 4, paragrafi 1 të saj;

III. nëse depozitari përfshihet në një kategori institucioni të përmendur në nenin 21, paragrafi 3, nënparagrafi i par, germa "c" të kësaj direktive, autoritetet kombëtare të shtetit anëtar të origjinës së tij, që autorizohen sipas ligjit ose rregullores që të mbikëqyrin këto kategori të institucioneve;

IV. nëse depozitari është një subjekt i përmendur në nënparagrafin e tretë të nenit 21, paragrafi 3 të kësaj direktive, autoritetet kombëtare të shtetit anëtar, në të cilin subjekti ka zyrën e regjistruar, dhe që autorizohen sipas ligjit ose rregullores për të mbikëqyrur këtë subjekt, ose organi zyrtar kompetent për regjistrimit ose mbikëqyrjen e këtij subjekti në përputhje me rregullat e sjelljes profesionale të zbatuara për to;

V. nëse depozitari emërohet si depozitar i një AIF-je jashtë BE-së, në përputhje me nenin 21, paragrafi 5, germa "b" të kësaj direktive, dhe nuk përfshihet në fushën e zbatimit të pikave I deri në IV të kësaj pike, autoritetet kombëtare përkatëse të vendit të tretë, në të cilin depozitari ka zyrën e regjistruar;

h) "autoritete kompetente të AIF-ve të BE-së" janë autoritetet kombëtare të një shteti anëtar që autorizohen me ligj ose me rregullore për të mbikëqyrur AIF-të;

i) "kontroll" është kontrolli, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 83/349/KEE;

j) "themeluar" nënkupton:

I. për AIFM-të, "me zyrë të regjistruar në";

II. për AIF-të, "të autorizuar ose të regjistruara në", ose, në rastin kur AIF-ja nuk është autorizuar ose regjistruar, "me zyrë të regjistruar në";

III. për depozitarët, "me zyrë të regjistruar ose degë në";

IV. për përfaqësuesit ligjorë që janë persona juridikë, "me zyrë të regjistruar ose degë në";

V. për përfaqësuesit ligjorë që janë persona fizikë, "me vendbanim në";

k) "AIF e BE-së" është:

I. një AIF e autorizuar ose e regjistruar në shtetit anëtar sipas legjislacionit të brendshëm të zbatueshëm; ose

II. një AIF që nuk është autorizuar ose regjistruar në shtetit anëtar, por ka zyrën e regjistruar dhe/ose selinë qendrore në një shtet anëtar;

l) "AIFM e BE-së" është AIFM-ja që ka zyrën e regjistruar në një shtet anëtar;

m) "AIF ushqyese" është AIF-ja që:

I. investon të paktën 85% të aktiveve të saj në njësitë ose aksionet e një AIF-je tjetër ("AIF-ja kryesore");

II. investon të paktën 85% të aktiveve të saj në më shumë se një AIF kryesore, kur këto AIF kryesore kanë strategji investimi identike; ose

III. ka një ekspozim prej të paktën 85% të aktiveve të saj në këtë AIF kryesore;

n) "instrument financiar" është instrumenti i përcaktuar në seksionin C të shtojcës I të Direktivës 2004/39/KE;

o) "shoqëri kontrolluese" është shoqëria me aksione në një ose më shumë shoqëri, qëllimi tregtar i së cilës është zhvillimi i strategjisë ose strategjive të biznesit, përmes filialeve të saj, shoqërive të lidhura ose pjesëmarrjeve, në mënyrë që të kontribuojë në vlerën e tyre afatgjatë, dhe që është një shoqëri që:

I. operon në llogarinë vetjake dhe aksionet e së cilës pranohet për t'u tregtuar në tregun e rregulluar në Bashkimin Evropian; ose

II. nuk themelohet për qëllimin kryesor të gjenerimit të kthimit të investimit për investitorët e tyre nëpërmjet tërheqjes së investimit nga filialet ose shoqëritë e lidhura, siç tregohet në raportin e saj vjetor ose në dokumente të tjera zyrtare;

p) "shtet anëtar i origjinës së AIF-së" është:

I. shteti anëtar, në të cilin AIF-ja autorizohet ose regjistrohet sipas legjislacionit të zbatueshëm të brendshëm, ose në rastin e autorizimeve ose regjistrimeve të shumëfishta, shteti anëtar në të cilin AIF-ja autorizohet ose regjistrohet për herë të parë; ose

II. nëse AIF-ja nuk është autorizuar dhe as regjistruar në një shtet anëtar, shteti anëtar në të cilin AIF-ja ka zyrën e saj të regjistruar dhe/ose atë qendrore;

q) "shtet anëtar i origjinës së AIFM-së" është shteti anëtar, në të cilin AIFM-ja ka zyrën e saj të regjistruar; për AIFM-të jashtë BE-së, të gjitha referencat për "shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së" në këtë direktivë lexohen si "shteti anëtar i referencës", siç parashikohet në kapitullin VII;

r) "shtet anëtar pritës i AIFM-së" është secili nga më poshtë:

I. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, në të cilin një AIFM e BE-së administron AIF-të e BE-së;

II. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, në të cilin një AIFM e BE-së tregon njësitë ose aksionet e një AIF-je të BE-së;

III. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, në të cilin një AIFM e BE-së tregon njësitë ose aksionet e një AIF-je jashtë BE-së;

IV. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i referencës, në të cilin një AIFM jashtë BE-së administron AIF-të e BE-së;

V. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i referencës, në të cilin një AIFM jashtë BE-së tregton njësitet ose aksionet një AIF-je të BE-së; ose

VI. shteti anëtar i ndryshëm nga shteti anëtar i referencës, në të cilin një AIFM jashtë BE-së tregton njësitet ose aksionet një AIF-je jashtë BE-së;

s) "kapitali themeltar" janë fondet e përmendura në nenin 57, paragrafi 1, germat "a" dhe "b" të Direktivës 2006/48/KE;

t) "emetues" është emetuesi sipas kuptimit të nenit 2, paragrafi 1, germa "d" të Direktivës 2004/109/KE, kur ky emetues e ka zyrën e regjistruar në Bashkimin Evropian dhe kur aksionet e tij pranohen për tregim në tregun e rregulluar, sipas kuptimit të nenit 4, paragrafi 1, pika (14) të Direktivës 2004/39/KE;

u) "përfaqësues ligjor" është personi fizik me vendbanim në Bashkimin Evropian ose personi juridik me zyrë të regjistruar në Bashkimin Evropian, dhe që caktohet shprehimisht nga një AIFM jashtë BE-së, vepron në emër të saj përpara autoriteteve, klientëve, organeve dhe kundërpalëve të AIFM-së jashtë BE-së në Bashkimin Evropian, në lidhje me detyrimet e AIFM-së jashtë BE-së në zbatim të kësaj direktive;

v) "efekti i levës financiare" është çdo metodë, përmes së cilës AIFM-ja rrit ekspozimin e AIF-së që ajo menaxhon, qoftë përmes huamarrjes në mjete monetare ose në tituj, ose efekti i levës financiare në pozicionet derivative ose përmes çdo mjeti tjetër;

w) "administrim i AIF-ve" është kryerja të paktën e funksioneve të administrimit të investimit, të përmendura në pikën 1, germa "a" ose "b" të shtojcës I, për një ose më shumë AIF;

x) "tregtim" është ofertimi direkt ose indirekt ose alokimi me iniciativën e AIFM-së, ose në emër të AIFM-së i njësive ose aksioneve të një AIF-je që ajo administron për ose me investitorët me vendbanim ose me zyrë të regjistruar në Bashkimin Evropian;

y) "AIF kryesore" është AIF-ja, në të cilën një AIF tjetër investon ose ka një ekspozim në përputhje me germën "m";

z) "shtet anëtar i referencës" është shteti anëtar i përcaktuar në përputhje me nenin 37, paragrafi 4;

aa) "AIF jashtë BE-së" është AIF-ja që nuk është AIF e BE-së;

ab) "AIFM jashtë BE-së" është AIFM-ja që nuk është AIFM e BE-së;

ac) "shoqëri e palistuar" është shoqëria me zyrë të regjistruar në Bashkimin Evropian, dhe aksionet e së cilës nuk pranohen për t'u tregtuar në tregun e rregulluar sipas kuptimit të nenit 4, paragrafi 1, pika 14 të Direktivës 2004/39/KE;

ad) "fonde të veta" janë fondet e veta, siç përmenden në nenet 56 deri në 67 të Direktivës 2006/48/KE;

ae) "shoqëri mëmë" është shoqëria mëmë sipas kuptimit të neneve 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE;

af) "broker primar" është një institucion krediti, një firmë investimi e rregulluar ose një subjekt tjetër, që i nënshtrohet rregullimit të kujdesshëm dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme, që ofron shërbime për investitorët profesionist, kryesisht për të financuar ose ekzekutuar transaksione të instrumenteve financiare si kundërpalë dhe që mund të ofrojë edhe shërbime të tjera, si klerimi dhe lëvrimi i i tregtimeve, shërbimet e kujdestarisë, huadhënia e titujve, teknologjia e përshtatur dhe ambientet e mbështetjes operationale;

ag) "investitor profesionist" është investitori që konsiderohet si klient profesionist ose, sipas kërkesës, mund të trajtohet si klient profesionist, sipas kuptimit të shtojcës II të Direktivës 2004/39/KE;

ah) "pjesëmarrje influencuese" është pjesëmarrja, direkte ose indirekte, në një AIFM, që përfaqëson 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës, në përputhje me nenet 9 dhe 10 të Direktivës 2004/109/KE, duke marrë në konsideratë kushtet në lidhje me agregimin e pjesëmarrjes së përcaktuar në nenin 12, paragrafët 4 dhe 5 të saj, ose që mundëson ushtrimin e një ndikimi influencues mbi administrimin e AIFM-së në të cilën bën pjesë pjesëmarrja;

ai) "përfaqësues të punonjësve" janë përfaqësuesit e punonjësve, siç përkufizohen në nenin 2, germa "e" të Direktivës 2002/14/KE;

aj) "investitori në tregun me pakicë" është investitori që nuk është investitor profesionist;

ak) "filial" është filiali, siç përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE;

al) "autoritete mbikëqyrëse" në lidhje me AIF-të jashtë BE-së janë autoritetet kombëtare të vendeve të treta, që autorizohen me ligj ose me rregullore për të mbikëqyrur AIF-të;

am) "autoritete mbikëqyrëse" në lidhje me AIFM-të jashtë BE-së janë autoritetet kombëtare të vendeve të treta që autorizohen me ligj ose me rregullore për të mbikëqyrur AIFM-të;

an) "subjekte titullzimi me qëllim të veçantë" janë subjektet, qëllimi i vetëm i të cilave është kryerja e titullzimit ose e titullzimeve, sipas kuptimit të nenit 1, paragrafi 2 të Rregullores (KE) nr. 24/2009 të Bankës Qendrore Evropiane, datë 19 dhjetor 2008, "Për statistikën e aktiveve dhe të pasiveve të korporatave të mjeteve financiare të angazhuara në transaksionet e titullzimit" dhe në veprimtari të tjera të përshtatshme për arritjen e këtij qëllimi;

ao) "SIKTT" është një sipërmarrje e investimeve kolektive të titujve të transferueshëm, e autorizuar në përputhje me nenin 5 të Direktivës 2009/65/KE.

2. Për qëllimet e germës "ad" të paragrafit 1 të këtij neni, nenet 13 deri në 16 të Direktivës 2006/49/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 qershor 2006, "Për

mjaftueshmërinë e kapitalit të firmave të investimit dhe institucioneve të kreditit", zbatohen rast pas rasti

3. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) metodat e financimit, siç përcaktohen në pikën V të paragrafit 1, duke përfshirë çdo strukturë financiare dhe/ose ligjore që përfshin palët e treta që kontrollohen nga AIF-ja përkatëse; dhe

b) mënyrën e llogaritjes së ndikimit të levës financiare.

4. Autoriteti Mbikëqyrës Evropian (Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve) (ESMA) përgatit draftin e standardeve teknike rregullatore për përcaktimin e llojeve të AIFM-ve, kur kjo lidhet me zbatimin e kësaj direktive, dhe për garantimin e kushteve të njëtrajtshme për zbatimin e kësaj direktive.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 5

Përcaktimi i AIFM-së

1. Shtetet anëtare duhet të garantojnë që çdo AIF e administruar brenda fushës së zbatimit të kësaj direktive të ketë një AIFM të vetme, që përgjigjet për garantimin e pajtueshmërisë me këtë direktivë. AIFM-ja është ose:

a) një administrues i jashtëm, i cili është personi juridik i caktuar nga AIF-ja ose në emër të AIF-së, dhe i cili, përmes këtij caktimi, përgjigjet për administrimin e AIF-së (AIFM e jashtme); ose

b) kur forma ligjore e AIF-së lejon administrimin e brendshëm dhe kur organi rregullator i AIF-së zgjedh të mos caktojë një AIFM të jashtëm, vetë AIF-ja, e cila më pas autorizohet si AIFM.

2. Në rastet kur AIFM-ja e jashtme nuk ka mundësi të garantojë pajtueshmërinë me kërkesat e kësaj direktive, për të cilën AIF-ja ose subjekti tjetër përgjigjet në emër të saj, ajo informon menjëherë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj dhe, aty ku është e zbatueshme, autoritetet kompetente të AIF-së së BE-së në fjalë. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së i kërkojnë AIFM-së që të marrë masat e nevojshme për të korrigjuar situatën.

3. Nëse vazhdon papajtueshmëria, pavarësisht hapave të ndërmarra që përmenden në paragrafin 2, dhe për aq kohë sa ajo lidhet me AIFM-në e BE-së ose AIF-në e BE-së, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së i kërkojnë AIF-së që të dorëhiqet si AIFM. Në këtë rast, AIF-ja nuk tregtohet më në Bashkimin Evropian. Në kjo lidhet me një AIFM jashtë

BE-së, që administron një AIF jashtë BE-së, AIF-ja nuk tregtohet më në Bashkimin Evropian. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së njoftojnë menjëherë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së.

KAPITULLI II

AUTORIZIMI I AIFM-VE

Neni 6

Kushtet për fillimin e veprimtarive si AIFM

1. Shtetet anëtare garantojnë se asnjë AIFM nuk administron AIF-të, përveç rastit kur ato autorizohen në përputhje me këtë direktivë.

AIFM-të e autorizuara në përputhje me këtë direktivë përmbushin në çdo kohë kushtet e autorizimit të përcaktuara në këtë direktivë.

2. Shtetet anëtare kërkojnë që asnjë AIFM e jashtme të mos angazhohet në veprimtari të ndryshme nga ato që përmenden në shtojcën I të kësaj direktive, dhe në administrimin shtesë të SIKTT-ve, që i nënshtrohen autorizimit sipas Direktivës 2009/65/KE.

3. Shtetet anëtare kërkojnë që asnjë AIF me administrim të brendshëm të mos angazhohet në veprimtari të ndryshme nga administrimi i brendshëm i kësaj AIF-je në përputhje me shtojcën I.

4. Duke deroguar nga paragrafi 2, shtetet anëtare mund të autorizojnë një AIFM të jashtme që të ofrojë shërbimet e mëposhtme:

a) administrimi i portofolave të investimeve, duke përfshirë ato në pronësi të fondeve të pensionit dhe të institucioneve të pensioneve profesionale, në përputhje me nenin 19, paragrafi 1 të Direktivës 003/41/KE, në përputhje me mandatet e dhëna nga investitorët në bazë diskrecionale, klient për klient;

b) shërbimet dytësore që përfshijnë:

I. këshilla investimi;

II. ruajtjen dhe administrimin në lidhje me aksionet ose njësitë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

III. marrjen dhe transmetimin e porosive në lidhje me instrumentet financiare.

5. AIFM-të nuk autorizohen sipas kësaj direktive për të ofruar:

a) vetëm shërbimet e përmendura në paragrafin 4;

b) shërbimet dytësore të përmendura në germën "b" të paragrafit 4, pa u autorizuar edhe për të ofruar shërbimet e përmendura në germën "a" të paragrafit 4;

c) vetëm veprimtaritë e përmendura në pikën 2 të shtojcës I; ose

d) shërbimet e përmendura në pikën 1, germa "a" të shtojcës I, pa ofruar gjithashtu shërbimet e përmendura në pikën 1, germa "b" të shtojcës I ose anasjelltas.

6. Neni 2, paragrafi 2 dhe nenet 12, 13 dhe 19 të Direktivës 2004/39/KE zbatohen për ofrimin e shërbimeve të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni, nga AIFM-të.

7. Shtetet anëtare i kërkojnë AIFM-ve që t'i dorëzojnë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tyre informacionin që ata kërkojnë për të monitoruar pajtueshmërinë, në çdo kohë, me kushtet e përmendura në këtë direktivë.

8. Firmave të investimit të autorizuara sipas Direktivës 2004/39/KE dhe institucioneve të kreditit të autorizuara sipas Direktivës 2006/48/KE nuk i kërkohet që të marrin një autorizim, në zbatim të kësaj direktive, për të ofruar shërbime investimi, si administrimi i portofolit individual në lidhje me AIF-të. Megjithatë, firmat e investimit duhet të ofrojnë, direkt ose indirekt, njësitë ose aksionet e AIF-ve, ose t'i alokojnë këto njësi ose aksione tek investitorët në Bashkimin Evropian vetëm deri në masën që këto njësi ose aksione të mund të tregtohen në përputhje me këtë direktivë.

Neni 7

Aplikimi për autorizim

1. Shtetet anëtare i kërkojnë AIFM-ve që të aplikojnë për autorizim nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tyre.

2. Shtetet anëtare kërkojnë që një AIFM që aplikon për autorizim, t'i dorëzojë autoriteteve kompetente të shtetit të tij të origjinës informacionin e mëposhtëm në lidhje me AIFM-në:

a) informacionin për personat që ushtrojnë me efikasitet veprimtarinë e AIFM-ve;

b) informacionin për identitetet e aksionarëve ose anëtarëve të AIFM-ve, qofshin të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, persona fizikë ose juridikë, që zotërojnë pjesëmarrje kualifikuese, dhe informacion për sasinë e këtyre pjesëmarrjeve;

c) programin e veprimtarisë, që përcakton strukturën organizative të AIFM-së, duke përfshirë informacionin për mënyrën se si AIFM-ja synon të përmbushë detyrimet e saj, sipas kreut II, III, dhe IV, dhe aty ku zbatohet, sipas kapitullit V, VI, VII dhe VIII;

d) informacionin për politikën e shpërblimit dhe praktikën në përputhje me nenin 13;

e) informacionin për marrëveshjet e lidhura për delegimin dhe nëndelegimin të palët e treta, të funksioneve që përmenden në nenin 20.

3. Shtetet anëtare i kërkojnë një AIFM-je që aplikon për autorizimin, t'i dorëzojë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tij informacionin e mëposhtëm për AIF-të që synon të administrojë:

a) informacionin për strategjitë e investimit, duke përfshirë llojet e fondeve bazë, nëse AIF-ja është një fond ndër fonde, dhe për politikat e AIFM-së në lidhje me përdorimin e levës financiare, dhe për profilet e rrezikut dhe karakteristika të tjera të AIF-ve që ajo administro ose synon të administrojë, duke përfshirë informacionin për shtetet anëtare ose vendet e treta, në të cilat këto AIF janë themeluar ose priten të themelohen;

b) informacion për vendin ku AIF-ja kryesore themelohet, nëse AIF-ja është AIF ushqyese;

c) rregullat ose instrumentet e themelimit të çdo AIF-je që AIFM-ja synon të administrojë;

d) informacion për marrëveshjet e lidhura për emërimin e depozitarit, në përputhje me nenin 21 për çdo AIF që AIFM-ja synon të administrojë;

e) çdo informacion shtesë që përmendet në nenin 23, paragrafi 1 për çdo AIF që AIFM-ja administron ose synon të administrojë.

4. Nëse shoqëria administruese autorizohet, në përputhje me Direktivën 2009/65/KE (shoqëri e administrimit të SIKTT-ve) dhe aplikon për t'u autorizuar si një AIFM në zbatim të kësaj direktive, autoritetet kompetente nuk i kërkojnë shoqërisë së administrimit të SIKTT-ve që të paraqesë dokumente ose informacione që shoqëria e administrimit të SIKTT-ve tashmë i ka dorëzuar gjatë aplikimit për autorizim sipas Direktivës 2009/65/KE, me kusht që ky informacion ose këto dokumente të mbeten të përditësuar.

5. Autoritetet kompetente çdo tre mujor informojnë ESMA-n për autorizimet e dhëna ose të tërhequra, në përputhje me këtë krye.

ESMA mban një regjistër qendror publik që identifikon çdo AIFM të autorizuar sipas kësaj direktive, listën e AIF-ve të administruara dhe/ose të tregtuara në Bashkimin Evropian nga këto AIFM dhe nga autoriteti kompetent për çdo AIFM të tillë. Regjistri bëhet publik në format elektronik.

6. Për të garantuar harmonizimin konsistent të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standardet teknike rregullatore për të specifikuar informacionin që AIFM-ja duhet t'u dorëzojë autoriteteve kompetente gjatë aplikimit për autorizimin, duke përfshirë programin e veprimtarisë.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Për të garantuar kushte të njëtrajtshme për zbatimin e këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standardet teknike zbatuese për të përcaktuar formularët standardë, shabllonët dhe procedurat për dorëzimin e informacionit të parashikuar në nënparagrafin e parë të paragrafit 6.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 8

Kushtet për dhënien e autorizimit

1. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së nuk japin autorizimin, përveçse kur:

- a) ato binden se AIFM-ja do të mund të përmbushë kushtet e kësaj direktive;
- b) AIFM-ja ka kapital fillestar dhe fonde të veta të mjaftueshme, në përputhje me nenin 9;
- c) personat, të cilët ushtrojnë, në mënyrë efikase, veprimtarinë e AIFM-së kanë reputacion të mirë dhe kanë përvojë të mjaftueshme edhe për strategjitë e investimit që ndiqen nga AIF-të e administruara nga AIFM-ja, emrat e këtyre personave dhe të çdo pasardhësi të tyre në detyrë i komunikohen menjëherë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, dhe vendimet për ushtrimin e veprimtarive të AIFM-së merren nga të paktën dy persona që i përmbushin këto kushte;
- d) aksionarët ose anëtarët e AIFM-së që kanë pjesëmarrje influencuese janë të përshtatshëm, duke marrë në konsideratë nevojën për të garantuar administrimin e mirë dhe të kujdesshëm të AIFM-së; dhe

e) zyra kryesore dhe zyra e regjistruar e AIFM-së ndodhen në të njëjtin shtet anëtar.

Autorizimi vlen për të gjitha shtetet anëtare.

2. Autoritetet kompetente përkatëse të shteteve të tjera anëtare të përfshira duhet të këshillohen përpara se të jepet autorizimi për AIFM-të si më poshtë:

a) një filial i një AIFM-je tjetër, i një shoqërie që administron një SIKTT, një firmë investimi, një institucioni krediti ose një shoqërie sigurimesh e autorizuar në një shtet tjetër anëtar;

a) një filial një shoqërisë mëmë të një AIFM-je tjetër, i një shoqërie që administron një SIKTT, një firmë investimi, një institucioni krediti, ose një shoqërie sigurimesh e autorizuar në një shtet tjetër anëtar; ose

c) një shoqëri e kontrolluar nga të njëjtët persona fizikë ose juridikë që kontrollojnë një AIFM tjetër, një shoqëri që administron SIKTT-në, një firmë investimi, një institucion krediti ose një shoqëri sigurimesh të autorizuar në një shtet tjetër anëtar.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së refuzojnë autorizimin, në rastin kur ushtrimi efikas i funksioneve të tyre mbikëqyrëse pengohet nga sa më poshtë:

- a) lidhjet e ngushta ndërmjet AIFM-së dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë;
- b) ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të një vendi të tretë që rregullon personat fizikë ose juridikë, me të cilët AIFM-ja ka lidhje të ngushta;
- c) vështirësitë e hasura në zbatimin të këtyre ligjeve, të rregulloreve dhe dispozitave administrative.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së mund të kufizojnë fushën e zbatimit të autorizimit, në veçanti lidhur me strategjitë e investimit të AIF-ve që lejohen të administrohen nga AIFM-ja.

5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë aplikantin me shkrim, brenda 3 muajve nga dërgimi i aplikimit të plotë, nëse autorizimi është dhënë ose jo. Autoritetet kompetente mund të zgjasin këtë periudhë deri në tre muaj të tjerë shtesë, në rastin kur ato e gjykojnë të nevojshme për shkak të rrethanave specifike të rastit dhe pasi të kenë njoftuar përkatësisht AIFM-në.

Për qëllimet e këtij paragrafi, zbatueshmëria konsiderohet e plotë nëse AIFM-ja ka dorëzuar të paktën informacionin e përmendur në gerrat "a" deri në "d" të nenin 7, paragrafi 2 dhe në gerrat "a" dhe "b" të nenit 7, paragrafi 3.

AIFM-të mund të fillojnë administrimin e AIF-ve me strategjitë e investimit që përshkruhen në aplikim, në përputhje me germën "a" të nenit 7, paragrafi 3 në shtetin anëtar të origjinës së tyre, sapo të jepet autorizimi, por jo më herët se 1 muaj pasi të kenë dërguar çdo informacion të munguar që përmendet në nenin 7, paragrafi 2, germa "e" dhe në nenin 7, paragrafi 3, gerrat "c", "d" dhe "e".

6. Për të garantuar harmonizimin konsistent të këtij neni, ESMA mund të përgatisë në draft standardet teknike rregullatore për të specifikuar:

- a) kërkesat e zbatueshme për AIFM-të sipas paragrafit 3;
- b) kërkesat e zbatueshme për aksionarët dhe anëtarët me pjesëmarrjet influencuese që përmenden në germën "d" të paragrafit 1;
- c) pengesat që mund të parandalojnë ushtrimin efikas të funksioneve mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 9

Kapitali fillestar dhe fondet e veta

1. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që AIFM-ja që është një AIF e administruar së brendshmi, të ketë një kapital fillestar prej të paktën 300 000 euro.

2. Nëse AIFM-ja emërohet si administruar i jashtëm i AIF-ve, AIFM-ja do të ketë një kapital fillestar prej të paktën 125 000 euro.

3. Nëse vlera e portofolave të AIF-ve që administrohen nga AIFM-ja tejkalon 250 milionë euro, AIFM-ja siguron një sasi shtesë të fondeve të veta. Sasia shtesë e fondeve të veta duhet të jetë e barabartë me 0,02% të sasisë me të cilën vlera e portofolave të AIFM-së tejkalon 250 milionë euro, por gjithsesi, totali i kapitalit fillestar të kërkuar dhe sasia shtesë nuk tejkalon 10 milionë euro.

4. Për qëllimet e paragrafit 3, AIF-të e administruara nga një AIFM, duke përfshirë AIF-të për të cilat AIFM-ja ka funksione të deleguara në përputhje me nenin 20, por duke përjashtuar portofolat e AIF-ve që AIFM-ja administron sipas delegimit, duhet të konsiderohen si portofola e AIFM-së.

5. Pavarësisht paragrafit 3, fondet e veta të AIFM-së nuk duhet të jenë asnjëherë më të ulëta se sa shuma e kërkuar sipas nenin 21 të Direktivës 2006/49/KE.

6. Shtetet anëtare mund të autorizojnë AIFM-të që të mos ofrojnë deri në 50% të sasisë shtesë të fondeve të veta që përmenden në paragrafin 3, nëse ato përfitojnë nga një garanci që ka të njëjtën sasi, e cila jepet nga një institucion krediti ose një shoqëri sigurimesh me zyrë të regjistruar në një shtet anëtar, ose në një vend të tretë, kur ajo i nënshtrohet rregullave të kujdeshme të cilët konsiderohen nga autoritetet kompetente si ekuivalente me ato që përcaktohen në të drejtën e Bashkimit Evropian.

7. Për të mbuluar rreziqet e mundshme të përgjegjësisë profesionale që rrjedhin nga veprimtaritë e ndërmarra nga AIFM-të, në përputhje me këtë direktivë, AIF-të e administruara së brendshmi dhe AIFM-të e jashtme ose:

a) duhet të kenë fonde të veta shtesë që mjaftojnë për të mbuluar rreziqet e mundshme të përgjegjësisë profesionale që rrjedhin nga pakujdesia profesionale; ose

b) ose duhet të zotërojnë një sigurim ndaj rreziqeve profesionale kundër përgjegjësisë që rrjedh nga pakujdesia profesionale, i cili është i mjaftueshëm për rreziqet e mbuluara.

8. Fondet e veta, duke përfshirë çdo fond vetjak shtesë, siç përmendet në germën "a" të paragrafit 7, investohen në aktive likuide ose në aktive lehtësisht të konvertueshme në mjete monetare në një afat të shkurtër dhe nuk përfshijnë pozicionet spekulative.

9. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtuar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me paragrafin 7 të këtij neni, që specifikojnë:

a) rreziqet që fondeve të veta shtesë ose sigurimi nga rreziqet profesionale duhet të mbulojnë;

b) kushtet për të përcaktuar mjaftueshmërinë e fondeve të veta shtesë ose mbulimin me sigurim të rreziqeve profesionale; dhe

c) mënyrën e përcaktimit të axhustimeve të vazhdueshme për fondet e veta shtesë ose për mbulimin me sigurim ndaj rreziqeve profesionale.

10. Me përjashtim të paragrafit 7 dhe 8 dhe të akteve të deleguara të miratuara në përputhje me paragrafin 9, ky nen nuk zbatohet për AIFM-të që janë gjithashtu shoqëri të administrimit të SIKTT-ve.

Neni 10

Ndryshimet në fushën e zbatimit të autorizimit

1. Shtetet anëtare u kërkojnë AIFM-ve që, përpara zbatimit, të njoftojnë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tyre për çdo ndryshim material në lidhje me kushtet për autorizimin fillestar, në veçanti për ndryshimet materiale në lidhje me informacionin e dorëzuar në përputhje me nenin 7.

2. Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës vendosin të caktojnë kufizime ose të kundërshtojnë këto ndryshime, ato informojnë AIFM-në brenda 1 muaji nga marrja e këtij njoftimi. Autoritetet kompetente mund të zgjasin këtë periudhë deri në 1 muaj, në rastin kur ato e gjykojnë të nevojshme për shkak të rrethanave specifike të rastit dhe pasi të kenë njoftuar përkatësisht AIFM-në. Ndryshimet mund të zbatohen nëse autoritetet kompetente përkatëse nuk kundërshtojnë ndryshimet brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

Neni 11

Tërheqja e autorizimit

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së mund të tërheqin autorizimin e lëshuar për një AIFM, në rastin kur kjo AIFM:

a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht autorizimin ose ka reshtur së ushtruar veprimtarinë e mbuluar nga kjo direktive për më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës ka parashikuar që autorizimi të ketë shkëputje në raste të tilla;

b) e ka marrë autorizimin nëpërmjet deklaratave të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;

c) nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave është dhënë autorizimi;

d) nuk vepron më në pajtim me Direktivën 2006/49/KE nëse autorizimi i saj mbulon gjithashtu edhe shërbimin e administrimit të kujdesshëm të portofolit, të përmendur në nenin 6, paragrafi 4, germa "a" të kësaj direktive;

e) ka kryer shkelje të rëndë ose të përsëritur të dispozitave të miratuara sipas kësaj direktive; ose

f) përfshihet në njërin prej rasteve kur legjislacioni i brendshëm, në lidhje me çështjet jashtë fushës së zbatimit të kësaj direktive, parashikon tërheqjen e autorizimit.

KAPITULLI III

KUSHTET E FUNKSIONIMIT TË AIFM-VE

SEKSIONI 1

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 12

Parime të përgjithshme

1. Shtetet anëtare garantojnë që në çdo kohë AIFM-të:

a) të veprojnë drejtë, me aftësitë dhe kujdesin e duhur, dhe me ndershmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre;

b) të veprojnë në interesin më të mirë të AIF-ve ose të investitorëve të AIF-ve që administrojnë dhe të integritetit të tregut;

c) të kenë dhe të përdorin me efikasitet burimet dhe procedurat e nevojshme për ecurinë sa më të mirë të veprimtarive të saj;

d) të marrin të gjitha masat e arsyeshme për shmangien e konflikteve të interesit, dhe kur nuk është e mundur, për identifikimin, administrimin dhe monitorimin dhe, sipas rastit, komunikimin e këtyre konflikteve të interesit, me qëllim parandalimin e ndikimit të tyre negativ në interesat e AIF-ve dhe të investitorëve të tyre, si dhe për garantimin e trajtimit të drejtë të AIF-ve nën administrimin e tyre;

e) të respektojnë të gjitha kërkesat rregullatore në zbatim të ushtrimit të veprimtarive të tyre me qëllim promovimin e interesave më të mira të AIF-ve ose të investitorëve të AIF-ve nën administrimin e tyre dhe të integritetit të tregut;

f) të trajtojnë në mënyrë të drejtë të gjithë investitorët e AIF-ve.

Asnjë investitor i AIF-ve nuk përfiton trajtim preferencial, me përjashtim të rasteve kur trajtimi preferencial komunikohet përmes rregullave përkatëse të AIF-ve ose përmes instrumenteve të përfshirjes.

2. Çdo AIFM, autorizimi i së cilës mbulon edhe shërbimin e administrimit me diskrecion të portofolit, të përmendur nenin 6, paragrafi 4, germa "a":

a) nuk lejohet të investojë të gjithë ose një pjesë të portofolit të klientit në kuota ose aksione të AIF-ve që ka në administrim, me përjashtim të rasteve kur merr miratim paraprak të klientit;

b) në lidhje me shërbimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 4, është objekt i Direktivës 97/9/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 3 mars 1997, "Për skemat investitor-kompensim".

3. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56 dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë kriteret që duhet të përdoren nga autoritetet kompetente përkatëse për të vlerësuar nëse AIFM-të i përmbushin detyrimet e tyre sipas paragrafit 1.

Neni 13

Shpërblimi

1. Shtetet anëtare u kërkojnë AIFM-ve të zotërojnë politika dhe praktika shpërblimesh për këto kategori të stafit, duke përfshirë drejtuesit e lartë, ata që marrin përsipër rrezikun, funksionet e kontrollit dhe çdo punonjës që merr një shpërblim total që e përfshin atë në të njëjtën fashë shpërblimi me drejtuesit e lartë dhe ata që marrin përsipër rrezikun, veprimtaritë profesionale të së cilëve kanë ndikim material në profilin e rrezikut të AIFM-ve ose AIF-ve nën administrimin e tyre, të cilat janë të qëndrueshme dhe nxisin menaxhimin e mirë dhe efektiv të rrezikut, si dhe nuk nxisin marrjen përsipër të rrezikut në kundërshtim me profilet e rrezikut, rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-ve nën administrimin e tyre.

AIFM-të i përcaktojnë politikat dhe praktikat e shpërblimit në përputhje me shtojcën II.

2. ESMA garanton ekzistencën e udhëzimeve për këto politika të mira të shpërblimit, të cilat janë në përputhje me shtojcën II. Këto udhëzime duhet të marrin në konsideratë parimet për politikat e mira të shpërblimit të përcaktuara në Rekomandimin 2009/384/KE, madhësinë e AIFM-ve dhe madhësinë e AIF-ve nën administrimin e tyre, strukturën e brendshme organizative dhe natyrën, objektin dhe kompleksitetin e veprimtarive të tyre. ESMA bashkëpunon ngushtë me Autoritetin Mbikëqyrës Evropian (Autoriteti Bankar Evropian) (EBA).

Neni 14

Konfliktet e interesit

1. Shtetet anëtare u kërkojnë AIFM-ve të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshme për identifikimin e konflikteve të interesit që hasen gjatë administrimit të AIF-ve, ndërmjet:

a) AIFM-së, duke përfshirë drejtuesit e saj, punonjësit ose çdo person tjetër të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me AIFM-në përmes kontrollit, dhe AIF-në e administruar nga AIFM-ja ose nga investitorët e kësaj AIF-je;

b) AIF-së ose investitorëve të kësaj AIF-je, dhe një AIF-je tjetër ose investitorëve të kësaj AIF-je;

c) AIF-së ose investitorëve të kësaj AIF-je, dhe një AIF-je tjetër ose investitorëve kësaj AIF-je;

d) AIF-së ose investitorëve të kësaj AIF-je dhe një SIKTT-je nën administrimin e AIFM-së ose investitorëve të kësaj SIKTT-je; ose

e) dy klientëve të AIFM-së.

AIFM-ja ruan dhe zbaton marrëveshjet efikase organizative dhe administrative, me qëllim marrjen e të gjitha hapave të arsyeshme të projektuara për identifikimin, parandalimin, administrimin dhe monitorimin e konflikteve të interesit në mënyrë që të parandalojnë ndikimin negativ në interesat e AIF-ve dhe investitorëve të tyre.

AIFM-të, brenda mjedisit të tyre operacional, ndajnë detyrat dhe përgjegjësitë që mund të konsiderohen jo në përputhje me njëra-tjetrën ose që mund të gjenerojnë konflikte sistemike të mundshme të interesit. AIFM-të vlerësojnë nëse kushtet e tyre operationale mund të sjellin konflikte të tjera materiale të interesit dhe informojnë investitorët e AIF-ve për këtë fakt.

2. Nëse marrëveshjet organizative të kryera nga AIFM-të për identifikimin, parandalimin, administrimin dhe monitorimin e konflikteve të interesit nuk mjaftojnë për të garantuar, sipas konfidencës së arsyeshme, parandalimin e rreziqeve në dëm të interesave të investitorëve, AIFM-ja informon në mënyrë të qartë investitorët për natyrën e përgjithshme ose burimet e konflikteve të interesit përpara se të marrë përsipër punë për llogari të tyre, dhe harton politika dhe procedura të përshtatshme.

3. Nëse AIFM përdor shërbimet e brokerit primar në emër të AIF-së, kushtet përcaktohen me kontratë me shkrim. Në veçanti, çdo mundësi transferimi dhe ripërdorimi e aktiveve të AIF-së duhet të parashikohet në këtë kontratë dhe duhet të jetë në përputhje me rregullat e AIF-së ose me instrumentet e themelimit. Kontrata parashikon që depozitari të informohet për këtë kontratë.

AIFM-të ushtrojnë aftësinë dhe kujdesin e duhur në lidhje me përzgjedhjen dhe caktimin e brokerave primar, me të cilët duhet të lidhet kontratë.

4. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) llojet e konflikteve të interesit, siç përmenden në paragrafin 1;

b) hapat e arsyeshme që AIFM-të pritet të marrin, në lidhje me strukturat dhe procedurat organizative dhe administrative, me qëllim identifikimin, parandalimin, administrimin, monitorimin dhe informimin për konfliktet e interesit.

Neni 15

Menaxhimi i rrezikut

1. AIFM-të i ndajnë në mënyrë funksionale dhe hierarkike funksionet për menaxhimin e rrezikut nga njësitë operative, madje edhe nga funksionet për administrimin e portofolit.

Ndarja funksionale dhe hierarkike e funksioneve të menaxhimit të rrezikut, në përputhje me nënparagrafin e parë, rishikohet nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke rënë dakord që AIFM-ja, në çdo rast, të mund të vërtetojë se disponon masa specifike kundër konflikteve të interesit që lejojnë kryerjen në mënyrë të pavarur të veprimtarive të menaxhimit të rrezikut dhe se procesi i menaxhimit të rrezikut i përmbush kërkesat e këtij neni dhe është vazhdimisht efikas.

2. AIFM-të përdorin sisteme të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut, me qëllim identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e përshtatshëm të të gjitha rreziqeve që lidhen me çdo lloj strategjie investimi të AIF-së dhe ndaj të cilëve çdo AIF është e ekspozuar ose mund të ekspozohet.

AIFM-të rishikojnë here pas here sistemet e menaxhimit të rrezikut, të paktën një herë në vit dhe i përshtatin këto sisteme sa herë është e nevojshme.

3. AIFM-të duhet të paktën:

a) të zbatojnë një proces të përshtatshëm, të dokumentuar dhe të përditësuar rregullisht të kujdesit të duhur kur investojnë në emër të AIF-së, sipas strategjisë së investimit, objektivave dhe profilit të rrezikut të kësaj AIF-je;

b) të garantojnë që rreziqet që lidhen me çdo pozitë investimesh të AIF-së dhe ndikimin e tyre të përgjithshëm në portofolin e AIF-së të mund të identifikohen, maten, administrohen dhe monitorohen siç duhet në mënyrë të vazhdueshme, madje edhe duke përdorur procedurat e duhura të testimit të stresit;

c) të garantojnë që profili i rrezikut të AIF-së të përkojë me madhësinë, strukturën e portofolit dhe strategjitë dhe objektivat e investimit të AIF-së, siç përcaktohet në rregullat e AIF-së apo në instrumentet e themelimit, prospekt dhe dokumentet e ofertave.

4. AIFM-të caktojnë një nivel maksimal të borxhit nominal që mund ta përdorin në emër të çdo AIF-je nën administrimin e tyre, si dhe në masën e së drejtës së ripërdorimit të kolateralit ose të garancisë që mund të jepet sipas marrëveshjes të borxhit nominal, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera:

a) llojin e AIF-së;

b) strategjinë e investimit të AIF-së;

c) burimet borxhit nominal të AIF-së;

d) çdo ndërlidhje tjetër ose marrëdhënie përkatëse me institucione të tjera financiare, të cilat paraqesin rreziqe sistemike;

e) nevojën për kufizimin e ekspozimit ndaj çdo kundërpale të vetme;

f) masën e vendosjes së kolateralit për borxhin nominal;

g) raportin aktive-pasive;

h) shkallën, natyrën dhe masën e veprimtarisë së AIFM-së në tregjet në fjalë.

5. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) sistemet e menaxhimit të rrezikut që duhet të përdorin AIFM-të, në lidhje me rreziqet që marrin përsipër në emër të AIF-ve nën administrimin e tyre;

b) shpeshhtësinë e duhur të rishikimit të sistemit të menaxhimit të rrezikut;

c) mënyrën se si funksioni i menaxhimit të rrezikut duhet të ndahet në mënyrë funksionale dhe hierarkike nga njësitë operationale, duke përfshirë edhe funksionin e administrimit të portofolit;

d) masat specifike të sigurisë kundër konflikteve të interesit të përmendura në nënparagrafin e parë të paragrafit 1;

e) kërkesat e përmendura në paragrafin 3.

Neni 16

Administrimi i likuiditetit

1. Për çdo AIF nën administrimin e tyre që nuk është AIF me afat e palëvruar, me fonde të palëvruara, AIFM-të përdorin një sistem të duhur menaxhimi të likuiditetit dhe miratojnë procedura që u mundësojnë atyre të monitorojnë rrezikun e likuiditetit të AIF-së dhe të garantojnë që profili i likuiditetit të investimeve të AIF-së të përmbushë detyrimet themelore.

AIFM-të zhvillojnë rregullisht testet e stresit, sipas kushteve normale dhe të jashtëzakonshme të likuiditetit, të cilat bëjnë të mundur që ato të vlerësojnë rrezikun e likuiditetit të AIF-ve dhe përkatësisht të monitorojnë rrezikun e likuiditetit të AIF-ve.

2. AIFM-të garantojnë që, për çdo AIF nën administrimin e tyre, strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika kompensimit të jenë të qëndrueshme.

3. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) sistemet dhe procedurat e administrimit të likuiditetit; dhe

b) harmonizimin e strategjisë së investimit, profilin e likuiditetit dhe politikës së kompensimit të përcaktuara në paragrafin 2.

Neni 17

Investimi në pozicionet e sigurimeve

Për garantimin e konsistencës ndërsektoriale dhe për vendosjen e rakordimit ndërmjet interesave të shoqërive që ripaketojnë kreditë në tituj të tregtueshëm dhe ceduesve sipas kuptimit të nenit 4, pika 41 të Direktivës 2006/48/KE dhe AIFM-ve që investojnë në këta tituj ose në instrumente të tjera financiare në emër të AIF-ve, Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56 dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që përcaktojnë kërkesat sipas fushave të mëposhtme:

a) kërkesat që duhet të plotësohen nga iniciatori, sponsori ose huadhënësi fillestar, në mënyrë që AIFM-ja të mund të investojë në tituj ose në instrumente të tjera financiare të këtij lloji, të emtuar pas datës 1 janar 2011, duke përfshirë edhe kërkesat që garantojnë se iniciatori, sponsori ose huadhënësi fillestar mban një interes ekonomik neto prej jo më pak se 5%;

b) kërkesat cilësore që duhet të përmbushin AIFM-të që investojnë në këta tituj ose në instrumente të tjera financiare, për llogari të një ose më shumë AIF-ve.

SEKSIONI 2

KËRKESAT ORGANIZATIVE

Neni 18

Parime të përgjithshme

1. Shtetet anëtare kërkojnë që AIFM-të të përdorin në çdo kohë burimet e duhura dhe të përshtatshme njerëzore dhe teknike të nevojshme për administrimin e duhur të AIF-ve.

Në veçanti, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të AIFM-së, duke pasur parasysh natyrën e AIF-ve nën administrimin e AIFM-së, kërkojnë që AIFM-ja të ketë procedura të mira administrative dhe kontabiliteti, masa kontrolli dhe mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave elektronike dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm duke përfshirë, veçanërisht, rregullat për transaksionet personale nga punonjësit e saj ose për zotërimin ose administrimin e investimeve, me qëllim investimin për llogari të vet dhe garantimin, që të paktën, çdo transaksion që përfshin AIF-të të mund të rindërtohet sipas origjinës së tij, palëve në të, natyrës, kohës dhe vendit ku është kryer dhe që aktivet e AIF-ve nën administrimin e AIFM-së të jenë investuar në përputhje me rregullat e AIF-së ose me instrumentet e themelimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

2. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56 dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë procedurat dhe marrëveshjet e përmendura në paragrafin 1.

Neni 19

Vlerësimi

1. AIFM-të, për çdo AIF nën administrimin e tyre, garantojnë hartimin e procedurave të përshtatshme dhe të qëndrueshme në mënyrë që të kryhet vlerësimi i duhur dhe i pavarur i këtyre

aktiveve të AIF-së, në përputhje me këtë nen, me legjislacionin e brendshëm në fuqi dhe me rregullat e AIF-së ose me instrumentet e themelimit.

2. Rregullat e zbatueshme për vlerësimin e aktiveve dhe për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për kuotë ose aksion të AIF-së, përcaktohen në legjislacionin e shtetit ku është themeluar AIF-ja dhe/ose në rregullat e AIF-së ose në instrumentet e themelimit.

3. Gjithashtu, AIFM-të garantojnë që vlera neto e aktiveve për kuotë ose aksion të AIF-ve të llogaritet dhe t'u përcillet investitorëve, në përputhje me këtë nen, me legjislacionin e brendshëm në fuqi dhe me rregullat e AIF-së ose me instrumentet e themelimit.

Procedurat e përdorura të vlerësimit garantojnë vlerësimin e aktiveve dhe llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për kuotë ose aksion, të paktën një herë në vit.

Nëse AIF-ja është e llojit me afat, ky vlerësim dhe llogaritje kryhet në intervale të përshtatshme për aktivet e mbajtura nga AIF-ja dhe për emetimin e tyre dhe shpeshhtësinë e kompensimit.

Nëse AIF-ja është e llojit me afat, ky vlerësim dhe llogaritje kryhet edhe në rastin e rritjes ose zvogëlimit të kapitalit nga AIF-ja përkatëse.

Investitorët informohen lidhur me vlerësimet dhe llogaritjet e përcaktuara në rregullat përkatëse të AIF-ve ose në instrumentet e themelimit.

4. AIFM-të garantojnë që funksioni i vlerësimit të zhvillohet përmes:

a) një vlerësuesi të jashtëm, qoftë person juridik ose fizik i pavarur nga AIF-ja, AIFM-ja dhe nga çdo person tjetër me lidhje të ngushta me AIF-në ose me AIFM-në; ose

b) vetë AIFM-së, me kusht që detyra e vlerësimit të ruajë pavarësinë funksionale nga administrimi i portofolit dhe nga politikat e shpërblimit dhe që masat e tjera të garantojnë zbutjen e konflikteve të interesit dhe parandalimin e ndikimit të papërshtatshëm mbi punonjësit.

Depozitari i emëruar për një AIF nuk duhet të emërohet si vlerësues i jashtëm i kësaj AIF-je, përveçse kur përmbushja e funksioneve të këtij depozitari është e ndarë nga pikëpamja funksionale dhe hierarkike nga detyrat e tij në rolin e vlerësuesit të jashtëm dhe kur konfliktet e mundshme të interesit identifikohen, administrohen, monitorohen dhe u përcillen siç duhet investitorëve të AIF-së.

5. Nëse vlerësuesi i jashtëm kryen funksionin vlerësues, AIFM-ja duhet të provojë që:

a) vlerësuesi i jashtëm t'i nënshtrohet regjistrimit profesional të detyrueshëm të njohur në dispozitat ligjore ose rregullatore ose në rregullat e etikës profesionale;

b) vlerësuesi i jashtëm të ofrojë garancitë e duhura profesionale që tregojnë se është i aftë të kryejë me efikasitet funksionin e vlerësimit përkatës, në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3; dhe

c) emërimi i vlerësuesit të jashtëm të jetë në përputhje me kërkesat në nenin 20, paragrafi 1 dhe 2 dhe aktet e deleguara të miratuara në përputhje me nenin 20, paragrafi 7.

6. Vlerësuesi i jashtëm i emëruar nuk duhet t'ia delegojë funksionin vlerësues një pale të tretë.

7. AIFM-të njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës lidhur me emërimin e vlerësuesit të jashtëm, të cilat mund të kërkojnë që të emërohet një tjetër vlerësues i jashtëm në vend të këtij të fundit, në rastin kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 5.

8. Ky vlerësim kryhet në mënyrë të paanshme dhe me të gjithë aftësinë dhe kujdesin e duhur.

9. Nëse funksioni vlerësues nuk kryhet nga një vlerësues i pavarur i jashtëm, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së mund t'i kërkojnë AIFM-së që të verifikojë procedurat e vlerësimit dhe/ose vlerësimet nga një vlerësues i jashtëm ose, sipas rastit, nga një auditues.

10. AIFM-të janë përgjegjëse për vlerësimin e saktë të aktiveve të AIF-së, për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve dhe për botimin e kësaj vlere neto të aktiveve. Për rrjedhojë, detyrimi i AIFM-ve kundrejt AIF-së dhe investitorëve të saj nuk ndikohet nga fakti që AIFM-ja ka emëruar një vlerësues të jashtëm.

Pavarësisht nënparagrafit të parë dhe pavarësisht nga çdo marrëveshje kontraktuale që parashikon ndryshe, vlerësuesi i jashtëm është përgjegjës ndaj AIFM-së për çdo humbje të shkaktuar nga AIFM-ja, si rezultat i neglizhencës së vlerësuesit të jashtëm ose moskryerjes me dashje të detyrave të tij.

11. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) kriteret në lidhje me procedurat për vlerësimin e duhur të aktiveve dhe llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për çdo kuotë ose aksion;

b) garancitë profesionale që duhet të japin vlerësuesit e jashtëm për të përmbushur në mënyrë efektive funksionin e vlerësimit;

c) shpeshhtësinë e vlerësimit të kryer nga AIF-të pa afat, i cili vlen edhe për aktivet e AIF-së dhe për politikën e emetimit dhe shlyerjes.

SEKSIONI 3

DELEGIMI I FUNKSIONEVE TË AIFM-SË

Neni 20

Delegimi

1. AIFM-të që synojnë t'ua delegojnë palëve të treta detyrën e kryerjes së funksioneve për llogari të tyre, duhet të njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës përpara se këto marrëveshje delegimi të hyjnë në fuqi. Duhet të përmbushen kushtet si më poshtë:

a) AIFM-ja duhet të mund të justifikojnë me arsye objektive të gjithë strukturën e delegimit;

b) i deleguari duhet ketë burime të mjaftueshme për kryerjen e detyrave përkatëse, dhe personat që përmbushin në mënyrë efikase detyrat e të deleguarit duhet të kenë reputacion mjaft të mirë dhe përvojë të mjaftueshme;

c) nëse ky delegim lidhet me administrimin e portofolit ose me menaxhimin e rrezikut, duhet t'u delegohet vetëm sipërmarrjeve të autorizuar ose të regjistruara për qëllimet e administrimit të aseteve dhe duhet t'u nënshtrohen mbikëqyrjes ose, në rast se nuk plotësohet ky kusht, ky delegim është objekt i miratimit paraprak nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së;

d) nëse ky delegim lidhet me administrimin e portofolit ose me menaxhimin e rrezikut dhe nëse i delegohet një sipërmarrje në një vend të tretë, përveç kërkesave të germës "c", duhet të garantohet bashkëpunimi me autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së dhe autoritetit mbikëqyrës të sipërmarrjes;

e) ky delegim nuk duhet të pengojë efikasitetin e mbikëqyrjes mbi AIFM-në dhe, sidomos, nuk duhet ta pengojë AIFM-në të veprojë, ose AIF-në të administrohet, në interesin më të mirë të investitorëve të saj;

f) AIFM-ja duhet të provojë që i deleguari është i kualifikuar dhe i aftë të ndërmarrë funksionet në fjalë, që ai është përzgjedhur me kujdesin e duhur dhe që pozita e AIFM-së është të monitorojë me efikasitet dhe në çdo kohë veprimtarinë e deleguar, t'i japë në çdo kohë udhëzime të deleguarit dhe të tërheqë delegimin me efekt të menjëhershëm kur kjo është në interes të investitorëve.

AIFM-ja rishikon vazhdimisht shërbimet e ofruara nga çdo i deleguar.

2. Administrimi i portofolit ose menaxhimi i rrezikut nuk duhet t'u delegohen:

a) depozitarit ose një personi të deleguar nga depozitari; ose

b) çdo subjekti tjetër, interesat e të cilit mund të bien ndesh me ato të AIFM-së ose me ato të investitorëve të AIF-së, përveç kur ky subjekt i ka ndarë nga pikëpamja funksionale dhe hierarkike detyrat e administrimit të portofolit apo menaxhimit të rrezikut nga detyrat e tjera që mund të sjellin konflikt, dhe kur konfliktet e mundshme të interesit janë identifikuar, administruar, monitoruar dhe u janë përcjellë siç duhet investitorëve të AIF-së.

3. Detyrimi i AIFM-së ndaj AIF-së dhe investitorëve të saj nuk ndikohet nga fakti se AIFM-ja u ka deleguar funksione një pale të tretë, ose nga nën-delegime të tjera, dhe AIFM-ja nuk duhet t'i delegojë funksionet e saj deri në atë masë që të mos konsiderohet më si administruese e AIF-së dhe deri në atë masë sa të bëhet shoqëri kuti-poste.

4. Pala e tretë mund të nën-delegojë çdo funksion që i është deleguar asaj, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) AIFM-ja të ketë dhënë pëlqimin paraprak për këtë nën-delegim;
- b) AIFM-ja të ketë njoftuar autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës përpara hyrjes në fuqi të marrëveshjes së nën-delegimit;
- c) kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 sipas të cilave të gjitha referencat për "të deleguarin" lexohen si referenca për "të nëndeleguarin".

5. Administrimi i portofolit ose menaxhimi i rrezikut nuk duhet t'u nën-delegohet:

- a) depozitarit ose një personi të deleguar nga depozitari; ose
- b) çdo subjekti tjetër, interesat e të cilit mund të bien ndesh me ato të AIFM-së ose me ato të investitorëve të AIF-së, përveç kur ky subjekt i ka ndarë nga pikëpamja funksionale dhe hierarkike detyrat e administrimit të portofolit apo menaxhimit të rrezikut nga detyrat e tjera që mund të sjellin konflikt, dhe kur konfliktet e mundshme të interesit janë identifikuar, administruar, monitoruar dhe u janë përcjellë siç duhet investitorëve të AIF-së.

I deleguari përkatës rishikon vazhdimisht shërbimet e ofruara nga çdo i nën-deleguar.

6. Kur i nën-deleguari delegon përsëri një nga funksionet që i janë deleguar, kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 zbatohen rast pas rasti.

7. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

- a) kushtet për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në paragrafët 1, 2, 4 dhe 5;
- b) kushtet sipas të cilave AIFM-ja konsiderohet se ka deleguar funksionet e saj, deri në masën që ajo kthehet në një shoqëri kuti-poste dhe nuk konsiderohet më si administruese e AIF-së, siç përcaktohet në paragrafin 3.

SEKSIONI 4

DEPOZITARI

Neni 21

Depozitari

1. Për çdo AIF nën administrimin e saj, AIFM-ja garanton që çdo depozitar i vetëm të emërohet në përputhje me këtë nen.

2. Emërimi i depozitarit vërtetohet me kontratë me shkrim. Ndër të tjera, kjo kontratë rregullon fluksin e informacionit që konsiderohet i nevojshëm për t'i lejuar depozitarit të kryejë

funkcionet e tij për AIF-në për të cilën është emëruar si depozitar, siç përcaktohet në këtë direktivë dhe në ligjet e tjera, rregulloret ose dispozitat administrative përkatëse.

3. Depozitari duhet që të jetë:

a) një institucion kreditor, me seli të regjistruar në BE dhe është i autorizuar në përputhje me Direktivën 2006/48/KE;

b) shoqëri investimi, me seli të regjistruar në BE, që i nënshtrohet kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me nenin 20, paragrafi 1 të Direktivës 2006/49/KE, duke përfshirë kërkesat e kapitalit për rreziqet operationale dhe e autorizuar në përputhje me Direktivën 2004/39/KE, dhe që gjithashtu ofron shërbime ndihmëse të ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në lidhje me llogaritë e klientëve, në përputhje me pikën 1 të seksionit B të shtojcës I të Direktivës 2004/39/KE; këto shoqëri investimi duhet në çdo rast të zotërojnë fonde vetjake, jo më pak se sasia e kapitalit fillestar të përmendur në nenin 9 të Direktivës 2006/49/KE; ose

c) një kategori tjetër institucioneve që është objekt i rregullores prudenciale dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe e cila, më datë 21 korrik 2011, përfshihet në kategoritë e institucioneve të përcaktuara nga shtetet anëtare që kualifikohen si depozitar sipas nenit 23, paragrafi 3 të Direktivës 2009/65/KE.

Vetëm për AIF-të jashtë BE-së dhe pa cenuar germën "b" të paragrafit 5, depozitari mund të jetë gjithashtu një institucion kreditor ose çdo subjekt tjetër i të njëjtës natyrë me subjektet e përmendura në gerrat "a" dhe "b" të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, me kusht që të përmbushen kushtet në germën "b" të paragrafit 6.

Gjithashtu, shtetet anëtare mund të lejojnë që lidhur me AIF-të që nuk gëzojnë të drejtat e kompensimit të ushtruara gjatë periudhës 5-vjeçare nga data e investimeve fillestare dhe të cilat, në përputhje me politikën bazë të investimit, përgjithësisht nuk investojnë në aktivet që duhet të mbahen në kujdestari, në përputhje me germën "a" të paragrafit 8 ose përgjithësisht investojnë në emetues ose shoqëri të parenditura, me qëllim fitimin e mundshëm të kontrollit mbi këto shoqëri, në përputhje me nenin 26, depozitari mund të jetë një subjekt që kryen funksionet e depozitarit si pjesë e veprimtarive të tij profesionale ose ekonomike, lidhur me të cilat ky subjekt i nënshtrohet regjistrimit të detyrueshëm profesional të njohur me ligj ose dispozitave apo rregullave ligjore ose rregullatore të etikës profesionale, dhe të cilat mund të ofrojnë garancitë e mjaftueshme financiare dhe profesionale që të zbatohen me efikasitet funksionet përkatëse depozitare dhe të përmbushin angazhimet bazë për këto funksione.

4. Për shmangien e konflikteve të interesit ndërmjet depozitarit, AIFM-së dhe/ose AIF-së dhe/ose investitorëve të saj:

a) AIFM-ja nuk vepron si depozitar;

b) brokeri primar që vepron si kundërpalë ndaj AIF-së, nuk vepron si depozitar për këtë AIF, përveç rastit kur funksionet e tij si depozitar janë të ndara nga pikëpamja funksionale dhe hierarkike nga detyrat e tij si broker primar, dhe kur konfliktet e mundshme të interesit identifikohen, administrohen, monitorohen dhe u përcillen siç duhet investitorëve të AIF-së. Në

rast se përmbushen këto kushte përkatëse, depozitari mund të kryejë delegimin e detyrave të kujdestarisë te brokeri primar, në përputhje me paragrafin 11.

5. Depozitari themelohet në njëren vendet e mëposhtme:

a) për AIF-të e BE-së, në shtetin anëtar të origjinës së AIF-së;

b) për AIF-të jashtë BE-së, në vendin e tretë ku është themeluar AIF-ja ose në shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së që administron këtë AIF ose në shtetin anëtar të referencës së AIFM-së që administron këtë AIF.

6. Pa cenuar kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3, emërimi i një depozitari të themeluar në një vend të tretë duhet t'i nënshtrohet në çdo kohë kushteve si më poshtë:

a) autoritetet kompetente të shteteve anëtare ku synohet të tregtohen kuotat ose aksionet e AIF-ve jashtë BE-së, dhe nëse nuk është i njëjti, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, të kenë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe për shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente të depozitarit;

b) depozitari të jetë objekt i rregullores prudenciale, duke përfshirë kërkesat minimale të kapitalit, dhe i mbikëqyrjes me të njëjtin efekt si legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe të zbatohet në mënyrë efikase;

c) vendi i tretë i themelimit të depozitarit të mos renditet nga FATF si shtet dhe territor jobashkëpunues;

d) shtetet anëtare ku synohen të tregtohen kuotat ose aksionet e AIF-së jashtë BE-së dhe, nëse nuk është i njëjti, shteti anëtar i origjinës së AIFM-së, të kenë nënshkruar një marrëveshje me vendin e tretë ku është themeluar depozitari, e cila të jetë plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara në nenin 26 të Konventës Tatimore Model të OECD-së për të Ardhurat dhe Kapitalin, dhe të garantojë shkëmbimin efikas të informacionit për çështjet tatimore, duke përfshirë çdo marrëveshje shumëpalëshe tatimore;

e) depozitari të ketë detyrime kontraktuale ndaj AIF-së ose investitorëve të AIF-së, në përputhje me paragrafët 12 dhe 13, dhe të pranojë shprehimisht të pajtohet me paragrafin 11.

Kur një autoritet kompetent i një shteti tjetër anëtar nuk pajtohet me vlerësimin lidhur me zbatimin e germave "a", "c" ose "e" të nënparagrafit të parë nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Në bazë të kriterëve të përmendura në germën "b" të paragrafit 17, Komisioni miraton akte zbatuese, duke cituar rregulloren prudenciale dhe mbikëqyrjen e një vendi të tretë, me të njëjtat efekte si legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe të zbatuara në mënyrë efikase. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

7. Në përgjithësi, depozitari duhet të garantojë monitorimin siç duhet të flukseve të parasë së AIF-ve, dhe veçanërisht marrjen e të gjitha pagesave të kryera nga ose në emër të investitorëve mbi bazën e nënshkrimit të kuotave ose aksioneve të AIF-së, dhe regjistrimin e të gjitha parave fizike të AIF-së në llogaritë e parasë, që hapen në emër të AIF-së ose të AIFM-së, e cila vepron në emër të AIF-së ose në emër të depozitarit, i cili vepron në emër të AIF-së, për subjektin e përmendur në nenin 18, paragrafi 1 në germet "a", "b" dhe "c" të Direktivës 2006/73/KE, ose çdo subjekt tjetër me natyrë të njëjtë në lidhje me tregun, në të cilin kërkohen llogaritë e parasë, me kusht që ky subjekt t'i nënshtrohet rregullimit dhe mbikëqyrjes së kujdesshme dhe efikase, të cilat kanë fuqi të njëjta si legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe zbatohen me efikasitet dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 16 të Direktivës 2006/73/KE.

Kur llogaritë në mjete monetare hapen në emër të depozitarit që vepron për llogari të AIF-së, në këto llogari nuk do të bllokohen mjete monetare të subjektit të përmendur në nënparagrafin e parë dhe as mjetet monetare të depozitarit.

8. Aktivet e AIF-së ose të AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, duhet t'i besohen depozitarit për qëllime të ruajtjes, si më poshtë:

a) për instrumentet financiare që mund mbahen në kujdestari:

I. depozitari mban në kujdestari të gjitha instrumentet financiare që mund të regjistrohen në llogarinë e instrumenteve financiare të hapura në librat e depozitarit dhe të gjitha instrumentet financiare që mund t'i lëvrohen fizikisht depozitarit;

II. për këtë qëllim, depozitari garanton që të gjitha këto instrumente financiare që mund të regjistrohen në llogarinë e instrumenteve financiare të hapur në librat e depozitarit të regjistrohen në librat e depozitarit brenda llogarive të ndara, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 16 të Direktivës 2006/73/KE, të hapura në emër të AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, në mënyrë që të mund të identifikohet qartë se i përkasin AIF-së, në përputhje me ligjin në fuqi dhe në çdo kohë;

b) për aktivet e tjera:

I. depozitari verifikon pronësinë e këtyre aktiveve të AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së dhe i regjistron këto aktive, për të cilat bie dakord që AIF-ja ose AIFM-ja që vepron për llogari të AIF-së të ruajë pronësinë;

II. vlerësimi nëse është ruajtur pronësia e AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së bazohet në informacionet ose dokumentet e ofruara nga AIF-ja ose AIFM-ja dhe, kur është e mundur, në prova të jashtme;

III. depozitari i mban të përditësuara të dhënat e tij.

9. Përveç detyrave të përmendura në paragrafët 7 dhe 8, depozitari:

a) garanton që shitja, emetimi, ri-blerja, kompensimi dhe anulimi i kuotave apo aksioneve të AIF-së të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-së;

b) garanton që vlera e kuotave ose aksioneve të AIF-së të llogaritet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-së dhe procedurat e përcaktuara në nenin 19;

c) zbaton udhëzimet e AIFM-s', me përjashtim të rasteve kur ato bien ndesh me legjislacionin e brendshëm në fuqi apo rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-së;

d) garanton që në transaksionet që përfshijnë asetet e AIF-së, çdo kërkesë t'i përcillet AIF-së brenda afateve kohore të zakonshme;

e) garanton që të ardhurat e AIF-së të përdoren në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi dhe me rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-së.

10. Për sa i përket roleve të tyre përkatëse, AIFM-ja dhe depozitari vepron në ndershmëri, në mënyrë të drejtë, profesionale, të pavarur dhe në interes të AIF-së dhe investitorëve të AIF-së.

Depozitari nuk duhet të kryejë veprimtari në lidhje me AIF-në ose AIFM-në për llogari të AIF-së, të cilat mund të shkaktojnë konflikte të interesit mes AIF-së, investitorëve të AIF-së, AIFM-së dhe vetë atij, përveç rastit kur funksionet e tij si depozitar janë të ndara nga pikëpamja funksionale dhe hierarkike nga detyrat e tij të tjera që mund të sjellin konflikt, dhe kur konfliktet e mundshme të interesit janë identifikuar, administruar, monitoruar dhe u janë përcjellë siç duhet investitorëve të AIF-së.

Aktivitetet e përmendura në paragrafin 8 nuk ripërdoren nga depozitari pa miratimin paraprak të AIF-së ose të AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së.

11. Depozitari nuk i delegon funksionet e tij te palët e treta siç përshkruhet në këtë nen, me përjashtim të atyre të përmendura në paragrafin 8.

Depozitari mund t'i delegojë palëve të treta funksionet e përmendura në paragrafin 8 duke iu nënshtuar kushteve si më poshtë:

a) këto detyra të mos delegohen me synim shmangien e kërkesave të kësaj direktive;

b) depozitari të mund të vërtetojë ekzistencën e një arsyeje objektive në lidhje me këtë delegim;

c) depozitari të ketë treguar aftësitë dhe kujdesin e duhur në përzgjedhjen dhe caktimin e çdo pale të tretë, të cilës dëshiron t'i delegojë pjesë të detyrave të tij, dhe të vazhdojë të tregojë aftësitë dhe kujdesin e duhur gjatë rishikimit periodik dhe monitorimit të vazhdueshëm të çdo pale të tretë, të cilës i ka deleguar detyrat e tij, si dhe për marrëveshjet e palëve të treta për çështjet që i janë deleguar; dhe

d) depozitari të garantojë që pala e tretë të plotësojë në çdo kohë kushtet e mëposhtme, gjatë kryerjes së detyrave që i janë deleguar:

I. pala e tretë të ketë strukturat dhe ekspertizën e duhur dhe në proporcion me natyrën dhe kompleksitetin e aktiveve të AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së që i janë besuar;

II. lidhur me detyrat e kujdestarisë të përmendura në germën "a" të paragrafit 8, pala e tretë të jetë objekt i rregullores prudenciale efektive, duke përfshirë kërkesat minimale të kapitalit, dhe mbikëqyrjes në juridiksionin në fjalë, dhe pala e tretë të jetë objekti i auditimit të jashtëm periodik për të siguruar që ajo të zotërojë këto instrumente financiare;

III. pala e tretë t'i ndajë asetet e klientëve të depozitarit nga burimet e veta dhe nga asetet e depozitarit në mënyrë të tillë që të mund të identifikojnë qartë në çdo kohë se këto asete u përkasin klientëve të një depozitari të caktuar;

IV. pala e tretë të mos i përdorë këto asete pa pëlqimin paraprak të AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së dhe të njoftojë paraprakisht depozitarin; dhe

V. pala e tretë të respektojë detyrimet dhe ndalimet e përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 8 dhe 10.

Pavarësisht pikës II të germës "d" të nënparagrafit të dytë, kur ligji i një vendi të tretë kërkon që instrumente të caktuara financiare të mbahet nën kujdestarinë e subjekti vendor dhe ndërkohë asnjë subjekt vendor nuk i përmbush kërkesat e delegimit të përcaktuara në këtë pikë, depozitari mund t'ia delegojë funksionet e tij një subjekti të tillë vendor vetëm për aq sa kërkohet nga ligji i këtij vendi të tretë dhe vetëm për sa kohë që nuk ka subjekte vendore që i përmbushin kërkesat e delegimit, sipas kërkesave të mëposhtme:

a) investitorët e AIF-së përkatëse duhet të informohen siç duhet se ky delegim është i nevojshëm për shkak të kufizimeve ligjore në ligjin e vendit të tretë dhe për shkak të rrethanave që justifikojnë këtë delegim përpara se të fillojnë investimin; dhe

b) AIF-ja ose AIFM-ja për llogari të AIF-së duhet të ketë udhëzuar depozitarin për delegimin e kujdestarisë së këtyre instrumenteve financiare te këto subjekte vendore.

Nga ana tjetër, pala e tretë mund të nën-delegojë këto funksione sipas kërkesave të njëjta. Në këtë rast, paragrafi 13 zbatohet rast pas rasti ndaj palëve përkatëse.

Për qëllime të këtij paragrafi, ofrimi i shërbimeve siç specifikohet në Direktivën 98/26/KE, përmes sistemeve të shlyerjes së titujve, siç përcaktohet për qëllimet e kësaj direktive, ose ofrimi i shërbimeve të ngjashme nga sistemet e shlyerjes së titujve të vendeve të treta, nuk konsiderohet delegim i funksioneve të saj të kujdestarisë.

12. Depozitari i përgjigjet AIF-së ose investitorëve të AIF-së për humbjet e shkaktuara nga depozitari ose pala e tretë, të cilave i delegohet kujdestaria e instrumenteve financiare të mbajtura nën kujdestari, në përputhje me germën "a" të paragrafit 8.

Në rastin e këtyre humbjeve të instrumenteve financiare të mbajtura nën kujdestari, depozitari i kthen pa vonesë AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, një instrument financiar identik ose shumën përkatëse të këtyre instrumenteve. Depozitari nuk ka asnjë përgjegjësi nëse ai mund të vërtetojë se kjo humbje ka lindur si rezultat i një ngjarjeje të jashtme përtej kontrollit të tij të arsyeshëm, pasojat e të cilës do të ishin të pashmangshme pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e arsyeshme që cilësojnë të kundërtën.

Gjithashtu, depozitari mban përgjegjësi ndaj AIF-së ose investitorëve të AIF-së, për të gjitha humbjet e tjera të shkaktuara si rezultat i neglizhencës ose mospërbushjes me dashje siç duhet të detyrimeve të tij, në përputhje me këtë direktivë.

13. Detyrimi i depozitarit nuk ndikohet nga asnjë delegim i përmendur në paragrafin 11.

Pavarësisht nga nënparagrafi i parë i këtij paragrafi, në rastin e humbjes së instrumentit financiar nën kujdestarinë e një pale të tretë, në përputhje me paragrafin 11, depozitari mund të shkarkohet nga detyrimi, nëse vërtetohet:

a) përbushja e të gjitha kërkesave të delegimit të detyrave të kujdestarisë, të përcaktuara në nënparagrafin e dytë të paragrafit 11;

b) transferimi i shprehur i detyrimit të depozitarit ndaj palës së tretë, sipas kontratës me shkrim ndërmjet tyre, dhe që bën të mundur ngritjen e pretendimeve të AIF-së ose të AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, ndaj palës së tretë, në lidhje me humbjen e instrumenteve financiare ose ngritjen e pretendimit nga depozitari në emër të tyre; dhe

c) lejimi shprehimisht i detyrimit të depozitarit, sipas kontratës me shkrim ndërmjet depozitarit dhe AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, dhe që cakton arsye objektive në lidhje me kontraktimin e këtij shkarkimi.

14. Përveç kësaj, nëse ligji i vendit të tretë i kërkon subjektit vendor mbajtjen nën kujdestari të instrumenteve të caktuara financiare dhe nëse nuk ka subjekte vendore që përbushin kërkesat e delegimit të përcaktuara në pikën II, germa "d" të paragrafit 11, depozitari mund të shkarkohet nga detyrimi, me kusht që të plotësojë kushtet si më poshtë:

a) rregullat ose dokumentet e themelimit të AIF-së përkatëse të lejojnë shprehimisht këtë shkarkim, sipas kushteve të përcaktuara në këtë paragraf;

b) investitorët e AIF-së përkatëse të informohen siç duhet në lidhje me këtë shkarkim dhe me rrethanat që justifikojnë shkarkimin, përpara se ata të fillojnë investimin;

c) AIF-ja ose AIFM-ja për llogari të AIF-së të ketë udhëzuar depozitarin për delegimin e kujdestarisë së këtyre instrumenteve financiare te subjektet vendore;

d) të jetë lidhur një kontratë me shkrim ndërmjet depozitarit dhe AIF-së ose AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, e cila lejon shprehimisht këtë shkarkim; dhe

e) të jetë lidhur një kontratë me shkrim mes depozitarit ndaj palës së tretë, që bën të mundur transferimin e detyrimit të depozitarit ndaj subjektit vendor dhe që bën të mundur

ngritjen e pretendimeve të AIF-së ose të AIFM-së që vepron për llogari të AIF-së, ndaj subjektit vendor, në lidhje me humbjen e instrumenteve financiare ose ngritjen e pretendimit nga depozitari në emër të tyre.

15. Përgjegjësia kundrejt investitorëve të AIF-së mund të kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet AIFM-së, në varësi të natyrës ligjore të marrëdhënies ndërmjet depozitarit, AIFM-së dhe investitorëve.

16. Depozitari i vendos në dispozicion autoriteteve kompetente, me kërkesë të tyre, të gjithë informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave, i cili mund t'u nevojitet autoriteteve kompetente të AIF-së ose AIFM-së. Nëse autoritetet kompetente të AIF-së ose AIFM-së janë të ndryshme nga depozitari, autoritetet kompetente të depozitarit shkëmbejnë pa vonesë informacionin e marrë me autoritetet kompetente të AIF-së dhe AIFM-së.

17. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) të dhënat që duhet të përfshihen në kontratën me shkrim të përmendur në paragrafin 2;

b) kriteret e përgjithshme për të vlerësuar nëse rregullorja prudenciale dhe mbikëqyrja e vendeve të treta të përmendura në germën "b" të paragrafit 6 kanë të njëjtin efekt si legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe nëse zbatohen në mënyrë efektive;

c) realizimin e funksioneve depozitare sipas paragrafit 7, 8 dhe 9, duke përfshirë:

I. llojin e instrumenteve financiare që duhet të përfshihen në objektin e detyrave depozitare të kujdestarisë, në përputhje me germën "a" të paragrafit 8;

II. kushtet sipas të cilave depozitari mund të ushtrojë detyrat e kujdestarisë mbi këto instrumente financiare të regjistruara nga depozitari qendror; dhe

II. kushtet sipas të cilave depozitari duhet të ruajë instrumentet financiare të emetuara në formë normative dhe të regjistruara nga emetuesi ose regjistri, në përputhje me germën "b" të paragrafit 8;

d) detyrat e kujdesit të duhur të depozitarit, sipas germës "c" të paragrafit 11;

e) detyrimin e ndarjes, sipas germën "d", pika III të paragrafit 11;

f) kushtet dhe rrethanat kur instrumentet e mbajtura financiare duhet të konsiderohen si të humbura;

g) çfarë nënkuptohet me ngjarjeje të jashtme përtej kontrollit të arsyeshëm, pasojat e të cilës do të ishin të pashmangshme pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e arsyeshme që cilësojnë të kundërtën, sipas paragrafit 12;

h) kushtet dhe rrethanat kur ka një arsye objektive për të lidhur kontratë për një shkarkim, sipas paragrafit 13.

KAPITULLI IV

KËRKESAT E TRANSPARENCËS

Neni 22

Raporti vjetor

1. AIFM-ja vendos në dispozicion një raport vjetor, për çdo AIF të BE-së që ajo administron dhe për çdo AIF që ajo tregton në BE, për çdo vit financiar dhe jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të këtij viti financiar. Ky raport vjetor u ofrohet investitorëve me kërkesë të tyre. Raporti vjetor vendoset në dispozicion të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së dhe, sipas rastit, shtetit anëtar pritës së AIF-së.

Kur AIF-së i kërkohet të publikojë një raport financiar vjetor në përputhje me Direktivën 2004/109/EC, investitorëve duhet t'u jepet me kërkesë të tyre vetëm informacioni shtesë i përmendur në paragrafin 2, veçmas ose si pjesë plotësuese e raportit financiar vjetor. Në rastin e dytë, raporti financiar vjetor bëhet publik jo më vonë se 4 muaj pas përfundimit të vitit financiar.

2. Raporti vjetor përmban të paktën sa më poshtë:

- a) bilancin ose pasqyrën e aktiveve dhe pasiveve;
- b) pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin financiar;
- c) raportin lidhur me veprimtaritë gjatë vitit financiar;
- d) çdo ndryshim material të informacioneve të renditura në nenin 23, gjatë vitit financiar që mbulon ky raport;
- e) sasinë totale të shpërblimeve gjatë vitit financiar, të ndara në shpërblime fikse dhe të ndryshueshme, që AIFM-ja i paguan stafit të saj, dhe numrin e përfituesve dhe, sipas rastit, interesin e mbajtur nga AIF-ja;
- f) sasinë e agreguar të shpërblimit, të ndarë sipas drejtuesve të lartë dhe anëtarëve të stafit të AIFM-së, masat e të cilës kanë ndikim material mbi profilin e rrezikut të AIF-së.

3. Informacioni kontabël i paraqitur në raportin vjetor përgatitet në përputhje me standardet kontabël të shtetit anëtar të origjinës së AIF-së, ose në përputhje me standardet kontabël të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja, dhe me rregullat kontabël të përcaktuara në rregullat e AIF-së ose në dokumentet e themelimit.

Informacioni kontabël i paraqitur në raportin vjetor vlerësohet nga një ose më shumë persona të autorizuar me ligj për auditin e llogarive në përputhje me Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 maj 2006, "Për auditet statusore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara". I gjithë raporti i ekspertit kontabël, përfshirë çdo kualifikim, paraqitet në raportin vjetor.

Duke deroguar nga nënparagrafi i dytë, shtetet anëtare mund t'i lejojnë AIFM-ve që tregtojnë AIF jashtë BE-së që t'i bëjnë raportet e këtyre AIF-ve objekt të auditimit për arritjen e standardeve ndërkombëtare të auditit në fuqi në shtetin e regjistrimit të selisë së AIF-s.

4. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë përmbajtjen dhe formatin e raportit vjetor. Këto masa përshtaten me llojin e AIF-së për të cilat zbatohen.

Neni 23

Informimi i investitorëve

1. Për çdo AIF të BE-së që administrojnë AIFM-të dhe për çdo AIF që ato tregtojnë në BE, AIFM-të vendosin në dispozicion të investitorëve të AIF-së përpara se këta të fundit të investojnë në këto AIF, në përputhje me rregullat e AIF-së ose me instrumentet e themelimit, informacionin e mëposhtëm dhe çdo ndryshim material të këtij informacioni:

a) një përshkrim të strategjisë së investimeve dhe objektivave të AIF-së, informacione se ku është themeluar AIF-ja kryesore dhe se ku janë vendosur fondet bazë nëse AIF-ja është një fond nga fondet, një përshkrim të llojeve të aktiveve ku mund të investojë kjo AIF, teknikat që mund të përdorë dhe të gjitha rreziqet përkatëse, çdo kufizim i zbatueshëm në investime, rrethanat kur kjo AIF mund të përdorë borxhin nominal, llojet dhe burimet e borxhit nominal të lejuar dhe rreziqet përkatëse, çdo kufizim për përdorimin e borxhit nominal dhe çdo kolateral dhe marrëveshje për ripërdorimin e aktiveve, dhe nivelin maksimal të borxhit nominal që AIFM-ja ka të drejtë të përdorë për llogari të AIF-së;

b) një përshkrim të procedurave sipas të cilave AIF-ja mund të ndryshojë strategjinë e investimit ose politikën e investimit, ose të dyja;

c) një përshkrim të implikimeve kryesore juridike të marrëdhënieve kontraktuale të nënshkruara për qëllime të investimit, duke përfshirë informacione për juridiksionin, për legjislacionin në fuqi dhe ekzistencën ose mosekzistencën e instrumenteve ligjore që parashikojnë njohjen dhe zbatimin e gjykimeve në territorin ku është themeluar AIF-ja;

d) identitetin e AIFM-së, depozitarit të AIF-së, audituesit dhe çdo ofruesi tjetër të shërbimeve dhe një përshkrim të detyrave të tyre dhe të drejtave të investitorëve;

e) një përshkrim të mënyrës se si AIFM-ja përmbush kërkesat e nenit 9, paragrafi 7;

f) një përshkrim të çdo funksioni të administrimit që AIFM-ja ka deleguar, siç përmendet në shtojcën I dhe të çdo funksioni të ruajtjes që depozitari ka deleguar, identifikimin e të deleguarit dhe çdo konflikt interesi që rrjedh nga këto delegime;

g) një përshkrim të procedurës së vlerësimit të AIF-së dhe metodologjisë së vendosjes së çmimeve për vlerësimin e aseteve, duke përfshirë metodat e përdorura në vlerësimin e aseteve të vështira për t'u vlerësuar, në përputhje me nenin 19;

h) një përshkrim të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të AIF-së, duke përfshirë të drejtat e kompensimit si në rrethana normale ashtu edhe në rrethana të jashtëzakonshme, si dhe marrëveshjet ekzistuese të kompensimit të lidhura me investitorët;

i) një përshkrim të të gjitha tarifave, taksave dhe shpenzimeve dhe shumat maksimale të tyre që mbulohen drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga investitorët;

j) një përshkrim të mënyrës se si AIFM-ja garanton trajtimin e drejtë të investitorëve, kurdoherë që investitori përfiton trajtim preferencial ose të drejtën e trajtimit preferencial, përshkrimin e këtij trajtimi preferencial, llojin e investitorëve që përfitojnë këtë trajtim preferencial dhe, sipas rastit, marrëdhëniet e tyre juridike ose ekonomike me AIF-në ose AIFM-në;

k) raportin vjetor më të fundit, të përmendur në nenin 22;

l) procedurën dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së kuotave ose aksioneve;

m) vlerën më të fundit neto të aktiveve të AIF-së ose çmimin më të fundit të tregut të kuotave ose aksioneve të AIF-së, në përputhje me nenin 19;

n) sipas rastit, performancën historike të AIF-së;

o) identitetin e brokerit primar dhe përshkrimin e çdo marrëveshje materiale të AIF-së me brokerat primar dhe mënyrën e administrimit të konflikteve të interesit që lidhen me to, dhe dispozitën e kontratës të nënshkruar me depozitarin për mundësinë e transferimit dhe ripërdorimit të aktiveve të AIF-së, si dhe informacione në lidhje me çdo transferim të detyrimeve ekzistuese të brokeri primar;

p) një përshkrim të mënyrës dhe kohës së komunikimit të informacionit të kërkuar sipas paragrafëve 4 dhe 5.

2. AIFM-ja informon investitorët përpara se ata të investojnë në AIF për çdo marrëveshje të lidhur me depozitarin për ta shkarkuar veten me kontratë nga çdo detyrim, në përputhje me nenin 21, paragrafi 13. Gjithashtu, AIFM-ja informon pa vonesë investitorët për çdo ndryshim në lidhje me detyrimin e depozitarit.

3. Kur AIF-së i kërkohet të publikojë një prospekt në përputhje me Direktivën 2003/71/KE, ose në përputhje me legjislacionin e brendshëm, vetëm informacioni i përmendur në paragrafët 1 dhe 2, përveç informacionit të përfshirë në prospekt, duhet të komunikohet veçmas ose si informacion plotësues i prospektit.

4. Për çdo AIF të BE-së nën administrimin e tyre dhe për do AIF që tregtojnë në BE, AIFM-të u komunikojnë investitorëve në mënyrë periodike:

a) përqindjen e aktiveve të AIF-së, të cilat janë objekt i marrëveshjeve të veçanta që rrjedhin nga natyra e tyre jolikuide;

b) çdo marrëveshje të re për administrimin e likuiditetit të AIF-së;

c) profilin aktual të rrezikut të AIF-së dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut të përdorura nga AIFM-ja për menaxhimin e rrezikut.

5. AIFM-të që administrojnë AIF-të e BE-së, të cilat përdorin borxh nominal ose tregtojnë në BE AIF që përdorin borxh nominal, duhet të përcjellin rregullisht informacion për secilën nga këto AIF:

a) çdo ndryshim të nivelit maksimal të borxhit nominal që AIFM-ja mund të përdorë për llogari të AIF-së, si dhe të drejtën e ripërdorimit të kolateralit ose çdo garancie të dhënë sipas marrëveshjes së borxhit nominal;

b) sasinë totale të borxhit nominal të përdorur nga kjo AIF.

6. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë detyrimet për informim të AIFM-ve të përmendura në paragrafët 4 dhe 5, duke përfshirë frekuencën e informimit të përmendur në paragrafin 5. Këto masa përshtaten me llojin e AIGM-së për të cilat zbatohen.

Neni 24

Detyrimet e raportimit të autoritetet kompetente

1. AIFM-ja i raporton rregullisht autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës për tregjet dhe instrumentet kryesore ku ajo tregton për llogari të AIF-ve nën administrimin e saj.

Ajo jep informacion për instrumentet kryesorë të përdorur për tregtim, tregjet ku është anëtare dhe ku tregton në mënyrë aktive, dhe për ekspozimet kryesore dhe përqendrimet më të rëndësishme të çdo AIF-je që administron.

2. AIFM-ja i jep autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës, për çdo AIF të BE-së që ajo administron dhe për çdo AIF që ajo tregton në BE, informacionin e mëposhtëm:

a) përqindjen e aktiveve të AIF-së, të cilat janë objekt i marrëveshjeve të veçanta që rrjedhin nga natyra e tyre jolikuide;

b) çdo marrëveshje të re për administrimin e likuiditetit të AIF-së;

c) profilin aktual të rrezikut të AIF-së dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut të përdorura nga AIFM-ja për menaxhimin e rrezikut të tregut, rrezikut të likuiditetit, rrezikut të kundërpalëve dhe rreziqe të tjera, duke përfshirë edhe rrezikun operacional;

d) informacione lidhur me kategoritë kryesore të aktiveve ku ka investuar kjo AIF; dhe

e) rezultatet e testeve të stresit të kryera në përputhje me germën "b" të nenit 15, paragrafi 3 dhe me nënparagrafin e dytë të nenit 16, paragrafi 1.

3. Me paraqitjen e një kërkesë, AIFM-ja u jep autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës, dokumentet e mëposhtme:

a) një raport vjetor të çdo AIF-je të BE-së nën administrimin e AIFM-së dhe çdo AIF që ajo tregton në BE, për çdo vit financiar dhe në përputhje me nenin 22, paragrafi 1;

b) në fund të çdo tremujori, listën e detajuar për të gjitha AIF-të nën administrimin e AIFM-së.

4. AIFM-ja që administron AIF, të cilat përdorin në baza të konsiderueshme borxhin nominal, duhet të vendosin në dispozicion të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës informacione lidhur me nivelin e përgjithshëm të borxhit nominal të përdorur nga çdo AIF nën administrimin e saj, një ndarje të borxhit nominal që lind nga huazimi i mjeteve monetare dhe i titujve dhe borxhit nominal të integruar në derivate financiare, si dhe masën e ripërdorimit të aktiveve të AIF-së sipas marrëveshjes së borxhit nominal.

Ky informacion duhet të përfshijë identitetin e pesë burimeve më të mëdha të mjeteve monetare ose të titujve për çdo AIF nën administrimin e AIFM-së, dhe shumat e borxhit nominal të marrë nga secili burim dhe për secilën nga këto AIF.

Për AIFM-të jashtë BE-së, detyrimet e raportimit të përmendura në këtë paragraf kufizohen vetëm për AIF-të e BE-së nën administrimin e tyre dhe AIF-të jashtë BE-së që ato tregtojnë në BE.

5. Kur nevojitet për monitorimin efektiv të rrezikut sistemik, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës mund të kërkojnë informacion shtesë përveç informacionit të përmendur në këtë nen, në mënyrë periodike dhe të posaçme. Autoritetet kompetente informojnë ESMA-n në lidhje me kërkesat për informacion shtesë.

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe kur kërkohet për të garantuar qëndrueshmërinë dhe integritetin e sistemit financiar, ose për të nxitur një rritje të qëndrueshme afatgjatë, ESMA mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të vendosin kërkesa të tjera raportimi.

6. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë:

a) se kur duhet të përdoret borxhi nominal mbi baza të konsiderueshme për qëllimet e paragrafit 4; dhe

b) detyrimet për të raportuar dhe për të dhënë informacionin e parashikuar në këtë nen.

Këto masa marrin parasysh nevojën për të shmangur barrën e tepërt administrative të autoriteteve kompetente.

KAPITULLI V

AIFM-TË QË ADMINISTROJNË LLOJE TË VEÇANTA TË AIF-VE

SEKSIONI 1

AIFM-TË QË ADMINISTRROJNË AIF-TË E LËVRUARA

Neni 25

Përdorimi i informacionit nga autoritetet kompetente, bashkëpunimi mbikëqyrës dhe kufijtë e borxhit nominal

1. Shtetet anëtare sigurohen që autoritet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të AIFM-së të përdorin informacionin e grumbulluar sipas nenit 24, me qëllim identifikimin e masës së përdorimit të kontributeve të borxhit nominal për ndërtimin e rrezikut sistemik në sistemin financiar, rreziqet e tregjeve të parregulluara ose rreziqet ndaj rritjes afat-gjatë të ekonomisë.

2. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së sigurohen që të gjitha informacionet e grumbulluara sipas nenit 24 në lidhje me të gjitha AIFM-të nën mbikëqyrjen e tyre dhe informacioni i grumbulluar sipas nenit 7, të vendoset në dispozicion të autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare, ESMA-s dhe ESRB-së përmes procedurave të përcaktuara në nenin 50 lidhur me bashkëpunimin mbikëqyrës. Ato, pa vonesë, ofrojnë gjithashtu mënyrat e këtyre procedurave, dhe në plan dypalësh për autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare të lidhura drejtpërsëdrejti, nëse një AIFM sipas përgjegjësisë së tyre, ose një AIF e administruar nga një AIFM mund të shërbejë si burim i rëndësishëm për rrezikun e kundërpalës në një institucion kreditor ose për institucione sistemike të tjera përkatëse në shtetet e tjera anëtare.

3. AIFM-ja duhet të provojë se kufijtë e borxhit nominal për çdo AIF nën administrimin e saj janë në çdo kohë të arsyeshëm dhe në përputhje me këta kufij. Autoritetet kompetente vlerësojnë rreziqet që mund të shfaqen përmes përdorimit të borxhit nominal nga një AIFM, në lidhje me AIF-të nën administrimin e saj, dhe, nëse shihet e nevojshme për qëllimet e garantimit të qëndrueshmërisë dhe të integritetit të sistemit financiar, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, pasi të kenë njoftuar ESMA-n, ESRB-në dhe autoritetet kompetente të AIF-së përkatëse, caktojnë kufijtë në nivelin e borxhit nominal që janë e drejtë e një AIFM-je ose të kufizimeve të tjera për administrimin e AIF-së, në lidhje me AIF-të nën administrimin e saj, për kufizimin e masës, sipas të cilës borxhi nominal kontribuon në ndërtimin e rrezikut sistemik në sistemin financiar ose të rreziqeve të tregjeve të parregullta. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë siç duhet ESMA-n, ESRB-në dhe autoritetet kompetente të AIF-së lidhur me masat e ndërmarra në këtë drejtim, përmes procedurave të përcaktuara në nenin 50.

4. Njoftimi i përmendur në paragrafin 3 përcillet jo më pak se 10 ditë pune përpara se të hyjë në fuqi ose të rinovohet masa e propozuar. Ky njoftim duhet të përmbajë të dhënat e masës së propozuar, arsyet për këtë masë dhe kohën kur kjo masë hyn në fuqi. Në rrethana të jashtëzakonshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së mund të vendosin që masa e propozuar të hyjë në fuqi brenda afatit të përmendur në fjalinë e parë.

5. ESMA ushtron rol lehtësues dhe koordinues dhe përpaket veçanërisht të sigurojë që autoritetet kompetente të kenë një qasje të qëndrueshme në lidhje me masat e propozuara nga autoritetet kompetente sipas paragrafit 3.

6. Pas marrjes së njoftimit të përmendur në paragrafin 3, ESMA u jep këshilla autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së në lidhje me masën që e propozuar ose të marrë. Kjo këshillë mund të trajtojë veçanërisht nëse janë përmbushur kushtet për marrjen e masave, nëse ato janë të përshtatshme dhe kohëzgjatjen e tyre.

7. Në bazë të informacionit të marrë në përputhje me paragrafin 2 dhe pas marrjes në konsideratë të çdo këshille të ESRB-së, ESMA mund të përcaktojë se borxhi nominal i përdorur nga një AIFM, ose nga një grup i AIFM-ve, shfaq një rrezik të konsiderueshëm për qëndrueshmërinë dhe integritetin e sistemit financiar, dhe mund të japë këshilla për autoritetet kompetente, duke specifikuar masat korrigjuese që duhet marrë, duke përfshirë kufijtë e nivelit të borxhit nominal, të cilat AIFM-të, ose grupet e AIFM-ve kanë të drejtë të përdorin. Për çdo përcaktim të tillë, ESMA menjëherë informon autoritetet kompetente të interesuara, Bordin Evropian të Riskut Sistemik dhe Komisionin.

8. Nëse një autoritet kompetent propozon të marrë masa kundër këshillës së ESMA-s të përmendur në paragrafin 6 ose 7, ai njofton ESMA-n duke cituar arsyet përkatëse. ESMA mund të publikojë faktin se autoriteti kompetent nuk pajtohet ose nuk synon të pajtohet me këshillën e saj. ESMA mund të vendosë të publikojë rast pas rasti arsyet e dhëna nga autoriteti kompetent për mospajtimin me këshillat e saj. Autoritetet kompetente në fjalë njoftohen paraprakisht lidhur me këtë publikim.

9. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat, në lidhje me përcaktimin e parimeve që specifikojnë rrethanat, në të cilat autoritetet kompetente zbatojnë dispozitat e përcaktuara në paragrafin 3, duke marrë në konsideratë strategjitë e ndryshme të AIF-ve, kushtet e ndryshme të tregut, në të cilat AIF-të operojnë, dhe efektet e mundshme prociklike nga zbatimi i këtyre dispozitave.

SEKSIONI 2

DETYRIMET PËR AIFM-TË ADMINISTRUESE TË AIF-VE QË FITOJNË KONTROLLIN E SHOQËRIVE DHE EMETUESVE TË PARENDITUR

Neni 26

Fusha e zbatimit

1. Ky seksion zbatohet për sa më poshtë:

a) AIFM-të administruese të një ose më shumë AIF-ve, të cilat në mënyrë individuale ose të përbashkët, mbi bazën e një marrëveshjeje që synon fitimin e kontrollit, e fitojnë kontrollin e një shoqërie të parenditur, në përputhje me paragrafin 5;

b) AIFM-të që bashkëpunojnë me një ose më shumë AIFM të tjera, mbi bazën e një marrëveshjeje, në përputhje me të cilat AIF-të e administruara bashkërisht nga këto AIFM, fitojnë kontrollin e një shoqërie të parenditur, në përputhje me paragrafin 5.

2. Ky seksion nuk zbatohet në rastin kur shoqëritë e parenditura në fjalë janë:

a) sipërmarrje të vogla dhe të mesme brenda kuptimit të nenit 2, paragrafi 1 të shtojcës së rekomandimit të Komisionit 2003/361/KE, datë 6 maj 2003, "Për përkufizimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme"; ose

b) mjete për qëllime të veçanta me synim blerjen, mbajtjen ose administrimin e pasurive të patundshme.

3. Pa cenuar paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, neni 27, paragrafi 1 mund të zbatohet për AIFM-të administruese të AIF-ve që fitojnë një pjesëmarrje të pakontrolluar në një shoqëri të parenditur.

4. Neni 28, paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe neni 30 zbatohet gjithashtu për AIFM-të që administrojnë AIF që fitojnë kontrollin e çështjeve. Për qëllime të këtyre neneve, paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen rast pas rasti.

5. Për qëllimet e këtij seksioni, në lidhje me shoqëritë e parenditura, kontroll do të thotë mbi 50% të të drejtave të votës së shoqërive.

Për llogaritjen e përqindjes së të drejtave të votës të çdo AIF-je përkatëse, përveç të drejtave të votës që AIF-ja përkatëse mban drejtpërdrejtë, duhet të merren parasysh të drejtat e mëposhtme të votës, të cilat janë objekt kontrolli, siç përmendet në nënparagrafin e parë, duke themeluar:

a) një sipërmarrje të kontrolluar nga AIF-ja; dhe

b) një person fizik ose juridik që vepron në emër të tij, por për llogari të AIF-së ose për llogari të një sipërmarrje të kontrolluar nga AIF-ja.

Përqindja e të drejtave të votës llogaritet në bazë të të gjitha aksioneve me të drejtë vote, edhe nëse është pezulluar ushtrimi i tyre.

Pavarësisht nga pika I e nenit 4, paragrafi 1, për qëllime të nenit 28, paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe të nenit 30, kontrolli i emetuesve përcaktohet në përputhje me nenin 5, paragrafi të Direktivës 2004/25/KE.

6. Ky seksion zbatohet në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në nenin 6 të Direktivës 2002/14/KE.

7. Ky seksion zbatohet pa cenuar asnjë rregull më strikt të miratuara nga shtetet anëtare, në lidhje me blerjen e sipërmarrjeve për emetuesit dhe shoqëritë e parenditura në territoret e tyre.

Neni 27

Njoftimi i blerjes së sipërmarrjeve të mëdha dhe kontrolli i shoqërive të parenditura

1. Shtetet anëtare kërkojnë që, në rastin kur një AIF blen, eliminon ose mban aksionet e një shoqërie të parenditur, AIFM-ja administruese e një AIF-je të tillë njofton autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj mbi proporcionin e të drejtave të votës së

shoqërive të parenditura që mbahen nga AIF-ja në çdo kohë, në rastin kur arrihet proporcioni, tejkalon ose bie nën kufijtë e 10%, 20%, 30%, 50% dhe 75%.

2. Shtetet anëtare kërkojnë që, kur AIF-ja, në mënyrë individuale ose të përbashkët, fiton kontrollin mbi një shoqëri të parenditur, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 5 të këtij neni, AIFM administruese e kësaj AIF-je njofton mbi fitimin e kontrollit të AIF-së subjektet si më poshtë:

a) shoqëria e parenditur;

b) aksionarët, për të cilët identitetet dhe adresat vihen në dispozicion të AIFM-së ose mund të vihen në dispozicion të shoqërisë së parenditur ose përmes një regjistri, për të cilin AIFM-ja ka ose fiton aksesin; dhe

c) autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës për AIFM-në;

3. Njoftimi i kërkuar sipas paragrafit 2 duhet të përmbajë informacionet shtesë të mëposhtme:

a) situatën si rrjedhojë e të drejtave të votës;

b) kushtet sipas të cilave është fituar kontrolli, duke përfshirë informacione lidhur me identitetin e aksionarëve të ndryshëm të përfshirë, çdo person fizik ose subjekt juridik me të drejtë vote për llogari të tyre dhe, sipas rastit, zinxhirin e sipërmarrjeve përmes së cilave mbahen në mënyrë efektive të drejtat e votës;

c) datën kur është fituar kontrolli.

4. Në njoftimin e saj për shoqërinë e parenditur, AIFM-ja kërkon nga bordi i drejtuesve të shoqërisë informimin e përfaqësuesve të punëmarrësve ose, nëse nuk ka të tillë, të vetë punonjësve, pa vonesa të papërshtatshme në lidhje me blerjen e kontrollit të AIF-së së administruar nga AIFM-ja dhe mbi informacionin e përmendur në paragrafin 3. AIFM-ja përpiqet maksimalisht të garantojë që bordi i drejtuesve të informojë përfaqësuesit e punëmarrësve ose, në rastin kur nuk ka të tillë, vetë punonjësit, në përputhje me këtë nen.

5. Njoftimet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 kryhen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë punë pas datës, në të cilën AIF-ja ka arritur, tejkaluar ose ka rënë nën nivelin e kufirit përkatës, ose ka fituar kontrollin mbi shoqërinë e parenditur.

Neni 28

Zbulimi i informacionit në rastin e fitimit të kontrollit

1. Shtetet anëtare kërkojnë që, kur AIF-ja fiton kontrollin mbi një shoqëri të parenditur, në mënyrë individuale ose të përbashkët, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 5 të këtij neni, AIFM administruese e kësaj AIF-je t'i përcjellë subjektet e mëposhtme lidhur me fitimin e kontrollit të AIF-së:

a) shoqërisë përkatëse;

b) aksionarëve të shoqërisë, identitetet dhe adresat e të cilëve janë vendosur në dispozicion të AIFM-së ose mund të vendosen në dispozicion nga shoqëria ose përmes një regjistri ku AIFM-ja ka ose mund të fitojë akses; dhe

c) autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së.

Shtetet anëtare mund të kërkojnë që informacioni i përmendur në paragrafin 2 të vihet gjithashtu në dispozicion të autoriteteve kompetente të shoqërisë së përenditur, që shtetet anëtare mund të caktojnë për këtë qëllim.

2. AIFM-ja vë në dispozicion:

a) identitetin e AIFM-ve administruese të AIF-ve kanë fituar kontrollin, në mënyrë individuale ose në marrëveshje me AIFM-të e tjera;

b) politika për parandalimin dhe administrimin e konflikteve të interesit, në veçanti ndërmjet AIFM-së, AIF-së dhe shoqërisë, duke përfshirë informacionin mbi masat mbrojtëse specifike, për garantimin që çdo marrëveshje ndërmjet AIFM-së dhe/ose AIF-së dhe shoqërisë të nënshkruhet në kushtet normale të konkurrencës; dhe

c) politika për komunikimin e jashtëm dhe të brendshëm lidhur me shoqërinë, veçanërisht për sa u përket punonjësve.

3. Në njoftimin e shoqërisë në përputhje me germën "a" të paragrafit 1, AIFM-ja kërkon nga bordi i drejtuesve të shoqërisë informimin e përfaqësuesve të punëmarrësve ose, nëse nuk ka të tillë, të vetë punonjësve, pa vonesa të papërshtatshme, informacionin e përmendur në paragrafin 1. AIFM-ja përpiqet maksimalisht të garantojë që bordi i drejtuesve të informojë përfaqësuesit e punëmarrësve ose, në rastin kur nuk ka të tillë, vetë punonjësit, në përputhje me këtë nen.

4. Shtetet anëtare kërkojnë që, kur AIF-ja fiton kontrollin mbi një shoqëri të përenditur, në mënyrë individuale ose të përbashkët, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 5 të këtij neni, AIFM-ja administruese e kësaj AIF-je të garantojë që AIF-ja, ose AIFM-ja që vepron në emër të AIF-së, të paraqesë objektivat e saj lidhur me të ardhmen e biznesit të shoqërisë së përenditur dhe ndikimet e mundshme në punësim, duke përfshirë çdo ndryshim material në kushtet e punësimit, për:

a) shoqërinë e përenditur; dhe

b) aksionarët e shoqërisë së përenditur, identitetet dhe adresat e të cilëve janë vendosur në dispozicion të AIFM-së ose mund të vendosen në dispozicion nga shoqëria e përenditur ose përmes një regjistri ku AIFM-ja ka ose mund të fitojë akses.

Përveç kësaj, AIFM-ja që administron AIF-të përkatëse kërkon dhe përdor përpjekjet më të mira për garantimin që bordi i drejtuesve të shoqërisë së përenditur vë në dispozicion

informacionin e përcaktuar në nënparagrafin e parë të përfaqësuesve të punonjësve ose, nëse nuk ka të tillë, të vetë punonjësve të shoqërisë së përenditur.

5. Shtetet anëtare kërkojnë që, kur AIF-ja fiton kontrollin mbi një shoqëri të përenditur, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 5 të këtij neni, AIFM-ja administruese e kësaj AIF-je u siguron autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tij dhe të investitorëve të AIF-ve informacionin mbi financimin e blerjes.

Neni 29

Dispozitat specifike në lidhje me raportin vjetor të AIF-ve që ushtrojnë kontrollin për shoqëritë e përenditura

1. Shtetet anëtare kërkojnë që, kur AIF-ja, në mënyrë individuale ose të përbashkët, fiton kontrollin të një shoqërie të përenditur, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 5 të këtij neni, AIFM administruese e kësaj AIF-je:

a) kërkesa dhe përdorimi i përpjekjeve më të mira për garantimin që raporti vjetor i shoqërisë së përenditur, i cili hartohet në përputhje me paragrafin 2 të vihet në dispozicion përmes bordit të drejtuesve të shoqërisë për përfaqësuesit e punëmarrësve ose, nëse nuk ka të tillë, për vetë punonjësit, brenda periudhës, gjatë së cilës raporti vjetor duhet të hartohet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm; ose

b) ose për çdo AIF të tillë, të përfshijnë në raportin vjetor të parashikuar në nenin 22, informacionin e përmendur në paragrafin 2, në lidhje me shoqërinë përkatëse të përenditur.

2. Informacioni shtesë që do të përfshihen në raportin vjetor të shoqërisë ose të AIF-së, në përputhje me paragrafin 1, duhet të paktën të përfshijë rishikimin e drejtë të zhvillimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë që përfaqëson situatën në fundin e periudhës së mbuluar nga raporti vjetor. Gjithashtu, në raport duhet të jepet informacion për:

a) çdo ngjarje të rëndësishme që ka ndodhur që nga përfundimi i vitit financiar;

b) zhvillimin e parashikuar të ndërmarrjes; dhe

c) blerjet e aksioneve vetjake të përshkruara në nenin 22, paragrafi 2 i Direktivës 77/91/BE.

3. AIFM-ja administruese e AIF-së përkatëse:

a) kërkesa dhe përpjekjet maksimale për garantimin që bordi i drejtuesve të shoqërisë së përenditur vë në dispozicion informacionin e përmendur në germën "b" të paragrafi 1 në lidhje me shoqërinë përkatëse për përfaqësuesit e punonjësve të kësaj të fundit ose, nëse nuk ka të tilla, për vetë punonjësit, brenda periudhës së përmendur në nenin 22, paragrafi 1; ose

b) vë në dispozicion informacionin e përmendur në germën "a" të paragrafit 1 për investitorët e AIF-së, për aq kohë sa vihet në dispozicion, brenda periudhës së përmendur në

nenin 22, paragrafi 1 dhe, në çdo rast jo më vonë se data, në të cilën hartohet raporti vjetor i shoqërisë së përnditur, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm.

Neni 30

Shitja pjesë pjesë e aktiveve

1. Shtetet anëtare kërkojnë që kur AIF-ja fiton kontrollin mbi një shoqëri të përnditur, në mënyrë individuale ose të përbashkët, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, së bashku me paragrafin 5 të këtij neni, AIFM-ja administruuese e kësaj AIF-je, për një periudhë prej 24 muajsh pasi AIF-ja të ketë fituar kontrollin e shoqërisë:

a) të mos lejohet të lehtësojë, mbështesë ose udhëzojë çdo shpërndarje, reduktim kapitali, të drejtë kompensimi për aksionet dhe/ose blerjet e aksioneve vetjake nga shoqëria, siç përshkruhet në paragrafin 2;

b) për sa kohë që AIFM-ja është e autorizuar të votojë për llogari të AIF-së në mbledhjet e organeve drejtuese të shoqërisë, të mos votojë në favor të shpërndarjes, reduktimit të kapitalit, të drejtës së kompensimit për aksionet dhe/ose blerjet e aksioneve vetjake nga shoqëria, siç përshkruhet në paragrafin 2; dhe

c) në çdo rast, të bëjë përpjekje maksimale për të parandaluar shpërndarjet, reduktimin e kapitalit, të drejtën e kompensimit për aksionet dhe/ose blerjet e aksioneve vetjake nga shoqëria, siç përshkruhet në paragrafin.

2. Detyrimet e vendosura ndaj AIFM-ve sipas paragrafit 1 lidhen me sa më poshtë:

a) çdo shpërndarje të kryer ndaj aksionarëve kur në ditën e mbylljes së vitit të fundit financiar, aktivet neto të përcaktuara në llogaritë vjetore të shoqërisë janë ose do të bëhen pas kësaj shpërndarje, më pak se shuma e kapitalit të nënshkruar plus rezervat të cilat mund të mos shpërndahen në bazë të ligjit ose statutit, duke rënë dakord se kur pjesa e pajustificuar e kapitalit të nënshkruar nuk është përfshirë në aktivet e pasqyruar në bilanc, kjo shumë zbritet nga shuma e kapitalit të nënshkruar;

b) çdo shpërndarje ndaj aksionarëve, kur kjo shumë tejkalon shumën e fitimeve në fund të vitit të fundit financiar, plus çdo fitim të arritur dhe shumat e tërhequra nga rezervat e disponueshme për këtë qëllim, minus çdo humbje e shkaktuar dhe shumë e vendosur për këtë rezervë në përputhje me ligjin ose statutin;

c) deri në masën që lejohen blerjet e aksioneve të veta, blerjet nga shoqëritë, duke përfshirë aksionet që shoqëria ka blerë më parë dhe që mban, si dhe aksionet e blera nga një person që vepron në emër të vet, por për llogari të shoqërisë, që do të ndikonte në reduktimin e aktiveve neto nën shumën e përmendur në germën "a".

3. Për qëllime të paragrafit 2:

a) termi "shpërndarje" i përmendur në germat "a" dhe "b" të paragrafit 2 përfshin, veçanërisht pagesën e dividendit dhe të interesave që lidhen me aksionet;

b) dispozitat për reduktimin e kapitalit nuk zbatohen për reduktimin e kapitalit të nënshkruar, qëllimi i të cilit është kompensimi i humbjeve të shkaktuara ose depozitimi i shumave të parave në rezerva që nuk shpërndahen me kusht që, pas këtij operacioni, shuma e këtyre rezervave të mos jetë më shumë se 10% e kapitalit të nënshkruar të nënshkruar; dhe

c) kufizimi i përcaktuar në germën "c" të paragrafit 2 është objekt i germave "b" deri në "h" të nenit 20, paragrafi 1 të Direktivës 77/91/KEE.

KAPITULLI VI

TË DREJTAT E AIFM-VE TË BE-SË PËR TË TREGTUAR DHE ADMINISTRUAR AIF TË BE-SË BRENDË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 31

Tregtimi i kuotave ose aksioneve të AIF-ve të BE-së në shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së

1. Shtetet anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar e BE-së të mund t'u tregtojë investitorëve profesionalë në shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së kuota ose aksione të ndonjë AIF-je të BE-së nën administrimin e saj, menjëherë sapo të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë nen.

Kur AIF-ja e BE-se është AIF furnizuese, e drejta për të tregtuar e përmendur në nënparagrafin e parë i nënshtrohet kushtit që AIF-ja kryesore të jetë gjithashtu AIF e BE-së, e cila administrohet nga një AIFM e autorizuar e BE-së.

2. AIFM-ja u dërgon autoriteteve kompetente të shtetit të saj të origjinës një njoftim në lidhje me çdo AIF të BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën III.

3. Brenda 20 ditëve pune pas marrjes së dosjes së plotë të njoftimit në përputhje me paragrafin 2, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë AIFM-në nëse ajo mund të nisë tregtimin e AIF-së të identifikuar në njoftimin e përmendur në paragrafin 2. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së parandalojnë tregtimin e AIF-së vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë, ose nëse AIFM-ja nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë. Në rast vendimi pozitiv, AIFM-ja mund të nisë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar të origjinës nga data e njoftimit nga autoritetet kompetente për këtë qëllim.

Për sa kohë që janë të ndryshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë gjithashtu edhe autoritetet kompetente të AIF-së që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së.

4. Në rastin e ndonjë ndryshimi material të ndonjë prej të dhënave të komunikuara në përputhje me paragrafin 2, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetet kompetente të shtetit anëtar të

originës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën 1 muaj përpara zbatimit të këtij ndryshimi në lidhje me çdo ndryshim të planifikuar nga AIFM-ja, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do ta respektojë më këtë direktivë ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do ta respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente përkatëse informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet ndonjë ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk e respekton më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk e respekton më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të originës së AIFM-së marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46, suke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin shprehimisht të tregtimit të AIF-së.

5. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar:

a) formën dhe përmbajtjen e modelit të shkresës së njoftimit, të përmendur në paragrafin 2; dhe

b) formën e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 4.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

6. Pa cenuar nenin 43, paragrafi 1, shtetet anëtare kërkojnë që AIF-të e administruara dhe të tregtuara nga AIFM-të, t'u tregtohen vetëm investitorëve profesional.

Neni 32

Tregtimi i kuotave ose aksioneve të AIF-ve të BE-së në shtetet anëtare, përveç se në shtetin anëtar të originës së AIFM-së

1. Shtetet anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar e BE-së të mund t'u tregtojë investitorëve profesionalë në një shtet tjetër anëtar nga ai i originës së AIFM-së kuota ose aksione të ndonjë AIF-je të BE-së nën administrimin e saj, menjëherë sapo të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë nen.

Kur AIF-ja e BE-se është AIF furnizuese, e drejta për të tregtuar e përmendur në nënparagrafin e parë i nënshtrohet kushtit që AIF-ja kryesore të jetë gjithashtu AIF e BE-së dhe të administrohet nga një AIFM e autorizuar e BE-së.

2. AIFM-ja u dërgon autoriteteve kompetente të shtetit të saj të originës një njoftim në lidhje me çdo AIF të BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën IV.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, brenda 20 ditëve pune pas datës së marrjes së dosjes së plotë së njoftimit të përmendur në paragrafin 2, u përcjellin dosjen e plotë të njoftimit autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku synohet të tregtohet kjo AIF. Përcjellja e kësaj dosjeje kryhet vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së respekton dhe vazhdon të respektojë këtë direktivë dhe nëse në të kundërt AIFM-ja e respekton këtë direktivë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së bashkëngjisin një deklaratë me synim që AIFM-ja në fjalë të autorizohet për administrimin e AIF-ve përmes një strategjie të veçantë të investimeve.

4. Pas përcjelljes së dosjes së njoftimit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së njoftojnë pa vonesë AIFM-në lidhur me përcjelljen e dosjes. AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar pritës të AIFM-së që nga data e këtij njoftimi.

Për sa kohë që janë të ndryshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë gjithashtu edhe autoritetet kompetente të AIF-së që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar pritës të AIFM-së.

5. Masat e përmendura në germën "h" të shtojcës IV janë objekt i ligjeve dhe mbikëqyrjes së shtetit anëtar pritës të AIFM-së.

6. Shtetet anëtare sigurohen që shkresa e njoftimit të AIFM-së e përmendur në paragrafin 2 dhe deklaratat e përmendur në paragrafin 3, të hartohen në një gjuhë që përdoret zakonisht në sferën e financave ndërkombëtare.

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet e tyre kompetente të pranojnë përcjelljen dhe dërgimin elektronik të dokumenteve të përmendura në paragrafin 3.

7. Në rastin e ndonjë ndryshimi material të ndonjë prej të dhënave të komunikuara në përputhje me paragrafin 2, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën 1 muaj përpara zbatimit të ndryshimeve të planifikuara, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do ta respektojë më këtë direktivë ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do ta respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente përkatëse informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet ndonjë ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do ta respektonte më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do ta respektonte më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin shprehimisht të tregtimit të AIF-së.

Nëse këto ndryshime pranohen për shkak se nuk pengojnë stafin drejtues të AIFM-së së AIF-së që të respektojë këtë direktivë, ose në të kundërt AIFM-në që të respektojë këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë pa vonesë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës së AIFM-së për këto ndryshime.

8. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar:

- a) formën dhe përmbajtjen e modelit të shkresës së njoftimit, të përmendur në paragrafin 2;
- b) formën dhe përmbajtjen e modelit të deklaratës, të përmendur në paragrafin 3;
- c) mënyrën e transmetimit të përmendur në paragrafin 3; dhe
- d) formën e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 7.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

9. Pa cenuar nenin 43, paragrafi 1, shtetet anëtare kërkojnë që AIF-të e administruara dhe të tregtuara nga kjo AIFM, t'u tregtohen vetëm investitorëve profesional.

Neni 33

Kushtet për administrimin e AIF-ve të BE-së të themeluara në shtetet të tjera anëtare

1. Shtetet Anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar e BE-së të mund të administrojë AIF të BE-së të themeluara në një shtet tjetër anëtar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes themelimit të një dege, me kusht që kjo AIFM të ketë autorizim për të administruar këtë lloj AIF-je.

2. Një AIFM që synon të administrojë AIF të BE-së të themeluara për herë të parë në një shtet tjetër anëtar i përcjell autoriteteve kompetente të shtetit të tij anëtar të origjinës informacionin e mëposhtëm:

a) shtetin anëtar ku synon të administrojë AIF-të në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes themelimit të një dege;

b) programin e operacioneve, veçanërisht duke cituar shërbimet që synon të kryejë dhe duke identifikuar AIF-të që synon të administrojë.

3. Nëse AIFM-ja synon të themelojë një degë, përveç informacionit të përmendur në paragrafin 2, ajo duhet të sigurojë edhe informacionin e mëposhtëm:

a) strukturën organizative të degës;

b) adresën në shtetin anëtar të origjinës së AIF-së, nga i cili mund të merren dokumentet;

c) emrat dhe të dhënat e personave përgjegjës për administrimin e degës.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, brenda 1 muaji nga marrja e dokumentacionit të plotë në përputhje me paragrafin 2 ose brenda 2 muajve nga marrja e dokumentacionit të plotë në përputhje me paragrafin 3, i përcjellin dokumentacionin e plotë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së. Përcjellja e këtij dokumentacioni kryhet vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së respekton dhe vazhdon të respektojë këtë direktivë dhe nëse në të kundërt AIFM-ja e respekton këtë direktivë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së bashkëngjisin një deklaratë ku citohet se AIFM-ja në fjalë disponon autorizimin e tyre.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së njoftojnë menjëherë AIFM-në lidhur me përcjelljen e dokumentacionit.

Pas marrjes së njoftimit të transmetimit, AIFM-ja mund të fillojë të ofrojë shërbimet e veta në shtetin anëtar pritës.

5. Shteti anëtar pritës i AIFM-së nuk duhet t'i paraqesë AIFM-së në fjalë kërkesa të tjera në lidhje me çështjet që mbulohen nga kjo direktivë.

6. Në rastin e ndryshimit të ndonjë informacioni të komunikuar në përputhje me paragrafin 2 dhe, sipas rastit, me paragrafin 3, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën një muaj përpara zbatimit të ndryshimeve të planifikuara, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do të respektonte më këtë direktivë ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do të respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet ndonjë ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do ta respektonte më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do ta respektonte më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46.

Nëse këto ndryshime pranohen për shkak se nuk pengojnë stafin drejtues të AIFM-së së AIF-së që të respektojë këtë direktivë, ose në të kundërt AIFM-në që të respektojë këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë pa vonesë autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së për këto ndryshime.

7. Për të garantuar harmonizimin e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike rregullatore për specifikimin e informacionit që duhet të përcillet në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

8. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për hartimin e formularëve, modeleve dhe procedurave standarde për përcjelljen e informacionit në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

KAPITULLI VII

RREGULLAT SPECIFIKE NË LIDHJE ME VENDET E TRETA

Neni 34

Kushtet për AIFM-të e BE-së që administrojnë AIF jashtë BE-së që nuk tregtohen në shtetet anëtare

1. Shtetet anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar e BE-së të mund të administrojë AIF jashtë BE-së të cilat nuk tregtohen brenda Bashkimit Evropian, me kusht që:

a) AIFM-ja të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë, përveç nenit 21 dhe 22 në lidhje me këto AIF; dhe

b) të jenë nënshkruar marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit mes autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, të paktën me qëllim garantimin e shkëmbimit efikas të informacionit që u lejon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë.

2. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 1, me qëllim hartimin e kuadrit të përbashkët për lehtësimin e caktimit të ardhshëm të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta.

3. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, EMSA harton udhëzimet për të përcaktuar kushtet e zbatimit të masave të miratuara nga Komisioni në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 1.

Neni 35

Kushtet për tregtimin me pasaportë brenda Bashkimit Evropian të një AIF-je jashtë BE-së të administruar nga një AIFM e BE-së

1. Shtetet anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar e BE-së të mund t'u tregtojë investitorëve profesional brenda Bashkimit Evropian kuota ose aksione të AIF-ve jashtë BE-së nën administrimin e saj dhe kuota ose aksione të AIF-ve furnizuese të BE-së që nuk përmbushin kërkesat e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 31, paragrafi 1, menjëherë sapo të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë nen.

2. AIFM-të duhet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë, me përjashtim të kreut VI. Gjithashtu, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) të jenë nënshkruar marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit mes autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, të paktën me qëllim garantimin e shkëmbimit efikas të informacionit, duke marrë në konsideratë paragrafin 4 të nenit 50 që u lejon autoriteteve kompetente të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë;

b) vendi i tretë i themelimit të AIF-së jashtë BE-së të mos renditet nga FATF si shtet dhe territor jobashkëpunues;

c) vendi i tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së të ketë nënshkruar marrëveshje me shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së së autorizuar dhe me çdo shtet anëtar tjetër ku synohen të tregtohen kuotat ose aksionet e AIF-së jashtë BE-së, në përputhje të plotë me standardet e përcaktuara në nenin 26 të Konventës Tatimore Model të OECD-së për të Ardhurat dhe Kapitalin, dhe të garantojë shkëmbimin efikas të informacionit për çështjet tatimore, duke përfshirë çdo marrëveshje shumëpalëshe tatimore.

Kur autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar nuk pajtohet me vlerësimin lidhur me zbatimin e germave "a" dhe "b" të nënparagrafit të parë nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. Nëse një AIFM synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-ve jashtë BE-së në shtetin e vet anëtar të origjinës, kjo AIFM i dorëzon një njoftim autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës në lidhje me çdo AIF jashtë BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën III.

4. Brenda 20 ditëve pune pas marrjes së njoftimit të plotë, në përputhje me paragrafin 3, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë AIFM-në nëse ajo mund të nisë tregtimin e AIF-së të identifikuar në njoftimin e përmendur në paragrafin 3 në territorin e vet. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së parandalojnë tregtimin e AIF-së vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë, ose nëse AIFM-ja nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë. Në rast vendimi pozitiv, AIFM-ja mund të nisë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar të origjinës që nga data e njoftimit nga autoritetet kompetente për këtë qëllim.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë gjithashtu edhe ESMA-n që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së.

5. Nëse një AIFM synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-ve jashtë BE-së në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, kjo AIFM i dorëzon një njoftim autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës në lidhje me çdo AIF jashtë BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën IV.

6. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, brenda 20 ditëve pune pas datës së marrjes së dosjes së plotë së njoftimit të përmendur në paragrafin 5, u përcjellin dosjen e plotë të njoftimit autoriteteve kompetente të shtetit anëtar ku synohet të tregtohet kjo AIF. Përcjellja e kësaj dosjeje do të kryhet vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së respekton dhe vazhdon të respektojë këtë direktivë dhe nëse në të kundërt AIFM-ja e respekton këtë direktivë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së bashkëngjisin një deklaratë me synim që AIFM-ja në fjalë të autorizohet për administrimin e AIF-ve përmes një strategjie të veçantë të investimeve.

7. Pas përcjelljes së dosjes së njoftimit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së njoftojnë pa vonesë AIFM-në lidhur me përcjelljen e dosjes. AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar përkatës pritës të AIFM-së që nga data e këtij njoftimi të përcjellë nga autoritetet kompetente.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë gjithashtu edhe ESMA-n që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar pritës të AIFM-së.

8. Masat e përmendura në germën "h" të shtojcës IV janë objekt i ligjeve dhe mbikëqyrjes së shteteve anëtare pritëse të AIFM-së.

9. Shtetet anëtare sigurohen që shkresa e njoftimit të AIFM-së e përmendur në paragrafin 5 dhe deklarata e përmendur në paragrafin 6 hartohen në një gjuhë që përdoret zakonisht në sferën e financave ndërkombëtare.

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet e tyre kompetente të pranojnë përcjelljen dhe dërgimin elektronik të dokumenteve të përmendura në paragrafin 6.

10. Në rastin e ndonjë ndryshimi material të ndonjë prej të dhënave të komunikuara në përputhje me paragrafin 3 ose 5, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën 1 muaj përpara zbatimit të ndryshimeve të planifikuara, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do të respektonte më këtë direktivë ose nëse AIFM-ja nuk do të respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet ndonjë ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do ta respektonte më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do ta respektonte më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46, suke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin shprehimisht të tregtimit të AIF-së.

Nëse këto ndryshime pranohen për shkak se nuk pengojnë stafin drejtues të AIFM-së së AIF-së që të respektojë këtë direktivë, ose në të kundërt AIFM-në që të respektojë këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së informojnë pa vonesë për këto ndryshime ESMA-n, për sa kohë që këto ndryshime lidhen me ndërprerjen e tregtimit të disa AIF-ve të caktuara ose me tregtimin e AIF-ve të tjera dhe, sipas rastit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës së AIFM-së.

11. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në germën a të paragrafit 2, me qëllim hartimin e kuadrit të përbashkët për lehtësimin e caktimit të ardhshëm të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta.

12. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, EMSA mund të hartojë udhëzime për të përcaktuar kushtet e zbatimit të masave të miratuara nga Komisioni në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në germën "a" të paragrafit 2.

13. ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të përcaktuar përmbajtjen minimale të marrëveshjeve të bashkëpunimit të përmendura në germën "a" të paragrafit 2, në mënyrë që t'u sigurojë informacione të mjaftueshme autoriteteve kompetente, si të shtetit anëtar të origjinës, ashtu dhe atij pritës, për të ushtruar kompetencat mbikëqyrëse dhe hetuese sipas kësaj direktive.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

14. Për të garantuar harmonizimin e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të specifikuar procedurat për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

15. Në rast se një autoritet kompetent refuzon një kërkesë për shkëmbim informacioni në përputhje me standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 14, autoritetet kompetente përkatëse mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

16. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar:

- a) formën dhe përmbajtjen e modelit të shkresës së njoftimit, të përmendur në paragrafin 3;
- b) formën dhe përmbajtjen e modelit të shkresës së njoftimit, të përmendur në paragrafin 5;
- c) formën dhe përmbajtjen e modelit të deklaratës, të përmendur në paragrafin 6;
- d) mënyrën e transmetimit të përmendur në paragrafin 6;
- e) formën e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 10.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

17. Pa cenuar nenin 43, paragrafi 1, shtetet anëtare kërkojnë që AIF-të e administruara dhe të tregtuara nga kjo AIFM, t'u tregtohen vetëm investitorëve profesional.

Neni 36

Kushtet për tregtimin pa pasaportë në shtetet anëtare të AIF-ve jashtë BE-së të administruara nga një AIFM e BE-së

1. Pa cenuar nenin 35, shtetet anëtare mund të lejojnë një AIFM e autorizuar e BE-së t'u tregtojë investitorëve profesional vetëm në territorin e tyre, kuota ose aksione të AIF-ve jashtë BE-së nën administrimin e saj dhe kuota ose aksione të AIF-ve furnizuese të BE-së që nuk përmbushin kërkesat e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 31, paragrafi 1, me kusht që:

a) AIFM-ja të respektojë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë, me përjashtim të nenit 21. Megjithatë, AIFM-ja duhet të garantojë caktimin e një ose më shumë subjekteve për përmbushjen e detyrave të përmendura në nenin 21, paragrafët 7, 8 dhe 9. AIFM-ja nuk duhet t'i kryejë këto funksione. AIFM-ja u siguron autoriteteve të saj mbikëqyrëse informacion në lidhje me identitetin e këtyre subjekteve përgjegjëse, për kryerjen e detyrave të përmendura në nenin 21, paragrafët 7, 8 dhe 9;

b) të jenë nënshkruar marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit për qëllimet e mbikëqyrjes së rrezikut sistematik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, mes autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, me qëllim garantimin e shkëmbimit efikas të informacionit që u

lejon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë;

c) vendi i tretë i themelimit të AIF-së jashtë BE-së të mos renditet nga FATF si shtet dhe territor jobashkëpunues.

2. Për qëllime të këtij neni, shtetet anëtare mund të vendosin rregulla më të rrepta për AIFM-në lidhur me tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-ve jashtë BE-së ndaj investitorëve në territorin e tyre.

3. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 1, me qëllim hartimin e kuadrit të përbashkët për lehtësimin e caktimit të ardhshëm të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta.

4. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, EMSA harton udhëzimet për të përcaktuar kushtet e zbatimit të masave të miratuara nga Komisioni në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 1.

Neni 37

Autorizimi i AIFM-ve jashtë BE-së që synojnë të administrojnë AIF të BE-së dhe/ose të tregtojnë AIF-të nën administrimin e tyre brenda Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 39 ose 40

1. Shtetet anëtare duhet të kërkojnë që AIFM-të jashtë BE-së që synojnë të administrojnë AIF-të e BE-së dhe/ose të tregtojnë AIF-të nën administrimin e tyre brenda Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 39 ose 40, të marrin paraprakisht autorizimin e autoriteteve kompetente të shtetit të tyre anëtar të referencës, në përputhje me këtë nen.

2. AIFM-ja jashtë BE-së që synon të marrë autorizimin paraprak të përmendur në paragrafin 1, duhet të jetë në përputhje me këtë direktivë, me përjashtim të kreut VI. Në rastin kur, dhe deri në masën që përputhshmëria me një dispozitë të kësaj direktive nuk pajtohet me përputhshmërinë e ligjit, të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së dhe/ose AIF-ja jashtë BE-së e tregtuar brenda Bashkimit Evropian, AIFM-ja nuk ka detyrim të pajtohet me dispozitat e kësaj direktive, në rast se arrin të provojë që:

a) e ka të pamundur të kombinojë njëkohësisht pajtimin edhe me dispozitën e detyrueshme të ligjit, të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së dhe/ose AIF-ja jashtë BE-së e tregtuar brenda Bashkimit Evropian;

b) ligji, të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së dhe/ose AIF-ja jashtë BE-së parashikon rregulla të njëjta, me të njëjtat qëllime rregullatore dhe ofron të njëjtin nivel mbrojtjeje për investitorët e AIF-së përkatëse; dhe

c) AIFM-ja jashtë BE-së dhe/ose AIF-ja jashtë BE-së respekton rregullat e barasvlershme të përmendura në germën "b".

3. AIFM-ja jashtë BE-së që synon të marrë autorizimin paraprak të përmendur në paragrafin 1, duhet të ketë një përfaqësues ligjor të regjistruar në shtetin e saj anëtar të referencës. Përfaqësuesi ligjor është pika e kontaktit të AIFM-së brenda Bashkimit Evropian dhe çdo korrespondencë zyrtare ndërmjet autoriteteve kompetente dhe AIFM-së dhe mes investitorëve të BE-së të AIF-së përkatëse dhe AIFM-së, siç përcaktohet në këtë direktivë, bëhet përmes këtij përfaqësuesi ligjor. Përfaqësuesi ligjor kryen funksionin e përputhshmërisë në lidhje me veprimtaritë e administrimit dhe tregtimit të kryera nga AIFM-ja sipas kësaj direktive, së bashku me AIFM.

4. Shteti anëtar i referencës së AIFM-së jashtë BE-së përcaktohet si më poshtë:

a) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të administrojë vetëm një AIF të BE-së, ose disa AIF të BE-së të themeluara në të njëjtin shtet anëtar, dhe nuk synon të tregtojë asnjë AIF brenda Bashkimit Evropian në përputhje me nenet 39 dhe 40, shteti anëtar i origjinës i kësaj/këtyre AIF-ve konsiderohet shteti anëtar i referencës dhe autoritetet kompetente të këtij shteti anëtar do të jenë kompetente për procedurën e autorizimit dhe për mbikëqyrjen e AIFM-së;

b) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të administrojë disa AIF të BE-së të themeluara në shtete të ndryshme anëtare dhe nuk synon të tregtojë asnjë AIF brenda Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 39 ose 40, shteti anëtar i referencës është:

I. shteti anëtar ku janë themeluar shumica e AIF-ve; ose

II. shteti anëtar ku administrohen shumica e aktiveve;

c) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të tregtojë vetëm një AIF të BE-së vetëm në një shtet anëtar, shteti anëtar i referencës përcaktohet si më poshtë:

I. nëse AIF-ja është e autorizuar ose regjistruar në një shtet anëtar, shteti anëtar i origjinës së AIF-së ose shteti anëtar ku AIFM-ja synon të tregtojë këtë AIF;

II. nëse AIF-ja nuk është e autorizuar ose e regjistruar në një shtet anëtar, shteti anëtar ku AIFM-ja synon të tregtojë këtë AIF;

d) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të tregtojë vetëm një AIF jashtë BE-së vetëm në një shtet anëtar, shteti anëtar i referencës është i njëjti shtet anëtar;

e) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të tregtojë vetëm një AIF të BE-së, por në shtete anëtare të ndryshme, shteti anëtar i referencës përcaktohet si më poshtë:

I. nëse AIF-ja është e autorizuar ose regjistruar në një shtet anëtar, shteti anëtar i origjinës së AIF-së është një nga shtetet anëtare ku AIFM-ja synon të zhvillojë marketing efikas; ose

II. nëse AIF-ja nuk është e autorizuar ose e regjistruar në një shtet anëtar, një nga shtetet anëtare ku AIFM-ja synon të zhvillojë marketing efikas;

f) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të tregtojë vetëm një AIF jashtë BE-së, por në shtete anëtare të ndryshme, shteti anëtar i referencës është një nga këto shtete anëtare;

g) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të tregtojë brenda Bashkimit Evropian disa AIF të BE-së, shteti anëtar i referencës përcaktohet si më poshtë:

I. për sa kohë që këto AIF janë të gjitha të regjistruara dhe të autorizuara në të njëjtin shtet anëtar, shteti anëtar i origjinës së këtyre AIF-ve ose shteti anëtar ku AIFM-ja synon të zhvillojë marketing efikas për shumicën e këtyre AIF-ve;

II. për sa kohë që këto AIF nuk janë të gjitha të regjistruara dhe të autorizuara në të njëjtin shtet anëtar, shteti anëtar ku AIFM-ja synon të zhvillojë marketing efikas për shumicën e këtyre AIF-ve;

h) nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të tregtojë disa AIF të BE-së dhe jashtë BE-së brenda Bashkimit Evropian, shteti anëtar i referencës është shteti anëtar ku ajo synon të zhvillojë marketing efikas për shumicën e këtyre AIF-ve;

Në përputhje me kriteret e përcaktuara në germat "b", "c", pika I, "e", "f" dhe "g", pika I të nënparagrafit të parë, mund të përcaktohen më shumë se një shtete anëtare të referencës. Në këto raste, shtetet anëtare duhet të kërkojnë që AIFM-ja jashtë BE-së që synon të administrojnë AIF të BE-së pa marketing dhe/ose të tregtojnë AIF nën administrimin e saj brenda Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 39 ose 40, t'i paraqesë një kërkesë autoriteteve kompetente të të gjitha shteteve anëtare që janë shtete anëtare candidate të referencës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këto pika, me qëllim që të përcaktojnë shtetin anëtar të referencës mes tyre. Këto autoritete kompetente vendosin bashkërisht shtetin anëtar të referencës për AIFM-në jashtë BE-së brenda 1 muaji nga marrja e kësaj kërkesë. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të caktuar si shteti anëtar i referencës informojnë pa vonesë AIFM-në jashtë BE-së për këtë caktim. Nëse AIFM-ja jashtë BE-së nuk informohet siç duhet lidhur me vendimin e marrë nga autoritetet kompetente përkatëse brenda 7 ditëve nga marrja e vendimit ose nëse autoritetet kompetente përkatëse nuk kanë marrë asnjë vendim brenda 1 muaji, AIFM-ja jashtë BE-së mund të zgjedhë vetë shtetin e saj anëtar të referencës në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë paragraf.

AIFM-ja duhet të jetë në gjendje të provojë synimin e saj për të zhvilluar marketing efikas në një shtet anëtar të veçantë duke bërë publike strategjinë e saj të marketingut për autoritetet kompetente të shtetit anëtar të caktuar prej saj.

5. Shtetet anëtare duhet të kërkojnë që AIFM-ja jashtë BE-së që synon të administrojë AIF të BE-së pa marketing dhe/ose të tregtojë AIF nën administrimin e saj brenda Bashkimit Evropian, në përputhje me nenin 39 dhe 40, t'i paraqesë shtetit të saj anëtar të referencës një kërkesë për autorizim.

Pas marrjes së kërkesës për autorizim, autoritetet kompetente vlerësojnë nëse përcaktimi i shtetit anëtar të referencës nga AIFM-ja është në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 4. Nëse autoritetet kompetente nuk e gjejnë të tillë, ato e refuzojnë kërkesën për autorizim të AIFM-së jashtë BE-së, duke shpjeguar arsyet për këtë refuzim. Nëse autoritetet kompetente gjejnë se janë përmbushur kriteret e paragrafit 4, ato njoftojnë ESMA-n, duke kërkuar këshilla lidhur me vlerësimin e tyre. Nëse njoftojnë ESMA-n, autoritetet kompetente i dërgojnë ESMA-s argumentet e AIFM-së për vlerësimin lidhur me shtetin anëtar të referencës dhe informacione lidhur strategjinë e marketingut të AIFM-së.

Brenda 1 muaji nga marrja e njoftimit të përmendur në nënparagrafin e dytë, ESMA u jep autoriteteve kompetente përkatëse këshilla në lidhje me vlerësimin e tyre për shtetin anëtar të referencës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 4. ESMA jep këshillë negative vetëm nëse gjykon se nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në paragrafin 4.

Kushti i përmendur në nenin 8, paragrafi 5 pezullohet gjatë periudhës kur ESMA kryen gjykimin në përputhje me këtë paragraf.

Nëse autoritetet kompetente propozojnë ta japin këtë autorizim kundër këshillës së ESMA-s të përmendur në nënparagrafin e tretë, ato duhet të njoftojnë ESMA-s, duke cituar arsyet e tyre. ESMA publikon faktin se autoritetet kompetente nuk pajtohen ose nuk synojnë të pajtohen me këshillën e saj. Gjithashtu, ESMA mund të vendosë të publikojë rast pas rasti arsyet e dhëna nga autoritetet kompetente për mospajtimin me këtë këshillë. Autoritetet kompetente njoftohen paraprakisht lidhur me këtë publikim.

Nëse autoritetet kompetente propozojnë ta japin këtë autorizim kundër këshillës së ESMA-s, të përmendur në nënparagrafin e tretë dhe AIFM-ja synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-ve nën administrimin e saj në shtete anëtare të tjera ndryshe nga shteti anëtar i referencës, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës duhet të informojnë gjithashtu edhe autoritetet kompetente të këtyre shteteve anëtare për këtë fakt, duke cituar arsyet e tyre. Për aq sa është e zbatueshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë gjithashtu edhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të origjinës për AIF-të nën administrimin e kësaj AIFM-je, duke cituar arsyet e tyre.

6. Kur autoriteti kompetent i një shteti anëtar nuk pajtohet për shtetin anëtar të referencës që AIFM-ja ka përcaktuar, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Pa cenuar paragrafin 8, nuk do të jepet asnjë autorizim nëse nuk plotësohen kushtet a tjera të mëposhtme:

a) shteti anëtar i referencës të jetë caktuar nga AIFM-ja në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 dhe ky caktim të shoqërohet me dorëzimin e strategjisë së marketingut, si dhe autoritetet kompetente përkatëse të kenë ndjekur procedurën e përcaktuar në paragrafin 5;

b) AIFM-ja të ketë caktuar një përfaqësues ligjor të regjistruar në shtetin anëtar të referencës;

c) ky përfaqësues ligjor, së bashku me AIFM-në, të jetë personi i kontaktit të AIFM-së jashtë BE-së për investitorët e AIF-ve përkatëse, për ESMA-n dhe për autoritetet kompetente, në lidhje me veprimtaritë për të cilat AIFM-ja gëzon autorizim brenda Bashkimit Evropian dhe duhet të ketë të paktën kompetenca të mjaftueshme për ushtrimin e funksionit të përputhshmërisë sipas kësaj direktive;

d) të jenë nënshkruar marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit mes autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së

AIF-së të BE-së në fjalë dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, të paktën me qëllim garantimin e shkëmbimit efikas të informacionit që u lejon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë;

e) vendi i tretë i themelimit të AIFM-së jashtë BE-së të mos renditet nga FATF si shtet dhe territor jobashkëpunues;

f) vendi i tretë ku është themeluar AIFM-ja jashtë BE-së të ketë nënshkruar marrëveshje me shtetin anëtar të referencës, në përputhje të plotë me standardet e përcaktuara në nenin 26 të Konventës Tatimore Model të OECD-së për të Ardhurat dhe Kapitalin, dhe të garantojë shkëmbimin efikas të informacionit për çështjet tatimore, duke përfshirë çdo marrëveshje shumëpalëshe tatimore;

g) funksionet mbikëqyrëse të ushtruara nga autoritetet kompetente sipas kësaj direktive të mos pengohen nga ligjet, rregulloret apo dispozitat administrative të një vendi të tretë qeverisës të AIFM-së, dhe as të kufizojnë kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore të autoriteteve mbikëqyrëse të atij vendi të tretë.

Kur autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar nuk pajtohet me vlerësimin lidhur me zbatimin e germave "a" deri në "c" dhe "g" të këtij paragrafi nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Kur autoritetet kompetente të AIF-së së BE-së nuk nënshkruajnë marrëveshjet e nevojshme të bashkëpunimit, siç përcaktohet në germën "d" të nënparagrafit të parë brenda një periudhe të arsyeshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

8. Autorizimi jepet në përputhje me kapitullin II, i cili zbatohet rast pas rasti sipas kriterëve të mëposhtme:

a) informacionin e përmendur në nenin 7, paragrafi 2 duhet të plotësohet me;

I. argumentet e AIFM-së për vlerësimin e saj në lidhje me shtetin anëtar të referencës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 për informacionet lidhur me strategjinë e marketingut;

II. një listë të dispozitave të kësaj direktive me të cilat AIFM-ja e ka të pamundur të pajtohet për shkak se pajtimi me këto dispozita nga ana e AIFM-së, sipas paragrafit 2, nuk përputhet me pajtimin e dispozitave të detyrueshme të ligjit që u nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së të tregtuara brenda Bashkimit Evropian.

III. prova me shkrim sipas standardeve teknike rregullatore të hartuara nga ESMA, të cilat vërtetojnë se ligji përkatës i vendit të tretë parashikon rregulla të barasvlershme me dispozitat me të cilat nuk mund të pajtohet, i cili ka të njëjtin qëllim rregullator dhe ofron të

njëtin nivel mbrojtjeje ndaj investitorëve të AIF-së përkatëse dhe që AIFM-ja pajtohet me këtë rregull të barasvlershëm; këto prova me shkrim duhet të shoqërohen me një opinion ligjor për ekzistencën e dispozitës përkatëse të detyrueshme që nuk përputhet në ligjin e vendit të tretë, dhe duke përfshirë një përshkrim të qëllimit rregullator dhe natyrës së mbrojtjes së investitorëve të synuar; dhe

IV. emrin e përfaqësuesit ligjor të AIFM-së dhe vendin e themelimit të saj;

b) informacioni i referuar në nenin 7, paragrafi 3 mund të kufizohet vetëm për AIF-të e BE-së që AIFM-ja synon të administrojë dhe për ato AIF nën administrimin e AIFM-së që synon të tregtojë me pasaportë brenda Bashkimit Evropian;

c) germa "a" e nenit 8, paragrafi 1 nuk cenon paragrafin 2 të këtij neni;

d) nuk zbatohet germa "e", e nenit 8, paragrafi 1;

e) nënparagrafi i dytë i nenit 8, paragrafi 5 lexohet duke përfshirë një referencë për "informacionin e përmendur në germën "a" të nenit 37, paragrafi 8".

Kur autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar nuk pajtohet me autorizimin e dhënë nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

9. Në rast se autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës gjykojnë se AIFM-ja mund marrë për bazë paragrafin 2 lidhur me përjashtimin nga përputhshmëria me disa dispozita të caktuara të kësaj direktive, ato njoftojnë pa vonesë ESMA-n për këtë fakt. Ky vlerësim mbështetet nga informacioni i dhënë nga AIFM-ja, në përputhje me germën "a", pikat II dhe III të paragrafit 8.

Brenda 1 muaji nga marrja e njoftimit të përmendur në nënparagrafin e parë, ESMA këshillon autoritetet kompetente në lidhje me zbatimin e përjashtimit nga përputhshmëria me këtë direktivë si pasojë e mospërputhshmërisë në bazë të paragrafit 2. Këto këshilla mund të trajtojnë veçanërisht faktin nëse janë plotësuar kushtet për këtë përjashtim, lidhur me informacionin e dhënë nga AIFM-ja, në përputhje me germën "a", pikat II dhe III të paragrafit 8 dhe me standardet teknike rregullatore për ekuivalencën. ESMA duhet të përpiqet të ndërtojë një kulturë evropiane të përbashkët mbikëqyrëse dhe praktika mbikëqyrëse të qëndrueshme dhe të garantojë qasje të qëndrueshme mes autoriteteve kompetente në lidhje me zbatimin e këtij paragrafi.

Kushti i përmendur në nenin 8, paragrafi 5 pezullohet gjatë periudhës së shqyrtimit të ESMA-s, në përputhje me këtë paragraf.

Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës propozojnë ta japin këtë autorizim kundër këshillës së ESMA-s të përmendur në nënparagrafin e dytë, ato duhet të njoftojnë ESMA-s, duke cituar arsyet e tyre. ESMA publikon faktin se autoritetet kompetente nuk pajtohen ose nuk synojnë të pajtohen me këtë këshillë. Gjithashtu, ESMA mund të vendosë

të publikojë rast pas rasti arsyet e dhëna nga autoritetet kompetente për mospajtimin me këtë këshillë. Autoritetet kompetente në fjalë njoftohen paraprakisht lidhur me këtë publikim.

Nëse autoritetet kompetente propozojnë ta japin këtë autorizim kundër këshillës së ESMA-s, të përmendur në nënparagrafin e dytë dhe AIFM-ja synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-ve nën administrimin e saj në shtete anëtare të tjera ndryshe nga shteti anëtar i referencës, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës duhet të informojnë gjithashtu edhe autoritetet kompetente të këtyre shteteve anëtare për këtë fakt, duke cituar arsyet e tyre.

Kur autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar nuk pajtohet me vlerësimin lidhur me zbatimin e këtij paragrafi nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

10. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë pa vonesë ESMA-n për rezultatin e procesit në momentin e autorizimit, për çdo ndryshim lidhur me autorizimin e AIFM-së dhe çdo tërheqje të autorizimit.

Autoritetet kompetente informojnë ESMA-n në lidhje me aplikimet e refuzuara për autorizim, duke ofruar të dhëna për AIFM-në që ka kërkuar këtë autorizim dhe arsyet e refuzimit. ESMA mban regjistrin qendror të këtyre të dhënave, të cilat vendosen në dispozicion të autoriteteve kompetente me kërkesë të tyre. Autoriteti kompetent duhet ta trajtojë këtë informacion si konfidencial.

11. Zhvillimi i mëtejshëm i biznesit të AIFM-së brenda Bashkimit Evropian nuk ndikon në përcaktimin e shtetit anëtar të referencës. Megjithatë, kur AIFM-ja ndryshon strategjinë e saj të marketingut brenda 2 viteve nga momenti i autorizimit dhe nëse ky ndryshim ka prekur përcaktimin e shtetit anëtar të referencës lidhur me faktin nëse strategjia e ndryshuar e marketingut është e njëjtë me strategjinë e parë të marketingut, AIFM-ja njofton autoritetet kompetente të shtetit të parë anëtar të referencës për këtë ndryshim përpara zbatimit të tij, dhe cilëson shtetin e saj anëtar të referencës në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 4, si dhe në bazë të strategjisë së re. AIFM-ja jep argumente për vlerësimin e saj, duke i dërguar strategjinë e saj të re të marketingut shtetit të saj të parë të referencës. Në të njëjtën kohë, AIFM-ja duhet të ofrojë informacion për përfaqësuesit të saj ligjor, duke përfshirë emrin dhe vendin e tij të themelimit. Përfaqësuesi ligjor duhet të regjistrohet në shtetin e ri anëtar të referencës.

Shteti i parë anëtar i referencës vlerëson saktësinë e përcaktimit nga AIFM-ja, në përputhje me nënparagrafin e parë dhe njofton ESMA-n për këtë fakt. ESMA jep këshilla lidhur me vlerësimin e autoriteteve kompetente. Nëse njoftojnë ESMA-n, autoritetet kompetente i dërgojnë asaj argumentet e AIFM-së për vlerësimin lidhur me shtetin anëtar të referencës dhe informacione lidhur strategjinë e re të marketingut të AIFM-së.

Brenda 1 muaji nga marrja e njoftimit të përmendur në nënparagrafin e dytë, ESMA u jep këshilla autoriteteve kompetente përkatëse lidhur me vlerësimin e tyre. ESMA jep këshillë negative vetëm kur gjykon se nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në paragrafin 4.

Pa marrjes së këshillës së ESMA-s në përputhje me nënparagrafin e tretë, autoritetet kompetente të shtetit të parë anëtar të referencës informojnë AIFM-në jashtë BE-së, përfaqësuesin e saj të parë ligjor dhe EMSA-n lidhur me vendimin e tyre.

Kur autoritetet kompetente të shtetit të parë anëtar të origjinës pajtohen me vlerësimin e AIFM-së, ato gjithashtu autoritetet kompetente të shtetit të ri anëtar të referencës për këtë ndryshim. Shteti i parë anëtar i referencës i përcjell pa vonesë AIFM-së së shtetit të ri anëtar të referencës një kopje të autorizimit dhe dosjes së mbikëqyrjes. Nga data e përcjelljes së autorizimit dhe dosjes së mbikëqyrjes, autoritetet kompetente të shtetit të ri anëtar të referencës do të jenë kompetente për autorizimin dhe mbikëqyrjen e AIFM-së.

Kur vlerësimi përfundimtar i autoriteteve kompetente bie në kundërshtim me këshillën e ESMA-s të përmendur në nënparagrafin e tretë:

a) autoritetet kompetente informojnë ESMA-s për këtë fakt, duke cituar arsyet. ESMA publikon faktin se autoritetet kompetente nuk pajtohen ose nuk synojnë të pajtohen me këshillën e saj. Gjithashtu, ESMA mund të vendosë të publikojë rast pas rasti arsyet e dhëna nga autoritetet kompetente për këtë mospajtim. Autoritetet kompetente në fjalë njoftohen paraprakisht lidhur me këtë publikim;

b) kur AIFM-ja tregton kuota ose aksione të AIF-ve nën administrimin e saj në shtete anëtare të tjera ndryshe nga shteti i parë anëtar i referencës, autoritetet kompetente të shtetit të parë anëtar të referencës duhet të informojnë autoritetet kompetente të këtyre shteteve të tjera anëtare për këtë fakt, duke cituar arsyet e tyre. Kur është e zbatueshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë gjithashtu edhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të origjinës për AIF-të nën administrimin e kësaj AIFM-je, duke cituar arsyet përkatëse.

12. Nëse gjatë rrjedhës aktuale të zhvillimit të biznesit të AIFM-së brenda Bashkimit Evropian brenda dy viteve pas marrjes së autorizimit, konstatohet se nuk është ndjekur strategjia e marketingut e prezantuar nga AIFM-ja në momentin e autorizimit, ose nëse AIFM-ja ka bërë deklarata të rreme lidhur me këtë strategji, ose nëse AIFM-ja nuk ka respektuar paragrafin 11 në momentin e ndryshimit të strategjisë së marketingut, autoritetet kompetente të shtetit të parë anëtar të referencës bëjnë kërkesë që AIFM-ja të caktojë shtetin anëtar të referencës duke u bazuar në strategjinë aktuale të marketingut. Procedura e përcaktuar në paragrafin 11 zbatohet rast pas rasti. Nëse AIFM-ja nuk respekton kërkesën e autoriteteve kompetente, këto të fundit e tërheqin autorizimin.

Kur AIFM-ja ndryshon strategjinë e saj të marketingut pas periudhës së përmendur në paragrafin 11 dhe synon të ndryshojë shtetin e saj anëtar të referencës në bazë të strategjisë së saj të re të marketingut, ajo mund t'i dorëzojë një kërkesë autoriteteve kompetente të shtetit të parë anëtar të referencës për ndryshimin e shtetit anëtar të referencës. Procedura e përmendur në paragrafin 11 zbatohet rast pas rasti.

Kur autoriteti kompetent i një shteti anëtar nuk pajtohet me vlerësimin e kryer nga shteti anëtar i referencës sipas paragrafit 11 ose sipas këtij paragrafi, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

13. Çdo mosmarrëveshje që lind mes autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së dhe vetë AIFM-së zgjidhet në përputhje me ligjin dhe është objekt i juridiksionit të shtetit anëtar të referencës.

Çdo mosmarrëveshje mes AIFM-së ose AIF-së dhe investitorëve të Bashkimit Evropian lidhur me AIF-në përkatëse zgjidhet në përputhje me ligjin dhe është objekt i juridiksionit të një shteti anëtar.

14. Komisioni miraton aktet zbatuese me qëllim përcaktimin e procedurës që duhet të ndiqet nga shtetet candidate anëtare të referencës gjatë përcaktimit të shtetit anëtar të referencës në radhët e këtyre shteteve anëtare, në përputhje me nënparagrafin e dytë të paragrafit 4. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

15. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në germën d të paragrafit 7, me qëllim hartimin e kuadrit të përbashkët për lehtësimin e caktimit të ardhshëm të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta.

16. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, EMSA mund të hartojë udhëzime për të përcaktuar kushtet e zbatimit të masave të miratuara nga Komisioni në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në germën "d" të paragrafit 7.

17. ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të përcaktuar përmbajtjen minimale të marrëveshjeve të bashkëpunimit të përmendura në germën "d" të paragrafit 7, në mënyrë që t'u sigurojë informacione të mjaftueshme autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës dhe autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës, për të ushtruar kompetencat e tyre mbikëqyrëse dhe hetuese sipas kësaj direktive.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

18. Për të garantuar harmonizimin e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të specifikuar procedurat për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të referencës dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

19. Në rast se një autoritet kompetent refuzon një kërkesë për shkëmbim informacioni në përputhje me standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 17, autoritetet kompetente përkatëse mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

20. Në përputhje me nenin 29 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, ESMA promovon shkëmbimin efektiv të informacionit në nivel dypalësh dhe shumë-palësh ndërmjet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së jashtë BE-së dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së në fjalë, duke respektuar plotësisht konfidencialitetin dhe dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, të parashikuara në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

21. Në përputhje me nenin 31 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, ESMA luan një rol të përgjithshëm koordinues ndërmjet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së jashtë BE-së dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së në fjalë. Në veçanti, ESMA:

- a) mund të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mes autoriteteve kompetente në fjalë;
- b) mund të përcaktojë objektin e informacionit që autoriteti kompetent i shtetit anëtar të referencës duhet t'u ofrojë autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse në fjalë;
- c) mund të marrë të gjitha masat e duhura në rastin e ngjarjeve që mund të rrezikojnë funksionimin e tregjeve financiare, me qëllim lehtësimin e koordinimit të masave të ndërmarra nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të referencës dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse në lidhjes me AIFM-të jashtë BE-së.

22. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar formën dhe përmbajtjen e kërkesës së përmendur në nënparagrafin e parë të paragrafit 12.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

23. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike zbatuese lidhur me sa më poshtë:

- a) mënyrën se si AIFM-ja duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë, duke marrë parasysh që AIFM-ja është e themeluar në një vend të tretë dhe, veçanërisht, paraqitjen e informacionit të nevojshëm sipas neneve 22 deri në 24;
- b) kushtet sipas të cilave gjykohet se ligji, të cilit i nënshtrohet AIFM-ja jashtë BE-së ose AIF-ja jashtë BE-së, parashikon rregulla të njëjta, me të njëjtat qëllime rregullatore dhe ofron të njëjtin nivel mbrojtjeje për investitorët përkatës.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 38

Rishikimi i shqyrtimeve në nivel të njëjtë dhe mbikëqyrjes së AIFM-ve jashtë BE-së

1. ESMA zhvillon çdo vit analizën e shqyrtimit në nivel të njëjtë të veprimtarive mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente, në lidhje me autorizimin dhe mbikëqyrjen e AIFM-ve jashtë BE-së sipas neneve 37, 39, 40 dhe 41, për të përmirësuar më shumë konsistencën e rezultateve të mbikëqyrjes, në përputhje me nenin 30 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

2. Deri më datë 22 korrik 2013, ESMA harton metoda për të bërë të mundur vlerësimin dhe krahasimin objektiv mes autoriteteve të shqyrtuara.

3. Ky shqyrtim në nivel të njëjtë përfshin një vlerësim për:

a) shkallën e konvergjencës në praktikat mbikëqyrëse të arritur gjatë autorizimit dhe mbikëqyrjes së AIFM-ve jashtë BE-së;

b) shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara në këtë direktivë përmes kësaj praktike mbikëqyrëse;

c) efikasitetin dhe shkallën e konvergjencës të arritur lidhur me zbatimin e kësaj direktive dhe masat e saj zbatuese dhe standardet zbatuese rregullatore dhe teknike të hartuara nga ESMA sipas kësaj direktive, duke përfshirë masat administrative dhe gjambat e vendosura ndaj AIFM-ve jashtë BE-së kur nuk është respektuar kjo direktivë.

4. Në bazë të përfundimeve të shqyrtimit në të njëjtin nivel, ESMA mund të nxjerrë udhëzime dhe rekomandime në përputhje me nenin 16 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, me qëllim hartimin e praktikave të qëndrueshme, efikase dhe efektive mbikëqyrëse të AIFM-ve jashtë BE-së.

5. Autoritetet kompetente bëjnë çdo përpjekje për t'u pajtuar me këto udhëzime dhe rekomandime.

6. Brenda 2 muajve nga nxjerrja e udhëzimit apo rekomandimit, çdo autoritet kompetent duhet të konfirmojë nëse është në pajtësi ose në synon të pajtohet me këtë udhëzim ose rekomandim. Në rast se autoriteti kompetent nuk pajtohet dhe as nuk synon të pajtohet, ai duhet të informojë ESMA-n, duke cituar arsyet e veta.

7. ESMA publikon faktin se një autoritet kompetent nuk pajtohet ose nuk synon të pajtohet me këtë udhëzim ose rekomandim. Gjithashtu, ESMA mund të vendosë të publikojë rast pas rasti arsyet e dhëna nga autoriteti kompetent për mospajtimin me këtë udhëzim ose rekomandim. Autoriteti kompetent në fjalë njoftohen paraprakisht lidhur me këtë publikim.

8. Në raportin e përmendur në nenin 43, paragrafi 5 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, ESMA informon Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komisionin për udhëzimet dhe rekomandimet e nxjerra sipas këtij neni, duke cituar se cilat autoritete kompetente nuk janë pajtuar me to, dhe duke përshkruar se si ESMA synon të garantojë që këto autoritete kompetente të respektojnë rekomandimet dhe udhëzimet e saj në të ardhmen.

9. Gjatë shqyrtimit të kësaj direktive dhe në përputhje me nenin 69, si dhe në çdo vlerësim pasues që kryen, Komisioni i merr siç duhet në konsideratë këto raporte.

10. ESMA harton praktikat më të mira që mund të identifikohen nga shqyrtimet në nivel të njëjtë publikisht të disponueshme. Gjithashtu, të gjitha rezultatet e tjera të shqyrtimeve në të njëjtin nivel mund të bëhen publike, me pranimin e autoritetit kompetent që është objekt i shqyrtimit në të njëjtin nivel.

Neni 39

Kushtet për tregtimin me pasaportë brenda Bashkimit Evropian të AIF-ve të BE-së të administruar nga një AIFM jashtë BE-së

1. Shtetet anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar jashtë BE-së të mund t'u tregtojë investitorëve profesional brenda Bashkimit Evropian kuota ose aksione me pasaportë të një AIF-je të BE-së nën administrimin e saj, menjëherë sapo të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë nen.

2. Në rast se AIFM-ja synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-së së BE-së në shtetin e saj anëtar të referencës, kjo AIFM i dorëzon një njoftim autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të referencës në lidhje me çdo AIF të BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën III.

3. Brenda 20 ditëve pune pas marrjes së njoftimit të plotë në përputhje me paragrafin 2, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë AIFM-në nëse ajo mund të nisë tregtimin e AIF-së së identifikuar në njoftimin e përmendur në paragrafin 2. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së mund të parandalojnë tregtimin e AIF-së vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë. Në rast vendimi pozitiv, AIFM-ja mund të nisë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar të referencës që nga data e njoftimit nga autoritetet kompetente për këtë qëllim.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë gjithashtu ESMA-n dhe autoritetet kompetente të AIF-së që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar të referencës së AIFM-së.

4. Në rast se AIFM-ja synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-së së BE-së në shtete anëtare të ndryshme nga shteti i saj anëtar i referencës, kjo AIFM i dorëzon një njoftim autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të referencës në lidhje me çdo AIF të BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën IV.

5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës, brenda 20 ditëve pune pas datës së marrjes së dosjes së plotë së njoftimit të përmendur në paragrafin 4, u përcjellin dosjen e plotë të njoftimit autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku synohet të tregtohen kuotat ose aksionet e kësaj AIF-je. Përcjellja e këtij dokumentacioni kryhet vetëm nëse stafi drejtues i

AIFM-së së AIF-së respekton dhe vazhdon të respektojë këtë direktivë dhe nëse në të kundërt AIFM-ja e respekton këtë direktivë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së bashkëngjisin një deklaratë me synim që AIFM-ja në fjalë të autorizohet për administrimin e AIF-ve përmes një strategjie të veçantë të investimeve.

6. Pas përcjelljes së dosjes së njoftimit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së njoftojnë pa vonesë AIFM-në lidhur me përcjelljen e dosjes. AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar përkatës pritës që nga data e këtij njoftimi.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë gjithashtu ESMA-n dhe autoritetet kompetente të AIF-së që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar pritës të AIFM-së.

7. Marrëveshjet e përmendura në germën "h" të shtojcës IV janë objekt i ligjeve dhe mbikëqyrjes së shtetit anëtar pritës të AIFM-së.

8. Shtetet anëtare sigurohen që shkresa e njoftimit të AIFM-së e përmendur në paragrafin 4 dhe deklarata e përmendur në paragrafin 5, të hartohen në një gjuhë që përdoret zakonisht në sferën e financave ndërkombëtare.

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet e tyre kompetente të pranojnë përcjelljen dhe dërgimin elektronik të dokumenteve të përmendura në paragrafin 6.

9. Në rastin e ndonjë ndryshimi material të ndonjë prej të dhënave të komunikuara në përputhje me paragrafin 2 dhe/ose 4, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetin kompetent të shtetit të saj anëtar të referencës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën 1 muaj përpara zbatimit të ndryshimeve të planifikuara, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do të respektonte më këtë direktivë ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do të respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet një ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk e respekton më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk e respekton më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46, suke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin shprehimisht të tregtimit të AIF-së.

Nëse këto ndryshime pranohen për shkak se nuk pengojnë stafin drejtues të AIFM-së së AIF-së që të respektojë këtë direktivë, ose në të kundërt AIFM-në që të respektojë këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë pa vonesë për këto ndryshime ESMA-n, për sa kohë që këto ndryshime lidhen me ndërprerjen e tregtimit të disa AIF-ve të caktuara ose me tregtimin e AIF-ve të tjera dhe, për aq sa është e zbatueshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës.

10. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar:

- a) formën dhe përmbajtjen e modelit të shkresës së njoftimit, të përmendur në paragrafët 2 dhe 4;
- b) formën dhe përmbajtjen e modelit të deklaratës, të përmendur në paragrafin 5;
- c) mënyrën e transmetimit të përmendur në paragrafin 5; dhe
- d) formën e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 9.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

11. Pa cenuar nenin 43, paragrafi 1, shtetet anëtare kërkojnë që AIF-të e administruara dhe të tregtuara nga kjo AIFM, t'u tregtohen vetëm investitorëve profesional.

Neni 40

Kushtet për tregtimin me pasaportë brenda Bashkimit Evropian të AIF-ve jashtë BE-së të administruar nga një AIFM jashtë BE-së

1. Shtetet anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar jashtë BE-së të mund t'u tregtojë investitorëve profesional brenda Bashkimit Evropian kuota ose aksione me pasaportë të një AIF-je jashtë BE-së nën administrimin e saj, menjëherë sapo të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë nen.

2. Përveç kërkesave të kësaj direktive në lidhje me AIFM-të e BE-së, për AIFM-të jashtë BE-së duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

b) të jenë nënshkruar marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit mes autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës dhe autoritetit mbikëqyrës të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, të paktën me qëllim garantimin e shkëmbimit efikas të informacionit që u lejon autoriteteve kompetente të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë;

b) vendi i tretë i themelimit të AIF-së jashtë BE-së të mos renditet nga FATF si shtet dhe territor jobashkëpunues;

c) vendi i tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së të ketë nënshkruar marrëveshje me shtetin anëtar të referencës dhe me çdo shtet anëtar tjetër ku synohen të tregtohen kuotat ose aksionet e AIF-së jashtë BE-së, në përputhje të plotë me standardet e përcaktuara në nenin 26 të Konventës Tatimore Model të OECD-së për të Ardhurat dhe Kapitalin, dhe të garantojë

shkëmbimin efikas të informacionit për çështjet tatimore, duke përfshirë çdo marrëveshje shumëpalëshe tatimore.

Kur autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar nuk pajtohet me vlerësimin lidhur me zbatimin e germave "a" dhe "b" të nënparagrafit të parë nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së, autoritetet kompetente në fjalë mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

3. AIFM-ja u dërgon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës një njoftim në lidhje me çdo AIF jashtë BE-së që synon të tregtojë në shtetin e saj anëtar të referencës.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën III.

4. Brenda 20 ditëve pune pas marrjes së njoftimit të plotë në përputhje me paragrafin 3, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë AIFM-në nëse ajo mund të nisë tregtimin e AIF-së së identifikuar në njoftimin e përmendur në paragrafin 3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së mund të parandalojnë tregtimin e AIF-së vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së së AIF-së nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk respekton dhe nuk do të respektojë këtë direktivë. Në rast vendimi pozitiv, AIFM-ja mund të nisë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar të referencës nga data e njoftimit nga autoritetet kompetente për këtë qëllim.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë gjithashtu edhe ESMA-n që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar të referencës së AIFM-së.

5. Në rast se AIFM-ja synon të tregtojë kuota ose aksione të një AIF-je jashtë BE-së edhe në shtete anëtare të tjera përveç shtetit të saj anëtar të referencës, kjo AIFM i dorëzon një njoftim autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të referencës në lidhje me çdo AIF jashtë BE-së që synon të tregtojë.

Ky njoftim përfshin edhe dokumentacionin dhe informacionin e përcaktuar në shtojcën IV.

6. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës, brenda 20 ditëve pune pas datës së marrjes së dosjes së plotë së njoftimit të përmendur në paragrafin 5, u përcjellin dosjen e plotë të njoftimit autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku synohet të tregtohen kuotat ose aksionet e kësaj AIF-je. Përcjellja e kësaj dosjeje kryhet vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së respekton dhe vazhdon të respektojë këtë direktivë dhe nëse AIFM-ja e respekton në përgjithësi këtë direktivë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së bashkëngjisin një deklaratë me synim që AIFM-ja në fjalë të autorizohet për administrimin e AIF-ve përmes një strategjie të veçantë të investimeve.

7. Pas përcjelljes së dosjes së njoftimit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së njoftojnë pa vonesë AIFM-në lidhur me përcjelljen e dosjes. AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e AIF-së në shtetin anëtar përkatës pritës të AIFM-së që nga data e këtij njoftimi.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë gjithashtu edhe ESMA-n që AIFM-ja mund të fillojë tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-së në shtetin anëtar pritës të AIFM-së.

8. Marrëveshjet e përmendura në germën "h" të shtojcës IV janë objekt i ligjeve dhe mbikëqyrjes së shtetit anëtar pritës të AIFM-së, për sa kohë që këta shtete anëtare janë të ndryshëm nga shteti anëtar i referencës.

9. Shtetet anëtare sigurohen që shkresa e njoftimit të AIFM-së e përmendur në paragrafin 5 dhe deklarata e përmendur në paragrafin 6, të hartohen në një gjuhë që përdoret zakonisht në sferën e financave ndërkombëtare.

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet e tyre kompetente të pranojnë përcjelljen dhe dërgimin elektronik të dokumenteve të përmendura në paragrafin 6.

10. Në rastin e ndonjë ndryshimi material të ndonjë prej të dhënave të komunikuara në përputhje me paragrafin 3 ose 5, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetin kompetent të shtetit anëtar të referencës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën 1 muaj përpara zbatimit të ndryshimeve të planifikuara, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do të respektonte më këtë direktivë ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do të respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet ky ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk e respekton më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk e respekton më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46, suke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin shprehimisht të tregtimit të AIF-së.

Nëse këto ndryshime pranohen për shkak se nuk pengojnë stafin drejtues të AIFM-së së AIF-së që të respektojë këtë direktivë, ose në të kundërt AIFM-në që të respektojë këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë pa vonesë për këto ndryshime ESMA-n, për sa kohë që këto ndryshime lidhen me ndërprerjen e tregtimit të disa AIF-ve të caktuara ose me tregtimin e AIF-ve të tjera dhe, për aq sa është e zbatueshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së.

11. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në germën a të paragrafit 2, me qëllim hartimin e kuadrit të

përbashkët për lehtësimin e caktimit të ardhshëm të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta.

12. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, EMSA mund të hartojë udhëzime për të përcaktuar kushtet e zbatimit të masave të miratuara nga Komisioni në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në germën "a" të paragrafit 2.

13. ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të përcaktuar përmbajtjen minimale të marrëveshjeve të bashkëpunimit të përmendura në germën "a" të paragrafit 2, në mënyrë që t'u sigurojë informacione të mjaftueshme autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të referencës dhe autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës, për të ushtruar kompetencat e tyre mbikëqyrëse dhe hetuese sipas kësaj direktive.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

14. Për të garantuar harmonizimin e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA harton draft standarde teknike rregullatore për të specifikuar procedurat për koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoritetit kompetent të shtetit anëtar të referencës dhe autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

15. Në rast se një autoritet kompetent refuzon një kërkesë për shkëmbim informacioni në përputhje me standardet teknike rregullatore të përmendura në paragrafin 14, autoritetet kompetente përkatëse mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

16. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar:

- a) formën dhe përmbajtjen e modelit të shkresës së njoftimit, të përmendur në paragrafët 3 dhe 5;
- b) formën dhe përmbajtjen e modelit të deklaratës, të përmendur në paragrafin 6;
- c) mënyrën e transmetimit të përmendur në paragrafin 6; dhe
- d) formën e njoftimit me shkrim të përmendur në paragrafin 10.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

17. Pa cenuar nenin 43, paragrafi 1, shtetet anëtare kërkojnë që AIF-të e administruara dhe të tregtuara nga kjo AIFM, t'u tregtohen vetëm investitorëve profesional.

Neni 41

Kushtet për administrimin e AIF-ve të themeluara në shtete anëtare të ndryshme nga shteti anëtar i referencës nga AIFM-të jashtë BE-së

1. Shtetet Anëtare sigurohen që një AIFM e autorizuar jashtë BE-së të mund të administrojë AIF të BE-së të themeluara në një shtet tjetër anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i referencës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes themelimit të një dege, me kusht që kjo AIFM të ketë autorizim për të administruar këtë lloj AIF-je.

2. Çdo AIFM jashtë BE-së që synon të administrojë AIF të BE-së të themeluara për herë të parë në një shtet tjetër anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i referencës, i përcjell autoriteteve kompetente të shtetit të tij anëtar të referencës informacionin e mëposhtëm:

a) shtetin anëtar ku synon të administrojë AIF-të në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes themelimit të një dege;

b) programin e operacioneve, veçanërisht duke cituar shërbimet që synon të kryejë dhe duke identifikuar AIF-të që synon të administrojë.

3. Nëse AIFM-ja jashtë BE-së synon të themelojë një degë, përveç informacionit të kërkuar në paragrafin 2, ajo duhet të sigurojë edhe informacionin e mëposhtëm:

a) strukturën organizative të degës;

b) adresën në shtetin anëtar të origjinës së AIF-së, nga i cili mund të merren dokumentet;

c) emrat dhe të dhënat e personave përgjegjës për administrimin e degës.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së, brenda 1 muaji nga marrja e dokumentacionit të plotë në përputhje me paragrafin 2, ose brenda 2 muajve nga marrja e dokumentacionit të plotë në përputhje me paragrafin 3, i përcjellin këtë dokumentacion autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së. Përcjellja e këtij dokumentacioni kryhet vetëm nëse stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së respekton dhe vazhdon të respektojë këtë direktivë dhe nëse në të kundërt AIFM-ja e respekton këtë direktivë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së bashkëngjisin një deklaratë ku citohet se AIFM-ja në fjalë disponon autorizimin e tyre.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së njoftojnë menjëherë AIFM-në lidhur me përcjelljen e dokumentacionit. Pas marrjes së njoftimit të transmetimit, AIFM-ja mund të fillojë të ofrojë shërbimet e veta në shtetet anëtare pritëse të AIFM-së.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë gjithashtu edhe ESMA-n që AIFM-ja mund të fillojë administrimin e AIF-së në shtetin anëtar pritës të AIFM-së.

5. Shtetet anëtare pritëse të AIFM-së nuk duhet të paraqesin AIFM-së në fjalë kërkesa të tjera në lidhje me çështjet që mbulohen nga kjo direktivë.

6. Në rastin e ndryshimit të ndonjë informacioni të komunikuar në përputhje me paragrafin 2 dhe, sipas rastit, me paragrafin 3, AIFM-ja njofton me shkrim autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës në lidhje me këtë ndryshim, të paktën 1 muaj përpara zbatimit të ndryshimit të planifikuar, ose menjëherë pasi ka ndodhur ndryshimi i paplanifikuar.

Nëse sipas ndryshimit të planifikuar, stafi drejtues i AIFM-së të AIF-së nuk do të respektonte më këtë direktivë ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk do të respektojë më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së informojnë pa vonesë AIFM-në se ajo nuk duhet të vendosë në zbatim këtë ndryshim.

Nëse zbatohet ndonjë ndryshim i planifikuar pavarësisht nënparagrafëve të parë dhe të dytë ose nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i paplanifikuar sipas të cilit stafi drejtues i AIFM-së së AIF-së nuk e respekton më këtë direktivë, ose nëse në të kundërt AIFM-ja nuk e respekton më këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës marrin masat e duhura në përputhje me nenin 46, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, ndalimin shprehimisht të tregtimit të AIF-së.

Nëse këto ndryshime pranohen për shkak se nuk pengojnë stafin drejtues të AIFM-së së AIF-së që të respektojë këtë direktivë, ose në të kundërt AIFM-në që të respektojë këtë direktivë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës informojnë pa vonesë autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së për këto ndryshime.

7. Për të garantuar harmonizimin e qëndrueshëm të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike rregullatore për specifikimin e informacionit që duhet të përcillet në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

Komisionit i delegohen kompetenca për të miratuar standardet teknike rregullatore të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 10 deri në 14 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

8. Për të garantuar kushte uniforme të zbatimit të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për hartimin e formularëve, modeleve dhe procedurave standarde për përcjelljen e informacionit në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 42

Kushtet për tregtimin pa pasaportë në shtetet anëtare të AIF-ve të administruara nga një AIFM jashtë BE-së

1. Pa cenuar nenet 37, 39 dhe 40, shtetet anëtare mund të lejojnë AIFM-të jashtë BE-së t'u tregtojnë investitorëve profesional vetëm në territorin e tyre kuota dhe aksione që ato administrojnë, të paktën sipas kushteve të mëposhtme:

a) AIFM-ja jashtë BE-së të jetë në përputhje me nenet 22, 23 dhe 24 në lidhje me çdo AIF që tregton sipas këtij neni dhe me nenet 26 deri në 30, kur AIF-ja që ajo tregton sipas këtij neni përfshihet në objektin e nenit 26, paragrafi 1. Autoritetet kompetente dhe investitorët e AIF-së të përmendur në këto nene konsiderohen ato të shteteve kompetente ku tregtohen këto AIF;

b) të jenë nënshkruar marrëveshjet e duhura të bashkëpunimit për qëllimet e mbikëqyrjes së rrezikut sistematik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, mes autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku tregtohen këto AIF, për aq sa është e zbatueshme, autoriteteve kompetente të AIF-së të BE-së në fjalë dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIFM-ja jashtë BE-së, për aq sa është e zbatueshme, autoriteteve kompetente të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së, me qëllim garantimin e shkëmbimit efikas të informacionit që u lejon autoriteteve kompetente të shteteve anëtare përkatëse të kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me këtë direktivë;

c) vendi i tretë i themelimit të AIFM-së jashtë BE-së ose të AIF-së jashtë BE-së të mos renditet nga FATF si shtet dhe territor jobashkëpunues.

Kur autoritetet kompetente të AIF-së së BE-së nuk nënshkruajnë marrëveshjet e kërkuara të bashkëpunimit, siç përcaktohet në germen "b" të nënparagrafit të parë brenda një periudhe të arsyeshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku kjo AIF synohet të tregtohet mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

2. Për qëllime të këtij neni, shtetet anëtare mund të vendosin rregulla më të rrepta për AIFM-në jashtë BE-së lidhur me tregtimin e kuotave ose aksioneve të AIF-ve ndaj investitorëve në territorin e tyre.

3. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 1, me qëllim hartimin e kuadrit të përbashkët për lehtësimin e caktimit të ardhshëm të këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e treta.

4. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, EMSA harton udhëzimet për të përcaktuar kushtet e zbatimit të masave të miratuara nga Komisioni në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura në paragrafin 1.

KAPITULLI VIII

TREGTIMI NDAJ INVESTITORËVE TË SHITJES ME PAKICË

Neni 43

Tregtimi i AIF-ve nga AIFM-të ndaj investitorëve të shitjes me pakicë

1. Pa cenuar instrumentet e tjera të legjislacionit të Bashkimit Evropian, shtetet anëtare mund të lejojnë AIFM-të t'u tregtojnë investitorëve të shitjes me pakicë në territorin e tyre, kuota ose aksione të AIF-ve nën administrimin e tyre, në përputhje me këtë direktivë, pavarësisht nëse këto AIF tregtohen në vend apo jashtë kufijve ose nëse janë AIF të BE-së ose jashtë BE-së.

Në këto raste, shtetet anëtare mund të vendosin kërkesa më të rrepta ndaj AIFM-së ose AIF-së sesa kërkesat në fuqi për AIF-të që u tregtohen investitorëve profesional në territorin e tyre, në përputhje me këtë direktivë. Megjithatë, shtetet anëtare nuk duhet të vendosin kërkesa më të rrepta ose kërkesa shtesë për AIF-të e BE-së të themeluara në një shtet tjetër anëtar dhe të tregtuara në baza ndërkufitare krahasuar me AIF-të e tregtuara në vend.

2. Shtetet anëtare që lejojnë tregtimin e AIF-ve ndaj investitorëve të shitjes me pakicë në territorin e tyre, duhet të informojnë Komisionin dhe ESMA-n deri më datë 22 korrik 2014, për:

a) llojet e AIF-së që AIFM-të mund t'u tregtojnë investitorëve të shitjes me pakicë në territorin e tyre;

b) çdo kërkesë tjetër që shteti anëtar vendos për tregtimin e AIF-ve ndaj investitorëve të shitjes me pakicë.

Shtetet anëtare informojnë Komisionin dhe ESMA-n për çdo ndryshim të mëvonshëm të nënparagrafi të parë.

KAPITULLI IX

AUTORITETET KOMPETENTE

SEKSIONI 1

EMËRIMI, KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT E ANKIMIT

Neni 44

Caktimi i autoriteteve kompetente

Shtetet anëtare caktojnë autoritetet kompetente për kryerjen e detyrave të parashikuara në këtë direktivë.

Ata informojnë ESMA-n dhe Komisionin për këtë, duke cilësuar çdo ndarje të detyrave.

Autoritetet kompetente duhet të jenë autoritete publike.

Shtetet anëtare i kërkojnë autoriteteve kompetente vendosjen e metodave të përshtatshme për monitorimin e përputhjes së AIFM-ve me detyrimet e tyre sipas kësaj direktive, sipas rastit, në bazë të udhëzimeve të përgatitura nga ESMA.

Neni 45

Përgjegjësitë e autoriteteve kompetente në shtetet anëtare

1. Mbikëqyrja e kujdesshme e AIFM-së është përgjegjësi e autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, pavarësisht nëse AIFM-ja administron dhe/ose tregton AIF në një tjetër shtet anëtar, pa cenuar ato dispozita të kësaj direktive që u japin përgjegjësi mbikëqyrëse autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës së AIFM-së.

2. Mbikëqyrja e përputhshmërisë së AIFM-së me nenet 12 dhe 14 është përgjegjësi e autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së, ku kjo AIFM administron dhe/ose tregton AIF nëpërmjet një dege në atë shtet anëtar.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së mund t'i kërkojnë një AIFM-je që administron ose tregton AIF në territorin e saj, përmes një dege ose jo, të ofrojë informacionin e nevojshëm për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së AIFM-së me rregullat e zbatueshme për të cilat këto autoritete kompetente janë përgjegjëse.

Këto kërkesa nuk duhet të jenë më të rrepta se sa kërkesat e vendosura nga shteti anëtar pritës i AIFM-së për AIFM-në, kur i njëjti shtet anëtar i origjinës monitoron përputhshmërinë me të njëjtat rregulla.

4. Kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së konstatojnë se AIFM-ja që administron dhe/ose tregton AIF-të në territorin e tij, përmes një dege ose jo, vepron në shkelje të një prej rregullave sipas të cilave ato janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e përputhshmërisë, këto autoritete i kërkojnë AIFM-së në fjalë që t'i japë fund kësaj shkelje dhe të informojë autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar.

5. Nëse AIFM në fjalë refuzon t'i japë autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar pritës informacionet që janë nën përgjegjësinë e saj, ose nuk arrin të ndërmarrë hapat e nevojshme për t'i dhënë fund shkeljes së përmendur në paragrafin 4, atëherë autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar pritës njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës për këtë fakt. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së në rastin e parë, duhet:

a) të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar që AIFM-ja në fjalë të sigurojë informacionin e kërkuar nga autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar pritës, në përputhje me paragrafin 3, ose t'i japë fund shkeljes së përmendur në paragrafin 4;

b) të kërkojë informacionin e nevojshëm nga autoritetet përkatëse mbikëqyrëse të vendeve të treta.

Natyra e masave të përmendura në germa "a" u përcillet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së.

6. Nëse AIFM-ja vazhdon të refuzojë dhënien e informacionit të kërkuar nga autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar pritës në përputhje me paragrafin 3, ose nëse vazhdon të shkelë dispozitat ligjore ose rregullatore të përmendura në paragrafin 4 që zbatohen në shtetin e saj anëtar pritës, pavarësisht masave të marra nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së në përputhje me paragrafin 5, ose për shkak se këto masa rezultojnë të jenë të

pamjaftueshme ose nuk ekzistojnë në shtetin anëtar në fjalë, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së, pasi të kenë informuar autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, mund të marrin masat e duhura, duke përfshirë edhe masat e përcaktuara në nenet 46 dhe 48, për të parandaluar apo penalizuar parregullsi të tjera dhe, për aq sa është e nevojshme, për të parandaluar që kjo AIFM të kryejë transaksione të tjera në shtetin e saj anëtar pritës. Kur funksioni i AIFM-së në shtetin anëtar pritës është administrimi i AIF-ve, shteti anëtar pritës mund t'i kërkojë AIFM-së të ndërpresë administrimin e këtyre AIF-ve.

7. Kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së kanë arsye të qarta dhe të vërtetueshme për të besuar se AIFM-ja ka shkelur detyrimet që rrjedhin nga rregullat, sipas të cilave ato nuk kanë asnjë përgjegjësi për mbikëqyrjen e përputhshmërisë, ato ia përcjellin këto gjetje autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, të cilat duhet të marrin të gjitha masat e duhura, nëse lind nevoja duke kërkuar edhe informacione shtesë nga autoritetet përkatëse mbikëqyrëse të vendeve të treta.

8. Nëse AIFM-ja vazhdon të veprojë në një mënyrë që cenon dukshëm interesat e investitorëve të AIF-së përkatëse, stabilitetin financiar apo integritetin e tregut në shtetin anëtar pritës të AIFM-së, pavarësisht masave të marra nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së ose për shkak se këto masa rezultojnë të jenë të papërshtatshme, ose sepse shteti anëtar i origjinës së AIFM-së nuk vepron brenda një kuadri kohor të arsyeshëm, pasi të kenë informuar autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIFM-së, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së marrin të gjitha masat e duhura të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve të AIF-së përkatëse, stabilitetin financiar dhe integritetin e tregut në shtetin anëtar pritës, duke përfshirë edhe mundësinë që të parandalojnë këtë AIFM-në që vazhdojë të tregojë kuota ose aksionet të AIF-së përkatës në shtetin anëtar pritës.

9. Procedura e përcaktuar në paragrafët 7 dhe 8 zbatohen edhe në rast se autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës kanë arsye të qarta dhe të vërtetueshme për mos t'u pajtuar me autorizimin e AIFM-së jashtë BE-së nga shteti anëtar i referencës.

10. Kur autoritetet kompetente përkatëse nuk pajtohen në ndonjë nga masat e marra nga autoriteti kompetent në pajtim me paragrafët 4 deri në 9, ato mund ta sjellin çështjen në vëmendje të ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

11. Sipas rastit, ESMA lehtëson negociatat dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të kërkuara sipas kësaj direktive ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të treta.

Neni 46

Kompetencat e autoriteteve kompetente

1. Autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse dhe hetuese të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre. Këto kompetenca ushtrohen sipas njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) në mënyrë të drejtpërdrejtë;

- b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;
- c) nën përgjegjësinë e tyre, përmes delegimit të subjektet të cilëve u janë deleguar detyra;
- d) duke aplikuar tek autoritetet kompetente gjyqësore.

2. Autoritetet kompetente kanë kompetenca:

- a) të kenë akses në të gjitha dokumentet e çfarëdolloj forme dhe për të marrë një kopje të tyre;
- b) të kërkojnë informacion nga cilido person që ka lidhje me veprimtaritë e AIFM-së ose AIF-së dhe, nëse është e nevojshme, të thërrasin persona dhe t'i marrin në pyetje për qëllime të marrjes së informacionit;
- c) të kryejnë inspektive në terren, me ose pa njoftim paraprak;
- d) të kërkojnë informacione për telefonatat ekzistuese dhe trafikun ekzistues të të dhënave;
- e) të kërkojnë pushimin e çdo praktike që është në kundërshtim me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj direktive;
- f) të kërkojnë bllokimin dhe/ose sekuestrimin e aktiveve;
- g) të kërkojnë ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë profesionale;
- h) të kërkojnë informacion nga AIFM-ja, depozitarët ose audituesit;
- i) të miratojnë çdo lloj mase për të garantuar që AIFM-të ose depozitari të vazhdojnë të veprjnë në përputhje me kërkesat e kësaj direktive të zbatueshme për ta;
- j) të kërkojnë pezullimin e emetimit, riblerjes ose shlyerjes së kuotave në interes të mbajtësve të kuotave ose të publikut;
- k) të tërheqin autorizimin që i është dhënë AIFM-së ose depozitarit;
- l) ta delegojnë çështjen për ndjekje penale;
- m) të kërkojnë që audituesit ose ekspertët të kryejnë verifikime ose hetime.

3. Kur autoriteti kompetent i shtetit anëtar të referencës konsideron që një AIFM jashtë BE-së e autorizuar ka shkelur detyrimet e saj sipas kësaj direktive, ai njofton ESMA-n, duke parashtruar arsyet e plota sa më shpejt të jetë e mundur.

4. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet kompetente të kenë kompetencat e duhura për të marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e funksionimit normal të tregjeve në ato raste kur për një instrument financiar veprimtaria e një ose më shumë AIF-ve në treg mund të rrezikonte funksionimin normal të këtij tregu.

Pushteti dhe kompetencat e ESMA-s

1. ESMA mund të hartojë dhe të rishikojë rregullisht udhëzime për autoritetet kompetente të shteteve anëtare për ushtrimin e kompetencave të tyre të autorizimit dhe për detyrimet e raportimit nga ana e autoriteteve kompetente sipas kësaj direktive.

ESMA gëzon kompetencat e nevojshme, duke përfshirë ato kompetenca të renditura në paragrafin 3 të nenit 48, për të përmbushur detyrat që i atribuohen sipas kësaj direktive.

2. Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar më parë ESMA-n, dhe për autoritetet kompetente ose çdo person tjetër të cilit ESMA i ka deleguar detyra, duke përfshirë edhe audituesit dhe ekspertët e kontraktuar nga ESMA. Informacioni i mbuluar nga sekreti profesional nuk mund t'i jepet asnjë personi apo autoriteti tjetër përveçse kur kjo është e nevojshme për procedura gjyqësore.

3. I gjithë informacioni i shkëmbyer sipas kësaj direktive mes ESMA-s, autoriteteve kompetente, EBA-s, Autoritetit Mbikëqyrës Evropian (Autoriteti Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale) i krijuar me Rregulloren (KE) nr. 1094/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe ESRB-së duhet të konsiderohet si konfidencial, përveç kur ESMA ose autoriteti kompetent ose autoriteti apo organi tjetër në fjalë deklaron në momentin e komunikimit të këtij informacioni se ky informacion mund të jepet ose rastet kur dhënia e këtij informacioni është i nevojshëm për procedurat gjyqësore.

4. Në përputhje me nenin 9 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010 dhe kur përmbushen të gjitha kushtet e paragrafit 5, ESMA mund t'i kërkojë autoritetit ose autoriteteve kompetente të marrin ndonjë nga masat e mëposhtme, sipas rastit:

a) të ndalojnë tregtimin në BE të kuotave ose aksioneve të AIF-ve të administruara nga AIFM-të jashtë BE-së ose të AIF-ve jashtë BE-së nën administrimin e AIFM-ve të BE-së pa autorizimin e kërkuar në nenin 37 ose pa njoftimin e kërkuar në nenet 35, 39 dhe 40 ose pa marrë pëlqimin e shteteve anëtare përkatëse, në përputhje me nenin 42;

b) të vendosin kufizime për AIFM-të jashtë BE-së lidhur me administrimin e një AIF-je në rast se në një treg të caktuar ose në baza ndërkufitare ka një përqendrim të tepërt rreziku;

c) të vendosin kufizime për AIFM-të jashtë BE-së lidhur me administrimin e një AIF-je, kur veprimtaritë e saj përbëjnë një burim të mundshëm të rëndësishëm të rrezikut si kundërpalë ndaj një institucioni kreditor ose institucioneve përkatëse sistemike.

5. ESMA mund të marrë një vendim sipas paragrafit 4 dhe sipas kërkesave të përcaktuara në paragrafin 6, nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

a) nëse ekziston ndonjë kërcënim i madh, që e ka origjinën ose është përkeqësuar nga veprimtaritë e AIFM-ve, ndaj funksionimit normal dhe integritetit të tregut financiar, ose ndaj stabilitetit të gjithë apo një pjese të sistemit financiar në BE, dhe kur kjo gjë sjell implikime ndërkufitare; dhe

b) autoriteti ose autoritetet kompetente përkatëse nuk kanë marrë masa për të trajtuar këtë kërcënim ose kur masat e marra nuk e trajtojnë mjaftueshëm këtë kërcënim.

6. Masat e marra nga autoriteti ose autoritetet kompetente sipas paragrafi 4 duhet:

a) të trajtojnë në mënyrë efikase kërcënimin ndaj funksionimit normal dhe integritetit të tregut financiar ose qëndrueshmërisë së të gjithë ose një pjese të sistemit financiar në BE ose të të përmirësojnë ndjeshëm kapacitetet e autoriteteve kompetente për të monitoruar këtë kërcënim;

b) të mos krijojnë rrezik të arbitrazhit rregullator;

c) të mos dëmtojnë efikasitetin e tregjeve financiare, duke përfshirë reduktimin e likuiditetit në ato tregje ose krijimin e pasigurisë për pjesëmarrësit në treg, në mënyrë joproportionale në dobi të masave.

7. Përpara se t'i kërkojë autoritetit kompetent marrjen ose rinovimin e masave të përmendura në paragrafin 4, kur shihet e përshtatshme, ESMA këshillohet me Bordin Evropian të Riskut Sistemik dhe autoritetet e tjera përkatëse.

8. ESMA njofton autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së jashtë BE-së dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse të AIFM-së jashtë BE-së në fjalë lidhur me vendimin për t'i kërkuar autoritetit kompetent ose autoriteteve kompetente të vendosin ose të rinovojnë çdo masë të përmendur në paragrafin 4. Në këtë njoftim duhet të specifikohen të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) AIFM-ja dhe veprimtaritë që i nënshtrohen këtyre masave, dhe kohëzgjatja e tyre;

b) arsyet pse ESMA mendon se është e nevojshme të vendosë masa në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen, duke përfshirë prova në mbështetje të këtyre arsyeve.

9. ESMA rishikon masat e ndërmarra të përmendura në paragrafin 4 në intervale të përshtatshme dhe në çdo rast të paktën çdo tre muaj. Nëse masat nuk rishikohen pas kësaj periudhe 3 mujore, afati i tyre përfundon në mënyrë automatike. Paragrafët 5 deri në 8 zbatohen për rinovimin e masave.

10. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të referencës së AIFM-së në fjalë jashtë BE-së mund t'i kërkojnë ESMA-s të rishqyrtojë vendimin e saj. Zbatohet procedura e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të nenit 44, paragrafi 1 të Rregullores (KE) nr. 1095/2010.

Neni 48

Penalitetet administrative

1. Shtetet anëtare përcaktojnë rregullat për masat dhe sanksionet e zbatueshme për shkeljen e dispozitave kombëtare, të miratuara në përputhje me këtë direktivë, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e këtyre rregullave. Pa cenuar procedurat për tërheqjen e autorizimit ose të drejtën e shteteve anëtare për të vendosur sanksione penale, këto të

fundit garantojnë, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, mundësinë e marrjes së masave të duhura administrative ose të vendosjes së sanksioneve administrative për personat përgjegjës në rastet kur nuk veprohet në përputhje me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj direktive. Shtetet anëtare sigurohen që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese.

2. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet kompetente të mund të bëjnë publike çdo masë ose sanksion që do të vendoset për shkeljen e dispozitave të miratuara në zbatimin e kësaj direktive, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e tyre mund të rrezikojë seriozisht tregjet financiare, mund të dëmtojë interesat e investitorëve ose mund të shkaktojë dëm joproportional ndaj palëve të përfshira.

3. ESMA harton një raport vjetor mbi zbatimin e masave administrative dhe vendosjen e penalteteve kur shkelen dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj direktive në shtete të ndryshme anëtare. Autoritetet kompetente i japin ESMA-s informacionin e nevojshëm për këtë qëllim.

Neni 49

E drejta për apelim

1. Autoritetet kompetente japin arsye me shkrim për çdo vendim për të refuzuar ose tërhequr autorizimin e AIFM-ve për administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve, ose për çdo vendim negativ të marrë në zbatim të masave të miratuara në zbatim të kësaj direktive, dhe ia komunikojnë ato aplikantëve.

2. Shtetet anëtare parashikojnë që çdo vendim i marrë sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë, të argumentohet siç duhet dhe t'i nënshtrohet të drejtës së ankimit në gjykatë.

Kjo e drejtë ankimi në gjykatë zbatohet edhe kur brenda 6 muajve nga paraqitja e kërkesës nuk merret asnjë vendim lidhur me një kërkesë për autorizim ku ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm.

SEKSIONI 2

BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE TË NDRYSHME

Neni 50

Detyrimi për bashkëpunim

1. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me ESMA-s dhe ESRB-në, sa herë që lind nevoja, për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive ose për ushtrimin e kompetencave të tyre sipas kësaj direktive apo legjislacionit kombëtar.

2. Shtetet anëtare lehtësojnë bashkëpunimin e parashikuar në këtë seksion.

3. Autoritetet kompetente i përdorin kompetencat e tyre për qëllime të bashkëpunimit, edhe në rastet kur vepra nën hetim nuk përbën shkelje të ndonjë rregulloreje në fuqi në vetë shtetin e tyre anëtar.

4. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare i japin menjëherë njeri-tjetrit dhe ESMA-s informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar i përcjellin një kopje të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit që kanë nënshkruar, në përputhje me nenin 35, 37 dhe/ose 40 shteteve anëtare pritëse të AIFM-së në fjalë. Autoritetet kompetente e shtetit anëtar të origjinës, në përputhje me procedurat që lidhin standardet e zbatueshme të rregulloreve teknike, të përmendura në nenin 35, paragrafi 14; nenin 37, paragrafi 17 ose nenin 40, paragrafi 14, përcjellin informacionin e marrë nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të treta, në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me këto autoritete mbikëqyrëse, në lidhje me AIFM-në ose, sipas rastit, në përputhje me nenin 45, paragrafi 6 ose 7, tek autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të AIFM-së përkatëse.

Kur autoriteti kompetent i një shtetit anëtar pritës gjykon se përmbajtja e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me shtetin anëtar të origjinës së AIFM-së në fjalë, në përputhje me nenin 35, 37 dhe/ose 40, nuk është në përputhje me kërkesat sipas standardeve të zbatueshme teknike rregullatore, autoritetet kompetente përkatëse mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

5. Kur autoritetet kompetente të një shteti anëtar kanë arsye të qarta dhe të vërtetueshme për të dyshuar se po kryhen apo janë kryer akte në kundërshtim me këtë direktivë nga një AIFM që nuk është nën mbikëqyrjen e këtyre autoriteteve kompetente, ato njoftojë për këtë fakt ESMA-n dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritës dhe të origjinës së AIFM-së fjalë, në mënyrë sa më specifike. Autoritetet marrëse të njoftimit marrin masat e duhura, informojnë ESMA-s dhe autoritetet kompetente njoftuese për rezultatin e këtyre masave dhe, për sa është e mundur, për zhvillime të rëndësishme të përkohshme. Ky paragraf nuk cenon kompetencat e autoritetit kompetent njoftues.

6. Për të garantuar zbatimin uniform të kësaj direktive në lidhje me shkëmbimin e informacionit, ESMA mund të hartojë draft standarde teknike zbatuese për të përcaktuar kushtet e aplikimit në lidhje me procedurat për shkëmbimin e informacionit mes autoriteteve kompetente dhe mes autoriteteve kompetente dhe ESMA-s.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 51

Transferimi dhe mbajtja e të dhënave personale

1. Në lidhje me transferimin e të dhënave personale mes autoriteteve kompetente, autoritetet kompetente zbatojnë Direktivën 95/46/KE. Në lidhje me transferimin e të dhënave

personale nga ESMA tek autoritetet kompetente të një shteti anëtar ose një vendi të tretë, ESMA respekton Rregulloren (KE) nr. 45/2001.

2. Të dhënat ruhet për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh.

Neni 52

Dhënia e informacionit ndaj vendeve të treta

1. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar mund t'i transferojë rast pas rasti një vendi të tretë të dhëna dhe analizën e të dhënave, ku të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 25 ose 26 të Direktivës 95/46/KE dhe ku të jetë specifikuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar se ky transferim është i domosdoshëm për qëllimet e kësaj direktive. Vendi i tretë nuk duhet t'i transferojë të dhëna një tjetër vendi të tretë pa autorizimin e shprehur me shkrim të autoritetit kompetent të shtetit anëtar.

2. Autoriteti kompetent i një shteti anëtar i jep autoritetit mbikëqyrës të një vendi të tretë informacionin e marrë nga një autoritet kompetent i një tjetër shteti anëtar vetëm kur autoriteti kompetent i shtetit anëtar në fjalë ka marrë shprehimisht pëlqimin e autoritetit kompetent që ka transmetuar informacionin dhe, sipas rastit, ky informacion jepet vetëm për qëllimet që autoriteti kompetent ka dhënë pëlqimin e tij.

Neni 53

Shkëmbimi i informacionit lidhur me pasojat e mundshme sistemike të veprimtarisë së AIFM-së

1. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare përgjegjëse për autorizimin dhe/ose mbikëqyrjen e AIFM-ve sipas kësaj direktive u përcjellin autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare, kur kjo vlen për të monitoruar dhe për t'i përgjigjur implikimeve të mundshme të veprimtarive të disa AIFM-ve të veçanta ose AIFM-ve së bashku për qëndrueshmërinë e institucioneve përkatëse financiare sistemike ose funksionimin e rregullt të tregjeve ku këto AIFM janë aktive. Gjithashtu, ESMA dhe ESRB-ja duhet të informohen dhe t'ia përcjellin këtë informacion autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare.

2. Sipas kushteve të përcaktuara në nenin 35 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, autoritetet kompetente të AIFM-së duhet t'u përcjellin ESMA-s dhe ESRB-së informacionin e agreguar që lidhet me veprimtaritë e AIFM-ve nën përgjegjësinë e tyre.

3. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë përmbajtjen e informacionit të shkëmbyer në përputhje me paragrafin 1.

4. Komisioni miraton akte zbatuese duke specifikuar modalitetet dhe shpeshtësinë e shkëmbimit të informacionit sipas paragrafit 1. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 59, paragrafi 2.

Neni 54

Bashkëpunimi për veprimtaritë e mbikëqyrjes

1. Në kuadër të kompetencave sipas kësaj direktive, autoritetet kompetente të një shteti anëtar mund të kërkojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të një tjetër shteti anëtar në një veprimtari mbikëqyrëse ose për një verifikim në terren, ose për një hetim të kryer në territorin e këtij të fundit.

Kur autoriteti kompetent merr një kërkesë për verifikim apo hetim në terren, ai kryen një nga sa më poshtë:

- a) kryen vetë verifikimin ose hetimin;
- b) lejon kryerjen e verifikimit apo hetimit nga autoriteti kërkuar;
- c) lejon që audituesit ose ekspertët të kryejnë verifikime ose hetime.

2. Në rastin e përmendur në germën "a" të paragrafit 1, autoriteti kompetent i shtetit anëtar që ka kërkuar këtë bashkëpunim mund t'u kërkojë anëtarëve të personelit të tij të asistojnë personelin që kryen këtë verifikim apo hetim. Megjithatë, ky verifikim ose hetim i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm të shtetit anëtar në territorin e të cilit kryhet.

Në rastin e përmendur në germën "b" të paragrafit 1, autoriteti kompetent i shtetit anëtar në territorin e të cilit kryhet ky verifikim apo hetim, mund të kërkojë që anëtarët e personelit të tij të asistojnë personelin që kryen këtë verifikim apo hetim.

3. Autoritetet kompetente mund të refuzojnë të shkëmbejnë informacion ose të reagojnë ndaj një kërkesë për bashkëpunim për kryerjen e një hetimi ose verifikimi në terren, vetëm në rastet e mëposhtme:

a) kur ky hetim, verifikim në terren ose shkëmbim informacioni mund të ndikojë negativisht në sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të shtetit anëtar që i drejtohet kërkesa;

b) kur është nisur tashmë një proces gjyqësor të lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtëve persona përpara autoriteteve të shtetit anëtar të cilit i drejtohet;

c) kur vendimi përfundimtar i dorëzohet tashmë shtetit anëtar, të cilit i drejtohet në lidhje me të njëjtët persona dhe të njëjtat veprime.

Autoritetet kompetente informojnë autoritetet kompetente kërkuese për çdo vendim të marrë sipas nënparagrafit të parë, duke cituar arsyet për këto vendime.

4. Për të garantuar zbatimin uniform të këtij neni, ESMA mund të përgatisë draft standarde teknike zbatuese për përcaktimin e procedurave standarde në mënyrë që autoritetet kompetente të bashkëpunojnë për kryerjen e verifikimeve dhe hetimeve në terren.

Komisionit i delegohen kompetencat për miratimin e zbatimit të rregulloreve teknike, të përmendura në nënparagrafin e parë, në përputhje me nenet 15 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

Neni 55

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se autoritetet kompetente të shteteve anëtare nuk bien dakord për ndonjë vlerësim, veprim ose mosveprim të një autoriteti kompetent në fusha ku kjo direktivë kërkon bashkëpunim ose koordinim mes autoriteteve kompetente të më shumë se një shteti anëtar, autoritetet kompetente mund t'ia delegojnë çështjen ESMA-s, e cila mund të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë deleguar sipas nenit 19 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010.

KAPITULLI X

DISPOZITA TË PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 56

Ushtrimi i delegimit

1. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara të përmendura në nenet 3, 4, 9, 12, 14 deri në 25, 34 deri në 37, 40, 42, 53, 67 dhe 68 i delegohen Komisionit për një periudhë 4-vjeçare duke nisur nga data 21 korrik 2011. Komisioni harton një raport në lidhje me kompetencat e deleguara jo më vonë se 6 muaj përpara përfundimit të periudhës 4-vjeçare. Delegimi i kompetencave shtyhet automatikisht për periudha me kohëzgjatje identike, përveçse kur Parlamenti Evropian ose Këshilli e revokon atë në përputhje me nenin 57.

2. Kur miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

3. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara i delegohen Komisionit sipas kushteve të përcaktuara në nenet 57 dhe 58.

Neni 57

Revokimi i delegimit

1. Delegimi i kompetencave të përmendura në nenet 3, 4, 9, 12, 14 to 25, 34 deri në 37, 40, 42, 53, 67 dhe 68 mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli.

2. Institucioni që ka nisur një procedurë të brendshme për të vendosur nëse duhet të revokojë delegimin e kompetencave, përpaket të informojë institucionin tjetër dhe Komisionin brenda një kohe të arsyeshme përpara se të merret vendimi përfundimtar, duke cilësuar kompetencat e deleguara që mund të jenë objekt revokimi dhe arsyet e mundshme për një revokim.

3. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuar në atë vendim. Ai hyn në fuqi menjëherë ose në një datë të mëvonshme që specifikohet në atë vendim. Ai nuk prek vlefshmërinë e akteve të deleguara të hyrë tashmë në fuqi. Vendimi botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 58

Kundërshtimet për aktet e deleguara

1. Parlamenti Evropian dhe Këshilli mund të kundërshtojnë një akt të deleguar brenda një periudhe 3 mujore nga data e njoftimit. Me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit, kjo periudhë zgjatet me 3 muaj të tjerë.

2. Nëse në përfundim të periudhës së përmendur në paragrafin 1, as Parlamenti Evropian dhe as Këshilli nuk ka kundërshtuar aktin e deleguar, ai botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe hyn në fuqi në datën që deklarohet aty.

Akti i deleguar mund të botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe mund të hyjë në fuqi përpara përfundimit të kësaj periudhe nëse, me kërkesë të argumentuar të Komisionit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar që të dy Komisionin për qëllimin e tyre për të mos paraqitur kundërshtime.

3. Nëse Parlamenti Evropian ose Këshilli kundërshtojnë aktin e deleguar të miratuar brenda periudhës së përmendur në paragrafin 1, ai nuk hyn në fuqi. Në përputhje me nenin 296 të TFBE-së, institucioni i cili e kundërshton aktin e deleguar deklaron arsyet për këtë kundërshtim.

Neni 59

Masat zbatuese

1. Komisioni asistohet nga Komiteti Evropian i Titujve, i themeluar me Vendimin e Komisionit 2001/528/KE³⁰. Ky Komitet është një komitet sipas kuptimit të Rregullores (BE) nr. 182/2011.

2. Kur përmendet ky paragraf, zbatohet neni 5 i Rregullores (BE) nr. 182/2011.

Neni 60

Publikimi i derogimeve

Kur një shtet anëtar përdor ndonjë derogim ose opsion të parashikuar në nenet 6, 9, 21, 22, 28, 43 dhe nenin 61, paragrafi 5 ai informon Komisionin në lidhje me këtë çështje, si dhe për çdo ndryshim të tyre në vijim. Komisioni vë në dispozicion të publikut informacionin në një faqe interneti ose nëpërmjet mjeteve të tjera lehtësisht të aksesueshme.

Neni 61

Dispozita kalimtare

1. Menaxherët e fondeve alternative të investimit, që sipas kësaj direktive, para 22 korrikut 2013, marrin të gjitha masat e nevojshme për përputhjen me të drejtën e brendshme që rrjedh nga kjo direktivë, dhe dorëzojnë aplikimin për autorizim brenda 1 viti nga kjo datë.

2. Nenet 31, 32 dhe 33 nuk zbatohen për tregtimin e kuotave ose aksioneve të fondeve alternative të investimit, të cilat i nënshtrohen ofrimit aktual për publikun, sipas prospektit të hartuar dhe të botuar në përputhje me Direktivën 2003/71/KE, para 22 korrikut 2013, për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së këtij prospekti.

3. Megjithatë, për sa kohë menaxherët e administrimit të fondeve publike të investimit, të cilët nuk kryejnë investime shtesë pas datës 22 korrik 2013, administrojnë fonde alternative të investimit me pjesëmarrje të mbyllur, para datës 22 korrik 2013, ata mund të vazhdojnë administrimin e këtyre fondeve pa u autorizuar sipas kësaj direktive.

4. Megjithatë, për sa kohë menaxherët e administrimit të fondeve publike të investimit administrojnë fonde alternative të investimit me pjesëmarrje të mbyllur, për të cilat periudha e abonimit për investitorët është mbyllur para hyrjes në fuqi të kësaj direktive, dhe vlejnë për afatin së shumti 3 vjet pas datës 22 korrik 2013, ata mund të vazhdojnë administrimin e këtyre fondeve pa përputhje me këtë direktivë, përveçse me nenin 22 dhe, sipas rastit, me nenet 26 deri 30, ose të dorëzojnë aplikimin për autorizim sipas kësaj direktive.

5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ose fondi alternativ i investimit, ose në rastin kur fondi alternativ i investimit nuk rregullohet nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të menaxherit të fondeve alternative të investimit, mund t'i lejojnë institucionet e përmendura në nenin 21, paragrafi 3, germa "a" dhe të themeluara në një tjetër shtet anëtar, caktimin e tyre si depozitar deri më 22 korrik 2017. Kjo dispozitë nuk cenon zbatimin e plotë të nenit 21, me përjashtim të germës a të paragrafit 5 të këtij neni për vendin e themelimit të depozitarit.

Neni 62

Ndryshimet e Direktivës 2003/41/KE

Direktiva 2003/41/KE ndryshohet si më poshtë:

1. në nenin 2, paragrafi, germa "b" zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"b) institucionet që mbulohen nga Direktiva 73/239/;

2. neni 19, paragrafi 1 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

1. Shtetet anëtare nuk i pengojnë institucionet që të emërojnë, për administrimin e portofolit të investimeve, administrues investimi që janë të vendosur në një tjetër shtet anëtar dhe që janë të autorizuar siç duhet për këtë veprimtari, në përputhje me Direktivat 85/611/KEE, 93/22/KEE, 2000/12/KE, 2002/83/KE dhe 2011/61/BE, si dhe ato që përmenden në nenin 2, paragrafi 1, të kësaj direktive.

Neni 63

Ndryshimet e Direktivës 2009/65/KE

Direktiva 2009/65/KE ndryshohet si më poshtë:

1. shtohet neni i mëposhtëm:

"Neni 50/a

Për të garantuar konsistencë ndërsektoriale dhe për vendosjen e rakordimit ndërmjet interesave të shoqërive që ripaketojnë kreditë në tituj të tregtueshëm dhe në instrumente të tjera financiare (krijuesit) dhe SIKTT-të që investojnë në këto tituj ose në instrumente të tjera financiare, Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 112/a, dhe duke iu nënshtruar kushteve të neneve 112/b dhe 112/c, miraton masat që përcaktojnë kërkesat sipas fushave të mëposhtme:

a) kërkesat që duhet të plotësohen nga iniciatori në mënyrë që SIKTT-ja të mund të investojë në tituj ose në instrumente të tjera financiare të këtij lloji të emetuar pas datës 1 janar 2011, duke përfshirë edhe kërkesat që garantojnë se iniciatori mban një interes ekonomik neto prej jo më pak se 5%;

b) kërkesat cilësore që duhet të përmbushin SIKTT-të që investojnë në këta tituj ose në instrumente të tjera financiare.";

2. neni 112, paragrafi 2 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

2. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara të përmendura në nenin 12, 14, 23, 33, 43, 51, 60, 61, 62, 64, 75, 78, 81, 95, dhe 111 i delegohen Komisionit për një periudhë 4-vjeçare duke nisur nga 4 janari 2011. Kompetencat për të miratuar aktet e deleguara të përmendura në nenin 50a i delegohen Komisionit për një periudhë 4-vjeçare duke nisur nga data 21 korrik 2011. Komisioni harton një raport në lidhje me kompetencat e deleguara jo më vonë se 6 muaj përpara përfundimit të periudhës 4-vjeçare. Delegimi i kompetencave shtyhet automatikisht për periudha me kohëzgjatje identike, përveçse kur Parlamenti Evropian ose Këshilli e revokon atë në përputhje me nenin 112/a.

3. Neni 112/a, paragrafi 1 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

1. Delegimi i kompetencave që përmendet në nenet 12, 14, 23, 33, 43, 50a, 51, 60, 61, 62, 64, 75, 78, 81, 95 dhe 111 mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli."

Neni 64

Ndryshimi i Rregullores (KE) nr. 1060/2009

Në Rregulloren (KE) nr. 1060/2009, paragrafi i parë i nenit 4, paragrafi 1 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

1. Institucionet kreditore, siç përcaktohen në Direktivën 2006/48/KE, shoqëritë e investimit, siç përcaktohen në Direktivën 2004/39/KE, sipërmarrjet e sigurimit që janë objekt i Direktivës së Parë të Këshillit 73/239/KEE, datë 24 qershor 1973, "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me nisjen dhe ndjekjen e biznesit të sigurimit të drejtpërdrejtë, të ndryshëm nga ai jetësor", sipërmarrjet e sigurimit, siç përcaktohen

në Direktivën 2002/83/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 nëntor 2002, "Për sigurimin jetësor", sipërmarrjet e risigurimit, siç përcaktohen në Direktivën 2005/68/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 nëntor 2005, "Për risigurimin", SIKTT-të siç përcaktohen në Direktivën, datë 13 qershor 2009, "Për koordinimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të dispozitave administrative në lidhje me sipërmarrjet për investimin kolektiv në tituj të transferueshëm (SIKTT)", institucionet për dispozitat e pensionit profesional, siç përcaktohen në Direktivën 2003/41/KE dhe fondet alternative të investimit, siç përcaktohen në Direktivën 2011/61/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2011, "Për drejtuesit e fondeve alternative të investimit" mund të përdorin vlerësimet e kredisë për qëllime rregullatore, vetëm nëse ato lëshohen nga agjenci të vlerësimit të kredisë të themeluara në BE dhe të regjistruara në përputhje me këtë rregullore.

Neni 65

Ndryshimi i Rregullores (BE) nr. 1095/2010

Në paragrafin 2 të nenit 1 të Rregullores (BE) nr. 1095/2010, fjalët "çdo legjislacion i ardhshëm në fushën e Administruesve të Fondeve Alternative të Investimit (AIFM) zëvendësohen me fjalët "Direktiva 2011/61/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 8 qershor 2011, "Për Administruesit e Fondeve Alternative të Investimit".

Neni 66

Transpozimi

1. Shtetet anëtare miratojnë dhe botojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat e nevojshme administrative për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë përpara datës 22 korrik 2011. Ato i komunikojnë menjëherë Komisionit tekstin e atyre dispozitave dhe një tabelë përputhshmërie ndërmjet atyre dispozitave dhe kësaj Direktive.

2. Shtetet anëtare zbatojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të përmendura në paragrafin 1, duke filluar nga 22 korriku 2013.

3. Pavarësisht paragrafit 2, shtetet anëtare zbatojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të qenë në përputhje me nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41, në përputhje me aktet e deleguara të miratuara nga Komisionit sipas nenin 67, paragrafi 6 dhe që nga data e specifikuar në këto akte.

4. Shtetet anëtare sigurohen që ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të miratuara prej tyre në përputhje me nenin 36 dhe 42, të mos zbatohen më në përputhje me aktet e deleguara të miratuara nga Komisionit sipas nenit 68, paragrafi 6 dhe që nga data e specifikuar në këto akte.

5. Shtetet anëtare, në miratimin e masave të përmendura në paragrafin 1, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre.

6. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit të brendshëm që ato miratojnë në fushën që mbulohet nga kjo direktivë.

Neni 67

Akti i deleguar në zbatim të nenit 35 dhe neneve 37 deri në 41

1. Përpara datës 22 korrik 2015, ESMA nxjerr për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komisionin:

a) mendimin e saj në lidhje me funksionimin e pasaportës për AIFM-të e BE-së që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF të BE-së sipas neneve 32 dhe 33 dhe në lidhje me funksionimin e tregtimit të AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare, dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, në përputhje me regjimet kombëtare të zbatueshme të përcaktuara në nenet 36 dhe 42; dhe

b) këshilla për përdorimin e pasaportës për tregtimin e AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41.

2. ESMA bazon mendimin dhe këshillën e saj lidhur me përdorimin e pasaportës për tregtimin e AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, ndër të tjera, në lidhje me:

a) funksionimin e pasaportës për AIFM-të e BE-së që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF të BE-së:

I. mënyra e përdorimit të pasaportës;

II. problemet e hasura në lidhje me:

— bashkëpunimin efikas mes autoriteteve kompetente,

— funksionimin efikas të sistemit të njoftimit,

— mbrojtjen e investitorit,

— ndërmjetësimin nga ESMA, duke përfshirë numrin e rasteve dhe efikasitetin e ndërmjetësimit;

III. efikasiteti i grumbullimit dhe shpërndarjes së informacionit në lidhje me monitorimin e rrezikut sistemik nga autoritetet kompetente kombëtare, ESMA dhe ESRB-ja;

b) në lidhje me funksionimin e tregtimit të AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare, dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, në përputhje me regjimet kombëtare të zbatueshme:

I. përputhshmëria e AIFM-ve jashtë BE-së me kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë, me përjashtim të nenit 21;

II. përputhshmëria e AIFM-ve jashtë BE-së me nenet 22, 23 dhe 24 në lidhje me çdo AIF të tregtuar nga kjo AIFM dhe, sipas rastit, me nenet 26 deri në 30;

III. ekzistenca dhe efikasiteti i marrëveshjeve të bashkëpunimit për qëllimet e mbikëqyrjes së rrezikut sistemik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, mes autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku tregtohen këto AIF, për aq sa është e zbatueshme, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIF-së së BE-së dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIFM-ja jashtë BE-së, për aq sa është e zbatueshme, autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së;

IV. çdo problem që mund të ketë ndodhur në lidhje me mbrojtjen e investitorit;

V. çdo veçori të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të një vendi të tretë që mund të pengojnë autoritetet kompetente të ushtrojnë në mënyrë efektive funksionet e tyre mbikëqyrëse sipas kësaj direktive;

c) në lidhje me funksionimin e të dy sistemeve, shtrembërimet e mundshme të tregut dhe shtrembërimet e konkurrencës (garantimi i rregullave të barabarta) ose çdo vështirësi të përgjithshme ose specifike të hasura nga AIFM-të e BE-së për themelimin e tyre ose për tregtimin e AIF-ve nën administrimin e tyre në vende të treta.

3. Për këtë qëllim, që nga momenti i hyrjes në fuqi të legjislacionit të brendshëm, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për zbatimin e kësaj direktive dhe deri në momentin kur ESMA të japë mendimin e saj të përmendur në germen "a" të paragrafit 1, autoritetet kompetente të shteteve anëtare i ofrojnë çdo tre muaj ESMA-s informacione për AIFM-të që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF nën mbikëqyrjen e tyre, qoftë përmes aplikimit të regjimit të pasaportave të parashikuar në këtë direktivë ose përmes regjimeve të tyre kombëtare, si dhe informacionet e nevojshme për vlerësimin e elementeve të përmendura në paragrafin 2.

4. Nëse ESMA gjykon se nuk ekzistojnë pengesa të konsiderueshme në lidhje me mbrojtjen e investitorit, çrregullimin e tregut, konkurrencën dhe monitorimin e rrezikut sistemik, të cilat pengojnë përdorimin e pasaportës për tregtimin e AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41, ajo duhet të japë këshilla pozitive lidhur me këtë çështje.

5. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë përmbajtjen e informacionit të siguruar në përputhje me paragrafin 2.

6. Komisioni miraton akte të deleguara brenda 3 muajve pas marrjes së këshillës pozitive dhe mendimit të ESMA-s, dhe duke marrë në konsideratë kriteret e renditura në paragrafin 2 dhe objektivat e kësaj direktive, si për shembull ato që lidhen me tregun e brendshëm, mbrojtjen e investitorit dhe monitorimin efikas të rrezikut sistemik, në përputhje me nenin 56, dhe sipas

kushteve të neneve 57 dhe 58, duke specifikuar datën kur hyjnë në fuqi rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe në nenet 37 deri në 41 në të gjitha shtetet anëtare.

Nëse ka kundërshtime ndaj aktit të deleguar të përmendur në nënparagrafin e parë në përputhje me nenin 58, Komisioni e miraton përsëri këtë akt të deleguar sipas të cilit rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41 gjejnë zbatim në të gjitha shtetet anëtare, në përputhje me nenin 56 dhe sipas kushteve të nenit 57 dhe 58, në një fazë më të vonë që ai e gjykon të përshtatshme, duke marrë parasysh kriteret e renditura në paragrafin 2 dhe objektivat e kësaj direktive, si për shembull ato që lidhen me tregun e brendshëm, mbrojtjen e investitorëve dhe monitorimin efektiv të rrezikut sistemik.

7. Nëse ESMA ende nuk e ka dhënë këshillën e saj brenda afatit të përmendur në paragrafin 1, Komisioni i kërkon ESMA-s të japë këshillën e saj brenda një afati të ri kohor.

Neni 68

Akti i deleguar për ndërprerjen e zbatimit të neneve 36 dhe 42

1. 3 vjet pas hyrjes në fuqi të aktit të deleguar të përmendur në nenin 67, paragrafi 6, sipas të cilit rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe në nenet 37 deri në 41 kanë gjetur zbatim në të gjitha shtetet anëtare, ESMA nxjerr për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komisionin:

a) mendimin e saj në lidhje me funksionimin e pasaportës për AIFM-të e BE-së që tregtojnë AIF jashtë BE-së brenda Bashkimit Evropian sipas nenit 35, dhe për AIFM-të jashtë BE-së që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF brenda Bashkimit Evropian sipas neneve 37 deri në 41, dhe në lidhje me funksionimin e tregtimit të AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare, dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, në përputhje me regjimet kombëtare të zbatueshme të përcaktuara në nenet 36 dhe 42; dhe

b) këshilla mbi përfundimin e ekzistencës së regjimeve kombëtare të përcaktuara në nenet 36 dhe 42 paralelisht me ekzistencën e pasaportës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe nenet 37 deri 41.

2. ESMA e mbështet opinionin dhe këshillat e saj mbi përfundimin e ekzistencës së regjimeve kombëtare të përcaktuara në nenet 36 dhe 42, ndër të tjera:

a) në lidhje me funksionimin e pasaportës për AIFM-të e BE-së që tregtojnë AIF jashtë BE-së brenda Bashkimit Evropian dhe për AIFM-të jashtë BE-së që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF brenda Bashkimit Evropian:

I. mënyra e përdorimit të pasaportës;

II. problemet e hasura në lidhje me:

— bashkëpunimin efikas mes autoriteteve kompetente,

— funksionimin efikas të sistemit të njoftimit,

— cilësimin e shtetit anëtar të referencës,

— funksionet mbikëqyrëse të ushtruara nga autoritetet kompetente të mos pengohen nga ligjet, rregulloret apo dispozitat administrative të një vendi të tretë qeverisës të AIFM-ve, dhe as të kufizojnë kompetencat mbikëqyrëse dhe hetimore të autoriteteve mbikëqyrëse të atij vendi të tretë,

— mbrojtjen e investitorit,

— aksesin e investitorit në BE,

— ndikimin në vendet në zhvillim,

— ndërmjetësimin nga ESMA, duke përfshirë numrin e rasteve dhe efikasitetin e ndërmjetësimit;

III. negocimi, nënshkrimi, ekzistenca dhe efikasiteti i marrëveshjeve të kërkuara të bashkëpunimit;

IV. efikasiteti i grumbullimit dhe shpërndarjes së informacionit në lidhje me monitorimin e rrezikut sistemik nga autoritetet kompetente kombëtare, ESMA dhe ESRB-ja;

V. rezultatet e shqyrtimit në të njëjtin nivel të përmendura në nenin 38;

b) në lidhje me funksionimin e tregtimit të AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së në shtetet anëtare, dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së në shtetet anëtare, në përputhje me regjimet kombëtare të zbatueshme:

I. përputhshmëria e AIFM-ve jashtë BE-së me kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë, me përjashtim të nenit 21;

II. përputhshmëria e AIFM-ve jashtë BE-së me nenet 22, 23 dhe 24 në lidhje me çdo AIF të tregtuar nga kjo AIFM dhe, sipas rastit, me nenet 26 deri në 30;

III. ekzistenca dhe efikasiteti i marrëveshjeve të bashkëpunimit për qëllimet e mbikëqyrjes së rrezikut sistemik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, mes autoriteteve kompetente të shteteve anëtare ku tregtohen këto AIF, për aq sa është e zbatueshme, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së AIF-së së BE-së në fjalë dhe autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIFM-ja jashtë BE-së, për aq sa është e zbatueshme, autoriteteve mbikëqyrëse të vendit të tretë ku është themeluar AIF-ja jashtë BE-së;

IV. çdo problem që mund të ketë ndodhur në lidhje me mbrojtjen e investitorit;

V. çdo veçori të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës të një vendi të tretë që mund të pengojnë autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian të ushtrorjnë në mënyrë efektive funksionet e tyre mbikëqyrëse sipas kësaj direktive;

c) në lidhje me funksionimin e të dy sistemeve, shtrembërimet e mundshme të tregut dhe shtrembërimet e konkurrencës (garantimi i rregullave të barabarta) ose çdo ndikim i mundshëm negativ tek aksesimi i investitorëve ose investimet për ose në dobi të vendeve në zhvillim;

d) një vlerësim sasior ku të identifikohet numri i juridiksioneve të vendeve të treta ku është themeluar një AIFM që tregon një AIF në një shtet anëtar, përmes aplikimit të regjimit të pasaportave të përmendur në nenin 40 ose sipas regjimeve kombëtare të përmendura në nenin 42.

3. Për këtë qëllim, që nga momenti i hyrjes në fuqi të aktit të deleguar të përmendur në nenin 67, paragrafi 6 dhe deri sa ESMA të nxjerrë opinionin e saj të përmendur në germën "a" të paragrafit 1 të këtij neni, autoritetet kompetente i ofrojnë çdo tre muaj ESMA-s informacione për AIFM-të që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF nën mbikëqyrjen e tyre, qoftë përmes aplikimit të regjimit të pasaportave të parashikuar në këtë direktivë ose përmes regjimeve të tyre kombëtare.

4. Nëse ESMA gjykon se nuk ekzistojnë pengesa të konsiderueshme në lidhje me mbrojtjen e investitorit, çrregullimin e tregut, konkurrencën ose monitorimin e rrezikut sistematik, të cilat pengojnë ndërprerjen e regjimeve kombëtare sipas neneve 36 dhe 42 dhe nxjerrjen e pasaportës për tregtimin e AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së brenda Bashkimit Evropian dhe administrimin dhe/ose tregtimin e AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së brenda Bashkimit Evropian, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41 për regjimin e vetëm të mundshëm për këto veprimtari nga AIFM-të përkatëse brenda Bashkimit Evropian, ajo duhet të japë këshilla pozitive lidhur me këtë çështje.

5. Komisioni, përmes akteve të deleguara në përputhje me nenin 56, dhe duke iu nënshtruar ndaj kushteve të neneve 57 dhe 58, miraton masat që specifikojnë përmbajtjen e informacionit të siguruar në përputhje me paragrafin 2.

6. Komisioni miraton akte të deleguara brenda 3 muajve pas marrjes së këshillës pozitive dhe mendimit të ESMA-s, dhe duke marrë në konsideratë kriteret e renditura në paragrafin 2 dhe objektivat e kësaj direktive, si për shembull ato që lidhen me tregun e brendshëm, mbrojtjen e investitorit dhe monitorimin efikas të rrezikut sistematik, në përputhje me nenin 56, dhe sipas kushteve të neneve 57 dhe 58, duke specifikuar datën kur regjimet kombëtare të përcaktuara në nenet 36 dhe 42 duhet të ndërpriten dhe regjimi i pasaportës i parashikuar në nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41 mbetet i vetmi regjim i detyrueshëm që zbatohet në të gjitha shtetet anëtare.

Nëse ka kundërshtime ndaj aktit të deleguar të përmendur në nënparagrafin e parë në përputhje me nenin 58, Komisioni e miraton përsëri këtë akt të deleguar sipas të cilit duhet të ndërpriten regjimet kombëtare të përcaktuara në nenet 36 dhe 42 dhe regjimi i pasaportës i parashikuar në nenin 35 dhe nenet 37 deri në 41 bëhet regjimi i vetëm i detyrueshëm që gjen zbatim në të gjitha shtetet anëtare, në përputhje me nenin 56 dhe sipas kushteve të nenit 57 dhe 58, në një fazë më të vonë që ai e gjykon të përshtatshme, duke marrë parasysh kriteret e renditura në paragrafin 2 dhe objektivat e kësaj direktive, si për shembull ato që lidhen me tregun e brendshëm, mbrojtjen e investitorëve dhe monitorimin efektiv të rrezikut sistematik.

7. Nëse ESMA ende nuk e ka dhënë këshillën e saj brenda afatit të përmendur në paragrafin 1, Komisioni i kërkon ESMA-s të japë këshillën e saj brenda një afati të ri kohor.

Rishikimi

1. Deri më 22 korrik 2017, në bazë të këshillimeve publike dhe duke marrë parasysh diskutimet me autoritetet kompetente, Komisioni duhet të nisë rishikimin e zbatimit dhe qëllimit të kësaj direktive. Ky rishikim analizon përvojën e fituar gjatë zbatimit të kësaj direktive, për ndikimin e saj mbi investitorët, AIF-të ose AIFM-të brenda Bashkimit Evropian dhe në vendet e treta, dhe në masën që objektivat e kësaj direktive të mund të arrihen. Nëse është e nevojshme, Komisioni propozon ndryshimet e përshtatshme. Ky rishikim përfshin një sondazh të përgjithshëm për funksionimin e rregullave të kësaj direktive dhe për eksperiencën e fituar në zbatim të tyre, duke përfshirë:

a) tregtimin në shtetet anëtare përmes regjimeve kombëtare të AIF-ve jashtë BE-së nga AIFM-të e BE-së;

b) tregtimin në shtetet anëtare përmes regjimeve kombëtare të AIF-ve nga AIFM-të jashtë BE-së;

c) administrimin dhe tregtimin e AIF-ve brenda Bashkimit Evropian nga AIFM-të e autorizuara në përputhje me këtë direktivë, përmes regjimit të pasaportës të parashikuar në këtë direktivë;

d) tregtimin e AIF-ve brenda Bashkimit Evropian nga ose për llogari të personave ose subjekteve të ndryshme nga AIFM-të;

e) investimet në AIF nga ose për llogari të investitorëve profesional Evropian;

f) ndikimin e rregullave të depozitarëve të përcaktuara në nenin 21 në tregun e depozitarëve në Bashkimin Evropian;

g) ndikimin e transparencës dhe rregullave të raportimit të përcaktuara në nenet 22 deri në 24, 28 dhe 29 që lidhen me vlerësimin e rrezikut sistemik;

h) ndikimin e mundshëm negativ tek investitorët e shitjes me pakicë;

i) ndikimin e kësaj direktive mbi funksionimin dhe qëndrueshmërinë e kapitalit privat dhe fondeve të kapitalit për ndërmarrjet e reja;

j) ndikimin e kësaj direktive mbi aksesin e investitorëve në BE;

k) ndikimin e kësaj direktive mbi investimet për dhe në dobi të vendeve në zhvillim;

l) ndikimin e kësaj direktive për të mbrojtur shoqëritë apo emetuesit e parenditur të parashikuar në nenet 26 deri 30 të kësaj direktive dhe për të garantuar rregulla të barabarta mes AIF-ve dhe investitorëve të tjerë pas blerjes së shoqërive të mëdha ose për kontrollin mbi këto shoqëri dhe emetues të parenditur.

Gjatë rishikimit të tregtimit dhe/ose administrimit të AIF-ve të përmendura në germa "a", "b" dhe "c" të nënparagrafit të parë, Komisioni analizon se sa e përshtatshme është t'i besojë ESMA-s përgjegjësi të tjera mbikëqyrëse në këtë fushë.

2. Për qëllimet e rishikimit të përmendur në paragrafin 1, shtetet anëtare i japin çdo vit Komisionit informacion për AIFM-të që administrojnë dhe/ose tregtojnë AIF nën mbikëqyrjen e tyre, qoftë nën regjimin e pasaportës të parashikuar në këtë direktivë ose nën regjimet e tyre kombëtare, duke cituar datën e transpozimit të regjimit të pasaportës dhe, sipas rastit, datën e zbatimit të juridiksionin e tyre.

ESMA i jep Komisionit informacion për të gjitha AIFM-të jashtë BE-së të autorizuara ose që kanë kërkuar autorizim në përputhje me nenin 37.

Informacioni i përmendur në nënparagrafët e parë dhe të dytë përfshin:

- a) informacion lidhur me vendin se ku janë themeluar AIFM-të;
- b) sipas rastit, identifikimin e AIF-ve të BE-së nën administrimin e tyre dhe/ose që ato tregtojnë;
- c) sipas rastit, identifikimin e AIF-ve jashtë BE-së nën administrimin e AIFM-ve të BE-së, por që nuk tregtohen brenda Bashkimit Evropian;
- d) sipas rastit, identifikimin e AIF-ve jashtë BE-së që tregtohen brenda Bashkimit Evropian;
- e) informacion për regjimin në fuqi, qoftë i brendshëm apo i BE-së, sipas të cilit AIFM-të përkatëse kryejnë veprimtaritë e tyre; dhe
- f) çdo informacion tjetër që lidhet me mënyrën se si funksionon në praktikë administrimi dhe tregtimi i AIF-ve nga AIFM-të në BE.

3. Shqyrtimi i përmendur në paragrafin 1 merr në konsideratë zhvillimet në nivel ndërkombëtar dhe diskutimet me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare.

4. Pas përfundimit të shqyrtimit, Komisioni i dërgon pa vonesë një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Nëse është e përshtatshme, Komisioni bën propozime, duke përfshirë edhe ndryshime të kësaj direktivë, duke marrë parasysh objektivat e kësaj direktive dhe ndikimet e saj në mbrojtjen e investitorëve, shtrembërimet e tregut dhe konkurrencës, monitorimin e rrezikut sistemik dhe ndikimet e mundshme tek investitorët, AIF-të ose AIFM-të brenda Bashkimit Evropian dhe në vende të treta.

Neni 70

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 71

Marrësit

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 8 qershor 2011.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti
J. BUZEK
Për Këshillin
Presidenti
GYÓRI E.

SHTOJCA I

1. Funkcionet e administrimit të investimeve që një AIFM duhet të paktën të kryejë gjatë administrimit të një AIF-je:

- a) administrimi i portofolit;
- b) menaxhimi i riskut.

2. Funksione të tjera shtesë që një AIFM mund të kryejë gjatë administrimit kolektiv të një AIF-je:

a) Administrimi:

- I. shërbimet ligjore dhe kontabël në lidhje me administrimin e fondeve;
- II. përgjigje për pyetjet e klientëve;
- III. vlerësimi dhe përcaktimi i çmimit, duke përfshirë deklaratat tatimore;
- IV. monitorimi i pajtueshmërisë me rregulloret;
- V. mbajtja e regjistrit të mbajtësve të njësisive/kuotave;
- VI. shpërndarja e të ardhurave;
- VII. kuotat/aksionet e nxjerra dhe reduktimet;
- VIII. zgjidhja e mosmarrëveshjeve kontraktuale, duke përfshirë dërgimin e certifikatave;
- IX. mbajtja e të dhënave;

b) Tregtimi;

c) Veprimtaritë që lidhen me aktivet e AIF-ve, konkretisht shërbimet e nevojshme për të përmbushur detyrat e lëna në mirëbesim të AIFM-së, administrimi i objekteve, veprimtaritë e administrimit të pasurive të patundshme, këshilla ndaj sipërmarrjeve lidhur me strukturën e kapitalit, strategjia industriale dhe çështje të lidhura me të, këshilla dhe shërbime lidhur me bashkimet dhe blerjen e sipërmarrjeve dhe shërbime të tjera që lidhen me administrimin e AIF-së dhe të shoqërive dhe pasurive të tjera ku ka investuar.

SHTOJCA II

POLITIKA E SHPËRBLIMIT

1. Gjatë përcaktimit dhe zbatimit të politikave të shpërblimit total, ku përfshihen rrogat dhe përfitimet diskrecionale nga pensioni, për ato kategori të stafit ku përfshihen drejtuesit e lartë, ata që marrin përsipër rrezikun, funksionet e kontrollit dhe çdo punonjës që merr një shpërblim total që e përfshin atë në të njëjtën fashë shpërblimi me drejtuesit e lartë dhe ata që marrin përsipër rrezikun, veprimtaritë profesionale të së cilëve kanë ndikim material në profilin e rrezikut të AIFM-ve ose AIF-ve që administrojnë, AIFM-të veprojnë në përputhje me parimet e mëposhtme në mënyrën dhe masën që i përshtatet përmasës dhe organizimit të brendshëm të këtyre institucioneve dhe natyrës, fushës së zbatimit dhe kompleksitetit të veprimtarive të tyre:

a) politika e shpërblimit të jetë e qëndrueshme dhe të nxisë menaxhimin e mirë dhe efektiv të rrezikut, si dhe të mos nxisë marrjen përsipër të rrezikut në kundërshtim me profilet e rrezikut, rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-ve nën administrimin e tyre;

b) politika e shpërblimit të jetë në pajtim me strategjinë e biznesit, objektivat, vlerat dhe interesat e AIFM-së dhe AIF-së nën administrimin e saj, ose të investitorëve të këtyre AIF-ve, dhe të përfshijë masa për të shmangur konfliktet e interesit;

c) organi drejtues i AIFM-së, në funksionin e tij mbikëqyrës, të miratojë dhe rishikojë në mënyrë periodike parimet e përgjithshme të politikës së shpërblimit dhe të mbajë përgjegjësi për zbatimin e saj;

d) zbatimi i politikës së shpërblimit, të paktën një herë në vit, të jetë objekt i shqyrtimit qendror dhe të pavarur për pajtueshmëri me politikat dhe procedurat e shpërblimit që janë miratuar nga organi drejtues në funksionin e tij mbikëqyrës;

e) stafi që angazhohet në funksionet e kontrollit kompensohet në përputhje me arritjen e objektivave të lidhura me funksionet e tyre, pavarësisht performancës së zonave të tyre në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë;

f) shpërblimi i zyrtarëve të lartë që kryejnë funksione të menaxhimit të rrezikut dhe sigurimit të përputhshmërisë, të mbikëqyret drejtpërsëdrejti nga komiteti i shpërblimeve;

g) kur shpërblimi lidhet me performancën, shuma totale e shpërblimit bazohet në një kombinim të vlerësimit të performancës së individit dhe të njësisë së biznesit ose AIF-së në fjalë

dhe të rezultateve të përgjithshme të AIFM-së, dhe gjatë vlerësimit të performancës individuale merren në konsideratë kriteret financiare dhe jofinanciare;

h) vlerësimi i performancës përcaktohet në një kuadër shumëvjeçar të përshtatshëm për ciklin e jetës së AIF-së të administruar nga AIFM-ja, me qëllim që të garantohet se procesi i vlerësimit bazohet në një performancë më afatgjatë dhe se pagesa aktuale e komponentëve të shpërblimit që bazohen në performancë të shpërndahet përgjatë një periudhe që merr në konsideratë ciklin politikën e kompensimit të AIF-ve nën administrimin e saj dhe rreziqet përkatëse të investimit;

i) shpërblimi i ndryshueshëm i garantuar të jepet në raste përjashtimore, vetëm në rastin e rekrutimit të stafit të ri, dhe të kufizohet vetëm për vitin e parë;

j) komponentët fiks dhe të ndryshueshëm të shpërblimit total të balancohen siç duhet dhe komponenti fiks të përfaqësojë një përqindje mjaftueshëm të lartë të shpërblimit total sa të lejojë funksionimin e një politike plotësisht elastike për komponentët e ndryshueshëm të shpërblimit, duke përfshirë mundësinë për të mos dhënë asnjë komponent të ndryshueshëm shpërblimi;

k) pagesat që lidhen me zgjidhjen e parakohshme të një kontrate të pasqyrojnë performancën e arritur përgjatë kohës dhe të jenë të projektuara në mënyrë të tillë që të mos shpërblejnë shkeljet;

l) matja e performancës që përdoret për të llogaritur komponentët e shpërblimit të ndryshueshëm ose grupet e komponentëve të shpërblimit të ndryshueshëm të përfshijë një mekanizëm gjithëpërfshirës rregullimi për të integruar të gjitha llojet përkatëse të rreziqeve aktuale dhe të ardhshme;

m) sipas strukturës ligjore të AIF-së dhe rregullave apo instrumenteve të saj të themelimit, një pjesë e konsiderueshme, dhe në çdo rast të paktën 50% e çdo shpërblimi të ndryshueshëm përbëhet nga kuota ose aksione të kësaj AIF-je, ose interesa të barasvlershëm pronësie, ose instrumente që lidhen me aksionet ose instrumente të barasvlershme jo në mjete monetare, përveç kur administrimi i AIF-ve vlen më pak se 50% e portofolit total të administruar nga AIFM-ja, dhe në këtë rast nuk zbatohet minimumi prej 50%.

Instrumentet që përmenden në këtë pikë i nënshtrohen një politike të përshtatshme mbajtjeje të hartuar për të koordinuar subvencionet me interesat e AIFM-së dhe të AIF-së nën administrimin e saj, dhe të investitorëve të këtyre AIF-ve. Shtetet anëtare ose autoritetet e tyre kompetente mund të vendosin kufizime për llojet dhe modelet e këtyre instrumenteve ose mund të ndalojnë, sipas rastit, disa instrumente të caktuara. Kjo pikë zbatohet si për pjesën e komponentit të shpërblimit të ndryshueshëm të shtyrë në përputhje me germën "n", ashtu edhe për pjesën e komponentit të shpërblimit të ndryshueshëm që nuk shtyhet;

n) një pjesë e konsiderueshme, në çdo rast jo më pak se 40%, e komponentit të shpërblimit të ndryshueshëm shtyhet për një periudhë të përshtatshme në aspektin e ciklit të jetës dhe politikës së kompensimit të AIF-së në fjalë dhe koordinohet saktë me natyrën e rreziqeve të AIF-së në fjalë.

Periudha e përmendur në këtë pikë është të paktën nga tre deri në 5 vjet, përveç kur cikli i jetës së AIF-së në fjalë është më i shkurtër; shpërblimi i pagueshëm sipas marrëveshjeve për shtyrje nuk i tejkalon nivelet proporcionale; në rastin e një komponenti të shpërblimit të ndryshueshëm në një shumë veçanërisht të lartë, të paktën 60% e shumës shtyhet;

o) shpërblimi i ndryshueshëm, duke përfshirë pjesën e shtyrë, paguhet ose jepet vetëm nëse është i qëndrueshëm sipas situatës financiare të AIFM-së në tërësi, dhe justifikohet mbi bazën e performancës së njësisë së biznesit, AIF-së dhe individit në fjalë.

Shpërblimi i ndryshueshëm total në përgjithësi pëson tkurrje të konsiderueshme në rastet kur AIFM-ja ose AIF-ja në fjalë ka një performancë financiare të ulët ose negative, duke marrë në konsideratë shpërblimin aktual dhe reduktimet në pagesat e shumave të fituara më parë, duke përfshirë nëpërmjet masave penalizuese (malus) ose të kthimit;

p) politika e pensionit të jetë në përputhje me strategjinë e biznesit, objektivat, vlerat dhe interesat afatgjatë të AIFM-së dhe AIF-së nën administrimin e saj.

Nëse punonjësi largohet nga AIFM-ja përpara se të dalë në pension, përfitimet diskrecionale nga pensioni mbahen nga AIFM-ja për një periudhë prej 5 vitesh në formën e instrumenteve të përcaktuara në germën "m". Në rastet kur një punonjës arrin moshën e pensionit, përfitimet diskrecionale nga pensioni i paguhen punonjësit në formën e instrumenteve të përcaktuara në germën "m", duke iu nënshtruar një periudhe mbajtjeje prej 5 vitesh;

q) anëtarëve u kërkohet që të zotohen të mos përdorin strategji mbrojtëse personale ose sigurim në lidhje me shpërblimin dhe përgjegjësinë në dëm të efekteve të koordinimit të rrezikut të përfshira në marrëveshjet për shpërblimin e tyre;

r) shpërblimi i ndryshueshëm nuk paguhet në formën e automjeteve ose metodave që lehtësojnë shmangien e kërkesave të kësaj direktive.

2. Parimet e përcaktuara në paragrafin 1 zbatohen për shpërblimet e çdo lloji të paguara nga AIFM-ja, për çdo shumë të paguar drejtpërdrejtë nga vetë AIF-ja, duke përfshirë edhe interesin e mbartur dhe çdo transferim të kuotave apo aksioneve të AIF-së në dobi të këtyre kategorive të stafit, duke përfshirë drejtuesit e lartë, ata që marrin përsipër rrezikun, funksionet e kontrollit dhe çdo punonjës që merr një shpërblim total që e përfshin atë në të njëjtën fashë shpërblimi me drejtuesit e lartë dhe ata që marrin përsipër rrezikun, veprimtaritë profesionale të së cilëve kanë ndikim material në profilin e rrezikut të AIF-ve që administrojnë.

3. AIFM-të që konsiderohen të mëdha për sa i përket madhësisë së tyre apo madhësisë së AIF-ve që administrojnë, natyrës dhe strukturës së tyre e brendshme organizative, objektit dhe kompleksitetit të veprimtarive të tyre, duhet të ngrenë një komitet shpërblimi. Komiteti i shpërblimit ka një përbërje të tillë që i mundëson atij të ushtrojë një gjykim kompetent dhe të pavarur për politikën dhe praktikën e shpërblimit dhe subvencionet e krijuara për menaxhimin e rrezikut.

Komiteti i shpërblimit mban përgjegjësi për përgatitjen e vendimeve që lidhen me shpërblimin, duke përfshirë ato që ndikojnë në rrezikun dhe menaxhimin e rrezikut në AIFM-në ose AIF-në përkatëse, vendime të cilat duhet të merren nga organi drejtues me funksione

mbikëqyrëse. Komiteti i shpërblimit kryesohet nga një anëtar i organit drejtues, i cili nuk kryen asnjë funksion ekzekutiv në këtë AIFM. Anëtarët e komitetit të shpërblimit duhet të jenë anëtarë të organit drejtues, të cilët nuk kryejnë asnjë funksion ekzekutiv në këtë AIFM-në.

SHTOJCA III

DOKUMENTACIONI DHE INFORMACIONI QË DUHET TË JEPET NË RAST SE SYNOHET TREGTIMI NË SHTETIN ANËTAR I ORIGJINËS SË AIFM-SË

a) Një letër njoftimi, duke përfshirë një program informacionesh ku të identifikohen AIF-të që AIFM-ja synon të tregtojë dhe informacione se ku janë themeluar këto AIF;

b) rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-së;

c) identifikimi i depozitarit të AIF-së;

d) një përshkrim ose informacione për AIF-në që ndodhet në dispozicion të investitorit;

e) informacion lidhur me vendin e themelimit të AIF-së kryesore nëse kjo AIF është AIF furnizuese;

f) çdo informacion shtesë që përmendet në nenin 23, paragrafi 1 për çdo AIF që AIFM-ja synon të tregtojë;

g) sipas rastit, informacion për marrëveshjet e nënshkruara për të parandaluar që kuotat ose aksionet e AIF-së t'u tregtohen investitorëve të shitjes me pakicë, duke përfshirë edhe rastin kur AIFM-ja gjen mbështetje të veprimtaritë e subjekteve të pavarura për të ofruar shërbime të investimeve në lidhje me këtë AIF.

SHTOJCA IV

DOKUMENTACIONI DHE INFORMACIONI QË DUHET TË JEPET NË RAST SE SYNOHET TREGTIMI NË SHTETET ANËTARE, TË NDRYSHME NGA SHTETI ANËTAR I ORIGJINËS SË AIFM-SË

a) Një letër njoftimi, duke përfshirë një program informacionesh ku të identifikohen AIF-të që AIFM-ja synon të tregtojë dhe informacione se ku janë themeluar këto AIF;

b) rregullat ose instrumentet e themelimit të AIF-së;

c) identifikimi i depozitarit të AIF-së;

d) një përshkrim ose informacione për AIF-në që ndodhet në dispozicion të investitorit;

e) informacion lidhur me vendin e themelimit të AIF-së kryesore nëse kjo AIF është AIF furnizuese;

f) çdo informacion shtesë që përmendet në nenin 23, paragrafi 1 për çdo AIF që AIFM-ja synon të tregtojë;

g) cilësimin e shtetit anëtar ku synon të tregtojë kuota ose aksione të AIF-së ndaj investitorëve profesionalë;

h) informacion në lidhje me masat e marra për tregtimin e AIF-ve dhe, sipas rastit, informacion për marrëveshjet e nënshkruara për të parandaluar që kuotat ose aksionet e AIF-së t'u tregtohen investitorëve të shitjes me pakicë, duke përfshirë edhe rastin kur AIFM-ja gjen mbështetje te veprimtaritë e subjekteve të pavarura për të ofruar shërbime të investimeve në lidhje me këtë AIF.
